



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 91 datë 22.10.2025



PËR MIRATIMIN E "PLANI VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE BASHKIA
PËRMET 2025 – 2028"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, "Për mbrojtjen civile", Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 – 2030, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qëndror, VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 «Plani Kombëtar për Emergjencat Civile» me propozim të Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Përmet 2025 – 2028".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe strukturat e Bashkisë Përmet.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PLANI VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE BASHKIA PËRMET





PLANI VENDOR PËR EMERGGJENCAT CIVILE 2025 - 2028

Përmet, Tetor 2025

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me Nr./.../ 2025

Grupi i Punës

Grupi i punës për koordinimin dhe bashkërendimin në hartimin e dokumentit “Plani Vendor i Emergjencave Civile” të Bashkisë Përmet

(Miratuar me urdhr të Kryetarit të Bashkisë Nr.155 Prot, date 05.05.2025)

Nr	EMRI MBIEMRI	POZICIONI	PËGJEGJËSIA
1.	Florant Hasani	N / Kryetar i Bashkisë	Kryetar
2.	Bekim Mecani	Përgjegjes i Sektorit të EC	Sekretar
3.		Drejtor i Zyrës Juridike dhe Burimeve Njerëzore	Anëtar
4.	Etleva Kreci	Drejtor i Buxhet - Financës	Anëtar
5.	Laert Bushi	Drejtor i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistik.	Anëtar
6	Etleva Myftari	Drejtor i Zhvill. Ekon, Bujq. Turiz.	Anëtar
7.	Klaudia Ciko	Drejtoresh e Integritit, Projekteve të Huaja	Anëtar
8.	Arjana Papapano	Drejtor i Përfshirjes Sociale	Anëtar
9.	Alfred Lipe	Shef i Sektorit të MZSH	Anëtar
10.	Thanas Nikolla	Përgjegjes i Sektorit të Shërbimit Pyjor	Anëtar
11.	Bledar Tesho	Përgjegjës i Sektorit bujqësi - Turizëm	Anëtar
12.	Jetmira Prifti	Specialist i Bujqësisë	Anëtar
13.	Aleksandra Mihali	Specialist i Shëndetësisë	Anëtar
14.	Erdi Gurra	Specialist Veteriner	Anëtar
15.	Harallamb Pano	Specialist Mjedisi	Anëtar
16.	Ledion Komino	Specialist i Kulturës	Anëtar
17	Kristiana Ibrahim	Adminstrator i Nj.Administrative Përmet	Anëtar
18.	Juxhin Pasho	Adminstrator i Nj.Administrative Piskovë	Anëtar
19.	Maringlen Spahiu	Adminstrator i Nj.Administrative Frashër	Anëtar
20.	Ylli Dervishi	Adminstrator i Nj.Administrative Petran	Anëtar
21.	Jani Ilia	Adminstrator i Nj.Administrative Carcovë	Anëtar

B. Bashkpunëtor në hartimin e dokumentit “Plani vendor i Emergjencave Civile”

Nr	EMRI MBIEMRI	POZICIONI
1	Fadil Guci	Specialist në Sektorin e EC të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë
2	Edison Xhenollari	Inxhinier elektrik, Dega OSHEE Përmet
3	Koco Isufi	Inxhinier hidroteknik Dega UK Përmet
4	Irena Shahini	Mjeke, Njësia Vendore Kujdesit Shëndetësor Përmet
5	Anila Mihali	ZVA Përmet
6	Arian Dumi	Përfaqësues i Komisarariatit të policisë Përmet

Parathënie

Plani i emergjencave civile të Bashkisë Përmet është dokumenti kryesor i Institucionit të bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile në territorin e saj.

Qëllimi i Planit të Emergjencave është të përshkruajë strukturën dhe organizimin e nevojshëm për të koordinuar në mënyrë efektive gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave nën juridiksionin e bashkisë Përmet.

Plani u përgatit në kuadër të programit të ndërtimit të kapaciteteve të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në nivelin lokal. Ky është dokumenti i tretë pas Vlerësimit të Riskut dhe Strategjise Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivelin vendor të bashkisë që pasoi miratimin e ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe “Planin Kombëtar të Emergjencave Civile”

Plani u hartua në një kohë kur pritshmëritë pas miratimit të ligjit 45/2019 ishin maksimale për një transformim thelbësor të sistemit të mbrojtjes civile në të gjitha nivelet, me një theks të veçantë në nivelin vendor.

Parimi i subsidiaritetit i sanksionuar më parë në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” është sanksionuar sërish në ligjin 45/2019, i cili i kategorizon emergjencat civile në vendore, rajonale dhe kombëtare, me një kontribut të vetëm të bashkisë në të parën, të përbashkët me bashkitë ose qarqet e tjera në të dytën dhe angazhim të bashkisë krahas angazhimit të gjithë shtetit në të tretën.

Për përgatitjen e planit u shfrytëzuan të gjitha dokumentet ekzistuese dhe përvojat e ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesit. Nënvizojmë faktin se plani u bazua edhe në gjetjet sikurse është në koherencë me dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive dhe me strategjinë vendore të ZRF dhe MC, çka përbën edhe rastin më të mirë për përgatitjen siç duhet të një dokumenti të tillë.

Ai përmbledh informacione dhe tregon rolet e drejtuesve të përfshirë në të gjitha fazat operacionale të menaxhimit të situatave emergjente, bazuar edhe në përvojën e menaxhimit të disa llojeve të fatkeqësive të ndodhura në territorin e bashkisë Përmet ndër vite.

Falënderojmë të gjithë anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës të bashkisë cilët kanë kontribuar në mënyrë aktive në përgatitjen e të gjitha fazave planifikuese dhe elementeve përbërëse të planit vendor për emergjencat civile në territorin e bashkisë Përmet.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për trainimin e stafit të bashkisë, sektorin e emergjencave civile të Prefektit të Qarku Gjirokastrë për koordinimin edhe asistimin në këtë proces, të cilët kanë bërë të mundur një bashkërendim shumë të mirë të aktorëve të përfshirë në procesin e përgatitjes së planit vendor për emergjencat civile, si dhe kanë mbështetur procesin në të gjitha hapat e tij duke kontribuar me ekspertizën dhe njohuritë e tyre në fushën e mbrojtjes civile.

Kryetari Bashkisë

Alma HOXHA

Tabela e Përmbajtjes

Grupi punës	3
Parathënie	4
Përmbajtja	5-6
Lista e tabelave	6
Lista e Figurave	7
Akronimet	7-8
1 Kuadri Ligjor Strategjik Kombëtar dhe Vendor	9
1.1 Kuadri kombëtar strategjik dhe ligjor për mbrojtjen civile	9-10
1.2 Bashkia Përmet: Kuadri institucional dhe dokumentet strategjike për Mbrojtjen Civile.	10-12
1.3 Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të PVEC të Bashkisë Përmet	12-13
2 Parimet e Funkcionimit të PVEC	14
2.1 Parashikueshmëria dhe gatishmëria	14
2.2 Vendimmarrja, lidhshëria dhe pronësia	14-15
2.3 Informacioni..	15-16
2.4 Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit	16
2.5 Përshatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në Nivel Vendor	16-18
3 Sistemi i Mbrojtjes Civile në Nivel Qendror, nivel qarku dhe në nivel vendor	19
3.1 Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile	19
3.2 Institucionet dhe Strukturat Vendore të MC	19-21
3.2.1 Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku	21
3.2.2 Strukturat dhe Institucionet e MC në nivel bashkie..	23-29
3.3 Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie	29
4 Parandalimi/Lehtësimi	30
4.1 Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin në nivel e bashkie..	30-42
5 Gatishmëria	43
5.1 Analiza Riskut për Bashkinë Përmet	43-44
5.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi publik	44-48
5.3 Masat e gatishmërisë	48-50
5.4 Qendrat e Koordinimit dhe zonat e paracaktuara për evakuim dhe përdorimin e tyre për aktivitete në funksion të përgjigjes në raste të emergjencave civile	50-53
5.5 Strukturat dhe institucionet përgjegjëse për Gatishmërinë në nivel bashkie...	53-63
6 Përgjigja	64
6.1 Qëllimet kryesore të përgjigjes.	64
6.2 Aktivizimi i përgjigjes në bashkinë Përmet	64-66
6.3 Aktivitetet e bashkisë në fazën e përgjigjes	66
6.3.1 Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë	66-67
6.3.2 Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë	68-69
6.3.3 Etapa III: Aktivizimi	69-70

6.3.4 Etapa IV. Dalja nga situata	70-71
6.4 Përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve për përgjigjen në nivel bashkie	72-84
6.5 Funkzionet e Përgjigjes	84-90
7 Rimëkëmbja.	91
7.1 Parimet e Rimëkëmbjes dhe zbatimi i tyre në bashkinë Përmet	91-92
7.2 Aktivitetet afatshkurtra.	92
7.3 Aktivitetet afatmesme	92-93
7.4 Aktivitetet Afatgjata	93
7.5 Roli i institucioneve, strukturave dhe aktorëve të tjerë institucionalë gjatë rimëkëmbjes	93-111
7.6 Roli i palëve të interesuara jofitimprurëse në rimëkëmbje	111-112
8 Skenarët	113
8.1 Skenari i riskut nga Përmbytjet	113-127
8.2 Skenari i Riskut të Zjarreve në Pyje	128-137
9 Referenca	138-139
ANEKSE	140
Aneks 1: Zonat e Emergjencës	140-149
Aneks 2: Raportimi Fillestar i Emergjencës	150-161
Aneks 3: Formate orientuese për komunikimin me publikun, sipas etapave	162-162
Aneks 4: Tabela e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike.	163-171
Aneksi5: Plan i nevojave për pajisje e material	171-177
Aneksi6: Lista me pikat e kontaktit	178-181
Aneksi7: Tabela e bashkërendimit të aktiviteteve / funksioneve në përgjigje të emergjencave	182-187
Aneksi8: Komisioni i Mbrojtjes Civile Bashkia Përmet	188-192

Lista e Tabelave

Tabela 1: Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre në fazën e parandalimit / lehtësimit – Bashkia Përmet	30-42
Tabela 2: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e gatishmërisë – Bashkia Përmet	53-63
Tabela 3: Etapat e Përgjigjes	65
Tabela 4: Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë	67
Tabela 5: Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë	68
Tabela 6: Etapa III: Aktivizim	69
Tabela 7: Etapa IV. Dalja nga situata	70
Tabela 8: Institucionet dhe strukturat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e Përgjigjes – Bashkia Përmet	72-84
Tabela 9: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e rimëkëmbjes – Bashkia përmet	93-111

Lista e Figurave

Figura 1: Emergjencat/model mbi vendimmarrjet për fatkeqësitë	15
Figura 2: Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile	19
Figura 3: Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe ndërveprimi i saj me nivelin qendror dhe atë vendor	20
Figura 4: Skema Institucionale e EC të institucionit të prefektit.	22
Figura 5: Strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor dhe QOECB.	24
Figura 6: Protokolli i Komunikimit gjatë Emergjencave Civile	45
Figura 7: Buletini ditor nga IGJEO mbi parashikimin e rrezikut hidro-meteorologjik	49
Figura 8: Rreziku i zjarreve në pyje - Buletini ditor i IGJEO	49
Figura 9: Modeli i Ndërhyrjes për Menaxhimin e Emergjencës.	66
Figura 10: Etapa 4 “Dalja nga Situata”.	71

Lista e Akronimeve

AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
BE	Bashkimi European
EC	Emergjencia Civile
EKKSH	Ekipet Kombëtare të Kërkimit dhe Shpëtimit
DQO	Drejtues Qendror i Operacionit
DOB	Drejtuesi i Operacionit në Nivel Bashkie
DOQ	Drejtuesi i Operacionit në Nivel Qarku
DPRMSH	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMCB	Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Bashkie
KMCQ	Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku
NEC	Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile
MB	Ministria e Brendshme
MC	Mbrojtja civile
MEC	Menaxhimi i Emergjencave Civile
MIE	Menaxhimi i Integruar i Emergjencave
MIEn	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MVP	Mbështetja e Vendit Pritës (<i>Host Nation Support – HNS</i>)
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PQEC	Plani i Qarkut për Emergjencat Civile

Plani Vendor për Emergjencat Civile – Bashkia Përmet

PH	Paralajmërim i Hershëm
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PVEC	Plani Vendor për Emergjencat Civile
PSV	Procedurë Standarde Veprimi
QKOEK	Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile
QOECB	Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki
QOECQ	Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark
RSH	Republika e Shqipërisë
SIG/GIS	Sisteme Informative Gjeohapësinore
SKZRF	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
SVZRF	Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SHMZSH	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
SHUM	Shërbimi i Urgjencës Mjekësore
VRFNQ	Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror
VRFNV	Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor
VKC	Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Cenueshmërisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRF	Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë

1.Kuadri Ligjor Strategjik Kombëtar dhe Vendor

1.1 / Kuadri kombëtar strategjik dhe ligjor për mbrojtjen civile

Kuadri ligjor për mbrojtjen civile

Kuadri kryesor ligjor për mbrojtjen civile (MC) në Shqipëri parashikohet nga ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ky ligj përcakton Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) si organin qendror që përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë territorin e vendit, gjithashtu ndër të tjera përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të ndryshme në nivel qendror dhe vendor në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile. Ligji parashikon gjithashtu një klasifikim të emergjencave civile si më poshtë vijon:

- emergjenca civile vendore, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në një bashki dhe mund të përballohen me anë të veprimeve të strukturave kompetente të saj;
- emergjenca civile rajonale, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që ndodhin në më shumë se një bashki që, për shkak të natyrës, shkallës dhe shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrjen e koordinuar të disa bashkive ose qarqeve;
- emergjenca civile kombëtare, që vijnë si pasojë e fatkeqësive që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, qendrore e vendore, edhe me masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) SKZRF 2023-2030 përshkruan një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Strategjia ofron një qasje shumë-sektoriale, duke u fokusuar tek parandalimi, gatishmëria, përgjigja dhe rimëkëmbja nga gjashtë risqe kryesore: tërmetet, përmytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, aksidentet teknologjike dhe sëmundjet infektive. SKZRF përcakton në detaje rolet institucionale, kuadrin ligjor, vlerësimet e riskut, përfshirjen e komunitetit, shpërndarjen e burimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ)

VRFNQ sintetizon një vlerësim të risqeve të shumta me të cilat përballlet Shqipëria. Si pjesë e këtij vlerësimi, janë kryer gjashtë vlerësime specifike risku, duke përdorur një metodologji vlerësimi për të renditur nivelet relative të riskut për dymbëdhjetë qarqet për tetë kategori risku (tërmete, përmytje, rrëshqitje dheu, zjarre, aksidente teknologjike, risqe biologjike, dështime digash dhe ortekë). Nga analiza rezulton se dështimet e digave, aksidentet teknologjike, përmytjet dhe risqet biologjike përfaqësojnë kërcënimet më të mëdha, ndërsa Tirana, Vlora dhe Shkodra janë identifikuar si zonat me rrezikshmërinë më të lartë.

Sipas VRFNQ, Qarku Gjirokastrë përballlet me një nivel mesatar risku nga fatkeqësitë (duke u vlerësuar me 2.13, brenda kategorisë me risk mesatar 2.01-3.00). Qarku Gjirokastrë përballlet me risqe të lartë nga përmytjet. Tërmetet, zjarret masive dhe epidemitë paraqesin risk mesatar. Si

kërcënim janë identifikuar gjithashtu risqe si përmytjet ose tërmetet që mund të shkaktojnë aksidente teknologjike.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile

PKEC u miratua me VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 dhe ofron një kuadër gjithëpërfshirës për menaxhimin e emergjencave civile (MEC) dhe fatkeqësive në Shqipëri. Qasja e PKEC bazohet në integrimin e shumë agjencive, duke përcaktuar qartë rolet e institucioneve dhe strukturave qendrore dhe vendore (në nivel qarku dhe bashkie). Elemente kryesore të PKEC përfshijnë:

- Parimet e MEC, duke theksuar kryesisht parashikimin, gatishmërinë, udhëheqjen dhe vazhdimësinë.
- Identifikimin e roleve dhe përgjegjësi të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë AKMC-në dhe ministritë përkatëse në fazat e Parandalimit, Gatishmërisë, Përgjigjes dhe Rimëkëmbjes.
- Detajimin e procedurave të aktivizimit të Përgjigjes ndaj situatave të emergjencave civile, bazuar në llojin e emergjencës dhe shkallën e saj, përfshirë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe koordinimit e asistencës ndërkombëtare.
- Përcaktimin e rolit të AKMC-së si mekanizëm institucional që garanton një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjen e shumë palëve në të gjitha fazat e MEC. PKEC identifikon AKMC si agjencinë përgjegjëse për përmirësimet e vazhdueshme për të fuqizuar kapacitetet gjatë fazës së Gatishmërisë dhe aftësitë reaguese gjatë fazës së Përgjigjes.

1.2 / Bashkia Përmet: Kuadri institucional dhe dokumentet strategjike për Mbrojtjen Civile

Kuadri institucional dhe strategjik për MC i Bashkisë Mallakastër përbëhet nga një sere dokumentesh vendore që ofrojnë udhëzime politikash për të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë një Strategji Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SVZRF), një Vlerësim të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor (VRFNV) dhe një Vlerësim të Kapacitetit dhe Cenueshmërisë të bashkisë (VKC). Këto dokumente, përvojat e mëparshme nga MEC dhe të dhënat e tjera të ofruara nga strukturat bashkiake dhe aktorët e tjerë të përfshirë, përbëjnë kuadrin për zhvillimin e PVEC të Bashkisë Përmet.

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor (VRFNV) në Bashkinë Mallakastër

VRFNV në Bashkinë Përmet shërben si bazë për PVEC, duke nënvizuar gjashtë risqet kryesore të fatkeqësive: biologjike, përmytjet, rrëshqitjet e dheut, ngjarjet sizmike, aksidentet teknologjike dhe zjarret në pyje. Risku mbizotërues në territorin e kësaj bashkie është ai sizmik, ndërsa edhe risqet e tjerë (si ato sizmike, biologjike, rrëshqitja e dherave, përmytjet, risqet teknologjike dhe zjarret) janë gjithashtu të pranishëm dhe me impact të ulët deri në mesatar.

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SVZRF)

SVZRF është zhvilluar për periudhën 2025-2030 dhe ofron një kuadër bashkëpunimi midis shumë aktorëve vendorë, institucioneve dhe agjencive kombëtare dhe institucioneve ndërkombëtare me qëllim vlerësimin dhe zvogëlimin e risqeve nga fatkeqësitë (ZRF). Strategjia bazohet në gjashtë risqe kryesore: përmytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, aktiviteti sizmik, risqet teknologjike dhe ato biologjike. Ajo ofron një qasje gjithëpërfshirëse, duke garantuar angazhimin e komunitetit dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive në vendimmarrje dhe zbatim. SVZRF shoqërohet nga një mekanizëm vjetor monitorimi, me tregues specifikë për të matur zbatimin e projekteve strategjike dhe ndikimin e përgjithshëm në ZRF. Këta tregues përfshijnë zvogëlimin e humbjeve ekonomike, pakësimin e numrit të personave të prekur, si dhe numrin e iniciativave dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve brenda bashkisë.

Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Cenueshmërisë (VKC) në Bashkinë Përmet

VKC për Bashkinë Përmet përbën një tjetër element kyç të PVEC, nëpërmjet të cilit vlerësohen cenueshmëria dhe kapacitetet ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. VKC mbulon gjashtë risqet kryesore (si më sipër) në përputhje me VRFNV. Ai detajon aspektet e cenueshmërisë dhe kapacitetet specifike të bashkisë dhe njësive përbërëse të saj, si dhe të strukturave dhe institucioneve të tjera që veprojnë në territorin e bashkisë. Raporti thekson cenueshmërinë e komuniteteve të caktuara ndaj risqeve specifike, veçanërisht atyre që banojnë në zona me risk të lartë, ose zona me mungesë të infrastrukturës së përshtatshme (pranë vatrave të zjarrit ose argjinaturave).

Grupet e cenueshme të popullsisë, të moshuarit dhe familjet me kryefamiljare femra janë identifikuar si grupe me risk të veçantë. VKC identifikon gjithashtu boshllëqet në infrastrukturën ekzistuese të ZRF, përfshirë nevojën për sisteme informative gjeohapësinore (SIG/GIS) të përditësuara dhe nevojën për përmirësimin e bazave të të dhënave për vlerësimet nga humbjet prej fatkeqësive.

Është e rëndësishme të theksohet detyrimi i bashkive për të raportuar në sistemin e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë që buron nga VKM nr. 345, datë 26.05.2022, për të cilin stafi i bashkisë Përmet është trajnuar nga AKMC. Çështjet kryesore të diskutuara përfshijnë mbajtjen në gatishmëri të sistemeve të paralajmërimit të hershëm (SPH), trajnimin dhe gatishmërinë e personelit të emergjencave, kapacitetet e bashkisë për të ofruar mbështetje për komunitetet e prekura nga fatkeqësitë dhe koordinimin ndër-institucional të agjencive që veprojnë në territorin e një bashkie gjatë një situatë emergjente. Lidhur me paralajmërimin e hershëm (PH) bashkia ka detyrimin e kryerjes së investimeve në përputhje me ligjin nr. 45/2019. Për sa i takon sistemeve të alarmit, bazuar në VKM nr. 594 datë 13.10.2021 “Për miratimin e kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si

dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre” bashkia është përgjegjëse për vendosjen e tyre pranë subjekteve private kur vlerësohet e nevojshme.

1.3 / Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të PVEC të Bashkisë Përmet

PVEC synon pikësëpari të mbrojë jetët njerëzore dhe të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e banorëve gjatë emergjencave, duke minimizuar dëmtimin e pronës dhe infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve dhe mjedisit. Këto objektiva janë në funksion të garantimit të vazhdimësisë duke ruajtur shërbimet dhe funksionet thelbësore gjatë dhe pas emergjencave apo fatkeqësive që mund të prekin bashkinë. PVEC i Bashkisë Përmet ka si objektiv madhor rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve vendore për të përballuar emergjencat dhe fatkeqësitë, si dhe garantimin e rimëkëmbjes së këtyre komuniteteve vendore pas fatkeqësive.

Objektivat specifike të PVEC përfshijnë:

- ❖ Mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të banorëve gjatë dhe pas emergjencave duke zbatuar masa për evakuimin në kohë, ofrimin e strehimit emergjent dhe ndihmës mjekësore.
- ❖ Minimizimin e dëmeve ndaj pronës, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve dhe mjedisit.
- ❖ Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe dobësive të mundshme brenda komunitetit për të informuar qytetarët mbi aktivitetet e *Gatishmërisë* dhe *Përgjigjes*.
- ❖ Zhvillimin e moduleve dhe programeve të trajnimit dhe të stërvitjeve për aktorët vendorë përgjegjës për emergjencat dhe komunitetin e gjerë.
- ❖ Krijimin e kanaleve të qarta të komunikimit për shpërndarjen e informacionit para, gjatë dhe pas një emergjence për të siguruar që banorët të dinë se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren.
- ❖ Përcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjësive të të gjitha institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore, subjekteve private, organizatave jo-fitimprurëse (OJF) dhe komunitetit para, gjatë dhe pas një emergjence.
- ❖ Garantimin e menaxhimit dhe shpërndarjes efikase të burimeve përfshirë personelin, pajisjet dhe furnizimet, për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive emergjencave.
- ❖ Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të qeverisjes vendore, OJF-ve dhe grupeve të komunitetit për të rritur përpjekjet për t’iu përgjigjur emergjencave.
- ❖ Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për gatishmërinë ndaj emergjencave civile dhe për veprimet që duhen ndërmarrë sipas llojeve të ndryshme të emergjencave civile përmes programeve dhe fushatave informuese.
- ❖ Garantimin e mos-ndërprerjes së shërbimeve dhe funksioneve thelbësore komunitare ose garantimin e rikthimit në gjendje funksionale të tyre sa më shpejt gjatë dhe pas një emergjence.

- ❖ Ndërmarrjen e vlerësimeve pas emergjencave dhe stërvitjeve për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin vendor për emergjencat civile, si dhe në menaxhimin e emergjencave në të ardhmen.

2. Parimet e Funksonimit të PVEC

2.1 / Parashikueshmëria dhe gatishmëria

Parimet e parashikueshmërisë dhe gatishmërisë janë jetikë si për etapat që i paraprijnë një emergjence (*Parandalimi dhe Gatishmëria*) ashtu dhe për etapat që e pasojnë atë. Ato fokusohen në monitorimin aktiv të risqeve të mundshme përmes Menaxhimit të Integruar të Emergjencave (MIE). Planifikimi efikas nxjerr në pah rëndësinë e trajnimeve dhe stërvitjeve pasi rreziqet janë dinamike dhe duhet të vlerësohen dhe menaxhohen vazhdimisht për të mundësuar operacione efikase.


Emergjencat sfidojnë vazhdimësinë e proceseve të punës dhe kërkojnë një ekuilibër midis *Përgjigjes* dhe *Rimëkëmbjes* për të garantuar funksionimin normal të tyre. Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” thekson bashkëpunimin e institucioneve dhe agjencive për parapërgatitjet për emergjencat civile, duke garantuar qartësinë e roleve për të gjithë aktorët përgjegjës. Këta aktorë duhet të zhvillojnë plane vazhdimësie për t'u përgatitur në mënyrë efektive për fatkeqësitë e mundshme që mund të ndërpresin aktivitetet e tyre, duke lejuar një përgjigje më të shpejtë dhe më të organizuar.

2.2 / Vendimmarrja, lidershipi dhe pronësia

Vendimmarrja është një aftësi jetike në emergjencat civile që kërkon trajnim, praktikë dhe një kuptim të thellë të elementeve që karakterizojnë emergjencat. Agjencitë dhe institucionet duhet të sigurohen që menaxherët e emergjencave të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre vendimmarrëse. Proceset e vendimmarrjes mund të klasifikohen në dy kategori kryesore: *vendimmarrja intuitive*, që mbështetet në njohuritë ekzistuese; dhe *vendimmarrja e bazuar në njohuri*, e cila përfshin krahasimin e opsioneve dhe zhvillimin e zgjidhjeve të reja.

Ka disa probleme që mund t'i bëjnë vendimet më pak efikase në një kontekst operacional.

Vendimmarrësit duhet të jenë të vetëdijshëm për to dhe duhet të kontrollojnë vendimet e tyre (nëpërmjet diskutimeve me kolegët ose opinioneve të dyta) për të eliminuar pasojat e padëshiruara. Lidershipi efikas nënkupton një kombinim të dy kategorive vendimmarrëse të mësipërme. Për një Lidërsip sa më efikas në emergjencat civile është thelbësore të analizohen nevojat dhe presionet që lindin gjatë një emergjence ose fatkeqësie, sidomos kur informacioni është shpesh i paplotë ose i paqartë.



Vendosja e qëllimeve dhe objektivave të qarta strategjike i ndihmon agjencitë dhe institucionet të koordinojnë përpjekjet dhe të fokusojnë burimet aty ku nevojitet. Ndërsa veprimet e menjëhershme synojnë të shpëtojnë jetë dhe të zbusin dëmet, fokusi strategjik duhet të përfshijë gjithashtu prioritetet afatgjata të rimëkëmbjes, si rivendosja e shërbimeve parësore dhe mbështetja e komuniteteve të prekura. Objektivat e përbashkëta të *Përgjigjes* përfshijnë mbrojtjen e jetëve, lehtësimin e pasojave, menaxhimin e emergjencave, ofrimin e informacionit publik dhe lehtësimin e rimëkëmbjes së komunitetit. Këto duhet të përfshijnë dhe mësimet të nxjerra për të përmirësuar përgjigjet e ardhshme të emergjencave.

2.3 / Informacioni

Informacioni është kritik për *Përgjigjen* dhe *Rimëkëmbjen* ndaj fatkeqësive. Garantimi i rrjedhës së informacionit brenda agjencive, me partnerët dhe publikun e gjerë, është jashtëzakonisht sfidues në kushtet e një emergjence. Rëndësia e informacionit për reaguesit e emergjencës dhe ata të prekur nga ngjarjet nuk mund të nënvlerësohet.

Menaxhimi i informacionit mbështetet në vetëdijësimin për situatën. Masat për të garantuar rrjedhën e informacionit duhet të parashikojnë përfshirjen e burimeve të shumfishta dhe vlerësimin e tij. Vlerësimi i informacionit është vendimtar për të përcaktuar qartë rëndësinë, saktësinë, afatin kohor, aksesin, interpretimin dhe transparencën e tij. Në këtë kuadër është jetik

transformimi i informacionit të disponueshëm për t'u përdorur sa më lehtë nga strukturat vendore të emergjencave civile ose për informacion publik.

Mbledhja, vlerësimi, vërtetimi dhe shpërndarja e informacionit në situata të emergjencave mund të jetë e vështirë. Kështu p.sh. agjenci të ndryshme veprojnë në mënyra të ndryshme kur vjen fjala tek procedurat e menaxhimit të informacionit ose tek këndvështrimet mbi ngjarjen ose situatën.

Në kushtet e kohës së pamjaftueshme që sjellin tension mes aktorëve, gabimet dhe keqkuptimet mund të ndodhin, çka mund të mbingarkojnë komunikimet mes tyre.

Kur procedurat e informacionit janë të qarta, aktorët vendorë duhet të ndjekin modelet e miratuara në nivel bashkie ose qarku. Përdorimi i modeleve të tilla dhe menaxhimi i informacionit më gjerësisht duhet të përfshihen dhe vlerësohen përmes trajnimeve dhe stërvitjeve.

Është gjithashtu thelbësore që publiku të marrë këshillat, paralajmërimet dhe informacionin e duhur për të ofruar siguri dhe një bazë për çdo veprim të nevojshëm. Nga pikëpamja ligjore, neni 49 i Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ka vendosur detyrimin e qeverisjes vendore për të informuar.

2.4 Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interes

Numri i madh i institucioneve të përfshira sidomos në etapat e *Përgjigjes* dhe *Rimëkëmbjes* nga emergjencat civile ose fatkeqësitë mund të krijojë vështirësi për menaxhimin efikas të operacioneve. Prandaj efikasiteti mund të arrihet vetëm nëse strukturat bëjnë një planifikim të kujdesshëm paraprak dhe përmes trajnimeve dhe stërvitjeve të vazhdueshme sipas risqeve dhe skenarëve të mundshëm. Emergjencat shpesh kanë karakter ndërkuftar, gjë që e bën bashkëpunimin ndërmjet njësisive të qeverisjes vendore kyç për suksesin e adresimit të tyre. Në këtë drejtim, Bashkia Përmet duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë fqinje. Menaxhimi i emergjencave në nivel vendor përfshijnë një numër të madh aktorësh publikë dhe privatë. Menaxhimi i tyre kombinon një numër të madh agjencishë, institucioneve dhe organizatash që shpesh nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën nga marrëdhëniet hierarkike.

Prandaj, proceset e vendimmarrjes duhet të synojnë gjithmonë të jenë gjithëpërfshirëse dhe të arrijnë vendime konsensuale, kurdoherë që është e mundur. Institucionet dhe drejtoritë vendore, si dhe aktorët e tjerë që veprojnë në territorin e Bashkisë Përmet, duhet të kuptojnë funksionet, mënyrat e punës, prioritetet dhe kufizimet e njëri-tjetrit. Kjo do të lehtësojë dialogun e hapur që është thelbësor për një qëllim dhe objektiva të përbashkëta për t'u zhvilluar, dakordësuar dhe punuar mbi to.

2.5 Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në Nivel Vendor

PVEC i bashkisë Mallakstër është në përputhje të plotë me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) (2015-2030).¹ Kuadri Sendai specifikon shtatë objektiva globale për t'u arritur deri në vitin 2030, të tillë si:

- i) ulje të vdekshmërive nga fatkeqësitë në shkallë globale;
- ii) ulje e numrit të njerëzve të prekur nga fatkeqësitë;
- iii) zvogëlim i dëmeve ekonomike nga fatkeqësitë në raport me GDP-në;
- iv) zvogëlimin e dëmtimeve në infrastrukturën kritike dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve bazë (si ato parësore shëndetësore dhe arsimore) përfshirë zhvillimin e rezistencës së tyre ndaj fatkeqësive;
- v) zhvillimin e strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut;
- vi) rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për ZRF;
- vii) rritje e aksesit në sistemet e paralajmërimit të hershëm për fatkeqësitë.

Paralelisht me objektivat, Kuadri Sendai parashikon edhe katër fusha prioritare të adresimit të sfidave në kuadër të ZRF-së, identifikimin e riskut nga fatkeqësitë, zhvillimin e politikave të ZRF dhe të menaxhimit të riskut, rritjen e investimeve për ZRF dhe fuqizimin e gatishmërisë për të ofruar përgjigje efektive ndaj fatkeqësive bazuar në parimin “Ndërtojmë Përsëri më Mirë” (ang. “*BBB – Build Back Better*”) për rimëkëmbjen, rehabilitimin e rindërtimin pas fatkeqësive. Mbështetur në këto fusha prioritare, PVEC i bashkisë Mallakastër është një instrument që synon të adresojë rritjen e kapaciteteve vendore, rritjen e koordinimit institucional dhe ndër institucional në nivel bashkie, prefekturë dhe institucioneve të tjera vendore, me qëllim zvogëlimin e dëmeve në infrastrukturë, uljen e numrit të individëve të prekur, rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive dhe fuqizimin e politikave të menaxhimit të riskut në nivel vendor.

Disa masa që sugjerojmë të merren në nivel qarku dhe bashkie për t'u përshtatur me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2015-2030), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe ndryshimet klimatike janë:

- 1. Vlerësimi i riskut në nivel vendor/qarku:*** Kryerja e vlerësimit të riskut në nivel vendor/qarku sipas parashikimeve ligjore jo më pak se një herë në çdo tre vjet, për të identifikuar risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.
- 2. Angazhimi dhe edukimi i komunitetit:*** Përfshirja e komunitetit në planifikimin e zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë dhe edukimi i tyre rreth praktikave të qëndrueshme dhe përshtatjes klimatike.
- 3. Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës:*** Promovimi dhe investimi në infrastrukturë me qëllim që t'i rezistojë ndikimeve klimatike.
- 4. Përshtatja e bazuar në ekosistem:*** Zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe mbrojtja e habitateve natyrore për të rritur aftësinë ripërtëritëse ekologjike ndaj ndikimeve klimatike.
- 5. Integrimi i politikave:*** Sigurimi që politikat vendore të përputhen me objektivat e Kuadrit Sendai, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm SDG-të dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.
- 6. Ngritja e kapaciteteve:*** Zhvillimi i kapaciteteve vendore duke trajnuar personelin, drejtues të komunitetit dhe organizata që veprojnë në territor për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.

7. Sistemet e paralajmërimit të hershëm: Krijimi dhe mbajtja e sistemeve të fuqishme të paralajmërimit të hershëm për të paralajmëruar shpejt komunitetet për fatkeqësitë e afërta, duke u mundësuar atyre të marrin masa proaktive për të minimizuar dëmin.

8. Promovimi i Jetesës së Qëndrueshme: Mbështetja e iniciativave që përmirësojnë jetesën e banorëve përmes praktikave të qëndrueshme bujqësore, bizneseve miqësore me mjedisin, duke përafuar aktivitetet ekonomike me ruajtjen e mjedisit.

9. Partneriteti dhe Bashkëpunimi: Nxitja e partneriteteve me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, sektorët privatë dhe shoqërinë civile për të siguruar mbështetje dhe burime për zbatimin e masave në nivel vendor/qarku të përshtatjes.


10. Monitorimi dhe Vlerësimi: Monitorimi dhe vlerësimi rregullisht i efektivitetit të masave të zbatuara, duke përshtatur politikat, strategjitë sipas nevojës për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje ndaj sfidave në zhvillim.

3. Sistemi i Mbrojtjes Civile në Nivel Qendror, nivel qarku dhe në nivel vendor

3.1 Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile

Skema mëposhtë paraqet institucione dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile. Për detaje të mëtejshme referoju Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, seksioni 1.4.3.

Figura 2: Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile




Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile

Ministri i Mbrojtjes (MM)

Sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, MM është përgjegjës për mbrojtjen civile. Detyrat kryesore të Ministrit të Mbrojtjes përfshijnë:

- Përcaktimin e drejtimeve dhe objektivave strategjike të AKMC-së;
- Hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për ZRF dhe MC;
- Informimin periodik të KM për çështjet e ZRF dhe MC;
- Mbikëqyrjen e menaxhimit të buxhetit të AKMC-së, sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Figura 3: Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Civile dhe ndërveprimi i saj me nivelin qendror, nivelin e qarkut dhe atë vendor



Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

AKMC përgjegjet për ZRF dhe MC në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke vepruar sipas Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe VKM nr. 747, datë 20.11.2019. Përgjegjësitë e AKMC ndër të tjera përfshijnë zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe përgatitjen e raporteve vjetore për ZRF dhe MC. AKMC koordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e SKZRF, VRFNQ dhe PKEC, planifikon financimin për masat parandaluese dhe lidh marrëveshje me organizatat mbi iniciativat dhe aktivitetet për MC. AKMC-ja koordinon në mënyrë të përqendruar shpërndarjen e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore, të caktuara për përballimin e emergjencave civile apo të fatkeqësive.

Për detaje të mëtejshme referoju Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, seksioni 1.4.3.


3.2 Institucionet dhe Strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qarku dhe në nivel bashkie/vendor.

3.2.1 Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, prefekti i qarkut ka rol parësor në ZRF dhe MC me disa përgjegjësi kritike. Këto përfshijnë: refuzimin e buxheteve të bashkive të cilave u mungojnë fonde për masat e ZRF dhe të mbrojtjes civile; kryerjen e vlerësimit të riskut në nivel qarku; dhe bashkëpunimin me bashkitë për të vlerësuar risqet nga fatkeqësitë dhe për të informuar publikun. Prefekti bashkërendon aktivitetet ndërmjet organeve dhe institucioneve vendore, kërkon ndihmë nga AKMC kur burimet brenda qarkut janë të pamjaftueshme dhe harton e përditëson Planin e Qarkut për Emergjencat Civile (PQEC) të cilin ia paraqet për analizë AKMC-së. Pjesë e strukturës bashkërenduese janë Sektorët e Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile, të ngritur pranë çdo prefekturë.

Për më tepër, prefekti garanton funksionimin e SPH, koordinon shpërndarjen e ndihmës ndërkombëtare gjatë fatkeqësive dhe i jep përparësi investimeve për MEC në nivel qarku. Prefekti është gjithashtu përgjegjës për të krijuar një bazë të dhënash të humbjeve nga fatkeqësitë, për të menaxhuar forcat operationale në rast emergjencash dhe për të promovuar bashkëpunimin midis bashkive dhe qarqeve kufitare. Në rast emergjence prefekti ndan informacionin me AKMC-në, mbikëqyr shërbimet e emergjencës dhe monitoron përpjekjet vendore për ZRF. Nëse nevojat për kompensimin e fatkeqësive tejkalojnë 8% të buxhetit të një bashkie, prefekti i paraqet AKMC-së një kërkesë për mbështetje për të mbuluar dëmet.

Figura 4: Strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku dhe QOECQ



Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile

Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark (QOECQ)

QOECQ është nën autoritetin e prefektit. Ajo aktivizohet menjëherë në të gjitha rastet e fatkeqësive kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore në një territor që përfshin qarkun. Në rastet e tjera vendimi i aktivizimit merret nga prefekti në bashkërendim me AKMC-në pas konsultimeve me KMCQ-në i cili bën një vlerësim të situatës së pritshme ose aktuale dhe paraqet

një raport bazuar në risqet aktuale ose të pritshme. Prefekti cakton një koordinator për të gjitha aktivitetet e qendrë dhe personel me përgjegjësi të përditshme për menaxhimin e kësaj qendre.

Aktivizimi i QOECQ ndodh kur:


- Shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore në një nga bashkitë në juridiksionin e qarkut.
- Rrezikohet një numër i konsiderueshëm jetësh njerëzore.
- Vërehet një shkallë e lartë e kërcënimit për njerëzit, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturoreose mjedisin.
- Kërkohet mbështetje në vend (aktivizimi afatgjatë, burime të kufizuara, etj.);
- Nevojitet një koordinim i burimeve të qarkut, si rezultat i burimeve të kufizuara vendore dhe/ose përmasave të mëdha dhe shtrirjes gjeografike të emergjencës;
- Shqetësim i lartë të ngritur nga media ose grupet e interesit.

3.2.2 Strukturat dhe Institucionet e MC në nivel bashkie

Bashkitë kanë disa përgjegjësi kyçe në ZRF dhe MC, duke përfshirë:

- *Vlerësimin e Riskut*: Kryerjen e VRFNV dhe paraqitjen e dokumenteve tek prefekti dhe AKMC.
- *Informimin publik*: Informimin e komunitetit për risqet nga fatkeqësitë.
- *Hartimi dhe përditësimi i SVZRF dhe PVEC*.
- *Trajnimi*: Organizimi i trajnimeve për mbrojtjen civile për personelin dhe banorët.
- *Sistemet e monitorimit*: Mirëmbajtja e SPH dhe informimi i autoriteteve dhe komuniteteve për emergjencat e mundshme.
- *Menaxhimi i të dhënave*: Përditësimi i të dhënave për planifikimin e fatkeqësive dhe krijimi i një baze të dhënash të humbjeve nga fatkeqësitë.
- *Kryerja e investimeve*: Kryerja dhe raportimi për investimet parandaluese dhe mbrojtëse.
- *Koordinimi operacional*: Koordinimi i përgjigjes ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive, si dhe kompensimi i qytetarëve të prekur.
- *Bashkëpunimi*: Bashkëpunimi me bashkitë kufitare për ZRF dhe MC.
- *Mirëmbajtja e infrastrukturës*: garantimi i mbrojtjes nga zjarri dhe i mbrojtjes së infrastrukturës kritike.
- *Vlerësimi i dëmeve, nevojave dhe dëmshpërblimi*: Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave për përballim, si dhe dëmshpërblimi i shtetasve të prekur nga fatkeqësia.

Figura 5: Strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor dhe QOECB



Burimi: Plani Kombëtar për Emergjencave Civile

Komisioni i Mbrojtjes Civile në Nivel Bashkie (KMCB).

KMCB është një strukturë e përhershme e MC që drejtohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga drejtues të departamenteve bashkiake, drejtues të njësive bashkiake, përfaqësues nga institucionet dhe strukturat që veprojnë në nivel vendor si autoritetet ushtarake, strukturat policore, drejtorë të zyrave arsimore, të shëndetit publik, OJF dhe struktura të tjera të përfshira në fushën e ZRF dhe MC.

Përgjegjësitë kryesore të KMCB dhe strukturës së përhershme të planifikimit dhe të mbrojtjes civile që lidhen me gatishmërinë dhe përgjigjen janë:

- Shqyrtimi dhe analizimi i funksionimit të sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e bashkisë, dhe sipas rastit merr masa për përmirësimin e tij.
- Hartimi i masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.
- Shqyrtimi, rekomandimi, përgatitja e programeve të edukimit dhe veprimtarive trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për përgatitjen e personelit që angazhohet në raste fatkeqësish dhe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.
- Koordinimi i aktiviteteve të menaxhimit të emergjencave midis strukturave shtetërore dhe joshtetërore.
- Bashkëpunimi me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe komisionet përkatëse të bashkive fqinje, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile.
- Përgatitja e PVEC, SZRFNV dhe VRFNV dhe dërgimin e dokumentit të hartuar për miratim në Këshillin Bashkiak, si dhe rishikimin e këtij dokumenti nga ana e tij sipas parashikimeve ligjore.
- Bashkërendimi dhe koordinimi i veprimtarive për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e fatkeqësive.
- Mbikëqyrja e logjistikës së ndihmës emergjente.
- Garantimi i higjienës dhe shërbimeve thelbësore për të dëmtuarit nga fatkeqësitë furnizimin me energji elektrike, ujë, kanalizimet dhe kujdesja për viktimat.
- Zbatimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse për zvogëlimin e risqeve.
- Kontrolli i marrjes së masave në nivel bashkie, për t'u mbrojtur nga dukuri të mundshme rreziku, duke përfshirë:
 - Marrja e masave për të siguruar mirëmbajtjen e kanalizimeve, pastrimin e tyre dhe të kolektorëve nga mbeturinat ose materialet inerte.
 - Njohja e komunitetit me rrugët e evakuimit dhe përgatitjet emergjente, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit, zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta.
 - Ndërgjegjësimi i komunitetit për ruajtjen e ushqimit të nevojshëm, të ujit dhe të rezervave të tjera minimale.
 - Ndjekja dhe zbatimi i të gjitha detyrave të tjera në rastet e fatkeqësive, si në rastet e shpalljes dhe ato të mos shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Drejtuesi i Operacioneve në nivel Bashkie (DOB)

Drejtuesi i operacionit në nivel bashkie caktohet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe është pozicion operacional që ngrihet dhe funksionon në situatat e emergjencave civile. Ai është përgjegjës koordinimin e burimeve njerëzore dhe materiale të listuara në planet vendore për

emergjencat civile dhe kryen këto detyra:

- Bashkërendon strukturat qendrore në nivel vendor, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë dhe siguron drejtimin e përgjithshëm të operacionit/përgjigjes.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e operacioneve të bashkive fqinje, informon dhe sipas rastit kërkon asistencë nga KMCB dhe KMCQ.
- Merr dhe zbaton udhëzimet e përgjithshme nga Kryetari i Bashkisë dhe KMCB, mban lidhje të vazhdueshme, raporton dhe ndjek udhëzimet e KMCB.
- Zbaton planin vendor për emergjencat civile dhe/ose planin për emergjencat civile të qarkut kur drejtimin e merr Prefekti i Qarkut.
- Bashkëvepron me grupe vullnetarësh, të specializuar për përballimin e emergjencave dhe me banorë, të përfshirë përkohësisht në strukturat operacionale të bashkisë.
- Sipas rastit, delegon autoritetin te drejtuesit e strukturave operacionale.
- Në rast se situata përkeqësohet dhe nëse me mundësitë dhe mjetet që zotëron bashkia, nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë të kërkojë mbështetje nga bashkitë fqinje, si dhe të kërojë mbështetje nga autoritetet më të larta shtetërore.

Mbështetja për DOB:

Për të realizuar detyrat e tij, DOB do të mbështetet nga Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB), e cila duhet të përbëhet nga tre sektorë kryesorë:

- Sektori i Planifikimit
- Sektori Operacional
- Sektori i Logjistikës.

Në varësi të natyrës dhe shkallës së emergjencës, si dhe burimeve të aktivizuara, numri i anëtarëve dhe rolet e tyre përshtaten sipas nevojave të situatës.

Në çdo rast, Kryetari i Bashkisë cakton edhe **Drejtues Operacioni Zëvendësues**, të cilit Drejtuesi i Operacionit i delegon përkohësisht detyrën në rastet kur operacioni zgjat mbi 12 orë.

Qendra Operacionale e Emergjencës Civile në Bashki (QOECB)

QOECB është strukturë e përkohshme nën autoritetin e bashkisë, dhe është aktive dhe operacionale në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ajo mund të aktivizohet gjithashtu në situata të tjera emergjente, në varësi të ashpërsisë së fatkeqësisë së pritshme ose të ndodhur dhe kapaciteteve të disponueshme për përballimin e saj.

Aktivizimi i QOECB-së

- Automatiki në rastin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në territorin e bashkisë.
- Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut dhe me AKMC-në dhe pas konsultimit paraprak me KMCB.
- Raportimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së përhershme të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile në bashki, paraqet në KMCB një raport të argumentuar, bazuar në ashpërsinë e fatkeqësisë së pritshme/të ndodhur dhe kapacitetet përballuese në dispozicion.

Funksionet kryesore të QOECB:

- Mbështet Drejtuesin e Operacionit në koordinimin e operacioneve emergjente.
- Siguron një qendër komunikimi dhe shkëmbimi informacioni midis aktorëve të përfshirë.
- Ofron asistencë teknike dhe administrative për funksionimin e KMCB dhe DOB.

Sektorët dhe përgjegjësitë e QOECB

• Sektori i Planifikimit

- ✓ **Planifikimi dhe Vlerësimi:** Harton, përditëson dhe analizon planet e emergjencave dhe vlerësimin e dëmeve.
- ✓ **Informimi Publik:** Koordinon komunikimin me publikun dhe median, duke siguruar informacion të saktë dhe të verifikuar.
- ✓ **Dokumentimi dhe Raportimi:** Mban të dhëna për operacionet dhe përgatitë raportime për ecurinë e emergjencës.

• Sektori Operacional

- ✓ **Koordinimi dhe Zbatimi:** Ekzekuton urdhrat e DOB dhe koordinon operacionet në terren.
- ✓ **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore:** Koordinon personelin operacional dhe mbështetës për përgjigjen ndaj emergjencave.
- ✓ **Ndërlidhja/Komunikimi:** Siguron funksionimin dhe gatishmërinë e rrjeteve të komunikimit ndërmjet ekipeve operacionale.

• Sektori i Logjistikës

- ✓ **Menaxhimi i Burimeve:** Siguron dhe shpërndan pajisje, furnizime dhe ndihma emergjente.
- ✓ **Siguria dhe Mbrojtja:** Siguron mbrojtjen e personelit dhe infrastrukturës kritike të emergjencës.
- ✓ **Infrastruktura dhe Transporti:** Koordinon mbështetjen për energjinë, ujën, transportin dhe mirëmbajtjen e objekteve të emergjencës.

Përgjegjësitë kryesore të QOECB

- Mbledhja dhe ndarja e informacionit midis institucioneve, strukturave dhe organizatave të përfshirane përgjigjen ndaj emergjencës.
- Koordinimi qendror i operacioneve emergjente në mbështetje të KMCB dhe DOB.
- Njoftimi dhe informimi i publikut për situatën emergjente.
- Menaxhimi i burimeve dhe logjistikës për reagimin ndaj emergjencave.

Shkaqet e aktivizimit të QOECB

- Numër i konsiderueshëm i personave në rrezik.
- Shkallë e lartë e kërcënimit për njerëzit, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore ose mjedisin.
- Kërkesa për mbështetje në vend (aktivizimi afatgjatë, burime të kufizuara, etj.).
- Nevoja për koordinim të burimeve për shkak të burimeve të kufizuara vendore dhe/ose madhësisë dhe shtrirjes së emergjencës.
- Shqetësim i lartë i ngritur nga media ose publiku/palët e interesit.

Detyrat e Policisë së Shtetit (PSH) në nivel bashkie

PSH organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e kërkim-shpëtimit, sipas planeve të hartuara më parë dhe planeve të përbashkëta me institucionet e tjera për MC. Detyrat kryesore përfshijnë: mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe informimit të të lënduarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, detyra të tjera që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për PSH. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në situata të tjera fatkeqësish, forcat e tyre komandohen nga eprorët e tyre.

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel bashkie (SHMZSHB)

SHMZSHB është një strukturë e spemergjencat civilealizuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është të inspektojë dhe parandalojë nëpërmjet masave të mbrojtjes nga zjarri dhe të ndërhyjë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e njerëzve, gjësë së gjallë, pronave, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

Shërbimet e Urgjencës Mjekësore (SHUM) dhe strukturat e tjera të kujdesit shëndetësor në nivel bashkie

Veprimtaria e SHUM në fushën e MC rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për SHUM dhe për kujdesin shëndetësor në republikën e Shqipërisë (RSH). SHUM është pjesë përbërëse e forcave

operacionale dhe operon për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës dhe për transportimin e të plagosurve drejt qendrave spitalore.

Shërbimi Vullnetar i Mbrojtjes Civile në nivel Bashkie

Çdo qytetar i RSH kontribuon vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe zvogëlimin e pasojave të tyre. Vullnetarët mund të ofrohen individualisht ose në grupe të organizuara, si struktura jofitimprurëse, por në të gjitha rastet, në varësi të situatave dhe nevojave të sistemit të MC, detyrat e tyre caktohen nga institucionet ose strukturat e mbrojtjes civile qendrore dhe vendore. Trajtimi i vullnetarëve, për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile ose në operacione për parandalimin dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive si dhe sigurimi i jetës dhe shëndetit të tyre rregullohen me VKM nr. 667, datë 10.11.2021 “Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive”.

Nga takimet e ekipit të projektit në Bashkinë e Mallakastrës, rezulton se ekziston angazhimi i vullnetarëve në rastet e operacioneve të parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive, por ky angazhim nuk është i strukturuar apo rregulluar sipas kërkesave të ligjit, për këtë arsye vlerësojmë që struktura dhe mënyra e rregullimit të grupeve vullnetare është e paplotë dhe ka nevojë për rishikim.

Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të MC

Strukturat e demergjencat civileentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të MC që veprojnë në nivel qarku, angazhohen aktivisht në ZRF dhe MC si pjesë përbërëse e KMCQ dhe KMCB (të krijuara përkatësisht nga prefekti dhe nga kryetari i bashkisë).

3.3 / Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie

Financimi i sektorit të MC në nivel bashkie sanksionohet në kuadrin ligjor aktual (ligji nr. 45/2019), sipas të cilit: “bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe për të kryer detyrat në zbatim të këtij ligji, mbështeten në garantimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit të tyre vjetor, i cili sigurohet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e tyre vendore, fondet që vijnë drejtpërdrejtë nga shpërndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet apo edhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

4. Parandalimi / Lehtësimi

Parandalimi/Lehtësimi është një nga katër fazat e ciklit të menaxhimit të EC, miratuar në nivel kombëtar nga AKMC.

Koncepti i “parandalimit” i referohet një sërë aktiviteteve që mund të ndërmerren bashkia Përmet për të shmangur plotësisht risqet nga fatkeqësitë e pritshme (të identifikuara në bazë të Vlerësimit të Riskut) dhe fatkeqësitë e reja që mund të shfaqen, si rezultat i ngjarjeve të papritura natyrore apo edhe aktivitete të shkaktuara nga njeriu, të cilat mund të kenë pasoja të rrezikshme për jetën e njerëzve, infrastrukturën etj.

Lehtësimi, nga ana tjetër, përfshin zvogëlimin ose minimizimin e ndikimeve negative të një ngjarjeje të rrezikshme. Edhe pse e vetëdijshme se disa risqe nga fatkeqësitë janë të pamundura për t'u eliminuar plotësisht, bashkia Fier synon, nëpërmjet këtij PVEC të zvogëlojë cenueshmërinë dhe ekspozimin ndaj tyre, si dhe të forcojë më tej sistemin e paralajmërimit të hershëm.

Ky PVEC synon gjithashtu integrimin me risqet rajonale (në nivel Qarku dhe më gjerë) që ndikojnë territorin e bashkisë, si digat, argjinaturat, risqet nga fatkeqësitë sizmike apo përhapja e sëmundjeve pandemike. Ky kapitull paraqet aktorët kryesorë të përfshirë në masat parandaluese/lehtësuese të bashkisë Fier dhe detyrat e secilit prej tyre në këtë fazë.

4.1/ Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin në nivel e bashkie

Tabela 1: Strukturat dhe institucionet përgjegjësitë e tyre në fazën e parandalimit/lehtësimit – Bashkia Përmet

Institucionet, strukturat dhe palët e përfshira	Përgjegjësitë në fazën e parandalimit/lehtësimit
Institucione dhe struktura në nivel bashkie	
Sektori i Mbrojtjes Civile	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe koordinimi i aktiviteteve për parandalimin e emergjencave civile në nivel bashkie. ➤ Bashkëpunimi me institucionet e tjera në bashki për përgatitjen e planeve dhe masave parandaluese për fatkeqësitë bazuar në dokumentin vendor të vlerësimit të riskut dhe strategjinë vendore për ZRF. ➤ Bashkëpunimi me institucione të tjera që operojnë në territorin e bashkisë Përmet për parandalimin dhe lehtësimin e risqeve nga fatkeqësitë dhe përballimin e

	<p>emergjencave civile.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rritja e ndërjegjësimit të të gjithë komunitetit për rreziqet.
<p>Drejtoria e financë – buxhetit, burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.</p> <p>Sektori financës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i burimeve financiare për menaxhimin e emergjencave civile në territorin e Bashkisë Mallakastër, duke identifikuar fondet e nevojshme dhe burimet e mundshme të financimit. ➤ Planifikimi dhe buxhetimi i fondeve për masat parandaluese, gatishmërinë, përgjigjen emergjente dhe procesin e rimëkëmbjes, duke integruar nevojat financiare në buxhetin vjetor të bashkisë. ➤ Monitorimi, menaxhimi dhe raportimi i përdorimit të fondeve në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarjen dhe përdorimin e financave publike për situatat emergjente.
<p>Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim, Kulturë, Sporte</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i informacionit mbi planin dhe masat e parandalimit dhe lehtësimit në mbrojtjen civile për strukturat që varen nga Drejtoria, me fokus grupet e cenueshme. ➤ Zbatimi i masave për mbrojtjen dhe ruajtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore të bashkisë. ➤ Pjesëmarrja në përgatitjen e planeve të menaxhimit të turizmit në kohë emergjence. ➤ Përdorimi i aktiviteteve turistike për të promovuar gatishmërinë e komunitetit për emergjencat. ➤ Inkurajimi i praktikave të qëndrueshme turistike që ruajnë mjedisin ➤ Zbatimi i masave për ndërtime të sigurta për objektet arsimore/kulturore/sportive/shëndetësore.
<p>Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit Policia Bashkiake Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbatimi i Vendimit nr. 1162, datë 24.12.2020: Sigurimi që të gjitha aplikimet për leje zhvillimi ose ndërtimi përmbushin kërkesën për pajisje me vertetim rrisht nga autoriteti kompetent. ➤ Përcaktimi i zonave me rrisht të lartë: Hartimi dhe përditësimi i hartave të rrishtit (p.sh., për përmbytje, rrëshqitje toke, zjarre) për të udhëhequr proceset e planifikimit territorial. ➤ Integrimi i analizës së rrishtit në planet urbanistike: Përcaktimi i kriterëve të ndërtimit bazuar në analizat e rrishtit për të minimizuar ekspozimin dhe cenueshmërinë e ndërtimeve të reja. ➤ Monitorimi i respektimit të standardeve të ndërtimit: Sigurimi që projektet zhvillimore respektojnë standardet për sigurinë sizmike, hidrologjike dhe gjeoteknike.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Sensibilizimi i komunitetit dhe investitorëve: Organizimi i fushatave informuese mbi rëndësinë e analizave të rrezikut dhe masave parandaluese në proceset e zhvillimit. ➤ Konsultimi me ekspertë dhe institucione relevante: Bashkëpunimi me institucione shkencore dhe teknike për të vlerësuar dhe minimizuar risqet territoriale.
<p>Drejtoria e Kordinimit të Integritimit Evropian të Projekteve, Mardhënieve me Pubikun e Median</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Angazhimi në përgatitjen dhe implementimin e projekteve që i ndihmojnë bashkisë të realizojë objektivat e Integritimit Evropian në fushën e menaxhimit të emergjencave. ➤ Angazhimi në projekte që promovojnë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar për ndihmën dhe mbështetjen në raste emergjencash.
<p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi Turizëm</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i risqeve që mund të ndikojnë në sektorin e bujqësisë ➤ Sigurimi i informacionit për teknikat bujqësore të qëndrueshme, përdorimin e pesticideve dhe substancave të tjera në mënyrë të sigurtë, si dhe ruajtjen e biodiversitetit. ➤ Marrja e masave parandaluese në sektorin e bujqësisë, mbrojtjes së tokës dhe konsumatorit.
<p>Drejtoria e Urbanistikës, Plianifikimit të Territorit - Sektori Juridik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi i akteve ligjore dhe udhëzimeve që rregullojnë procedurat dhemasat për parandalimin e emergjencave në nivel vendor. ➤ Përgatitja dhe mbështetje për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe protokolleve me institucione të tjera, si autoritetet e qeverisjes qendrore, organizatat ndërkombëtare, ose organizatat joqeveritare për mbështetje dhe bashkëpunim në rast emergjencash. ➤ Sigurimi që të gjitha procedurat ligjore të jenë të qarta për reagimin ndaj emergjencave.
<p>Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mirëmbajtja e vendkalimeve të gjerësisë së duhur për afrimin e mjeteve zjarrfikëse në objektet publike dhe private. ➤ Pajisja e ndërtesave me aparate zjarri pluhur të thatë si masë parandaluese për menaxhimin e zjarreve dhe minimizimin e riskut nga zjarret. ➤ Kontrollimi i kutive të shpërndarjes elektrike dhe linjave elektrike. Instalimi i tyre sipas rregullave të sigurisë elektrike. ➤ Kontrollimi i objekteve për pajisjen e tyre me hidrantë të brendshëm dhe të jashtëm, duke siguruar gjithashtu burimet e furnizimit me ujë janë të mjaftueshëm. ➤ Kontrollimi i objekteve për pajisjet e tyre me shkallë

	<p>emergence. Marrja e masave paraprake për pajisjet e tyre me këto shkallë dhe plotësimi i tyre nëse mungojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendosja e tabelave paralajmëruese në vende të dukshme si “Ndalohet pirja e duhanit”, “Nuk lejohet zjarr”. “Rreziku nga zjarri” etj.
Sektori Pyjeve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i risqeve që mund të ndikojnë në sektorët e pyjeve dhe mjedisit, si përmbytjet, zjarret etj. ➤ Vënia në funksion e sistemit të monitorimit dhe sinjalizimit të zjarrit në pikat dominuese të kodrave për identifikimin e hershëm të risqeve të mundshme . ➤ Përgatitja e një sistemi kontaktesh dhe rrjete komunikimi për aktorët lokalë të përfshirë në parandalimin e zjarreve. ➤ Hapja dhe pastrimi i brezave të ndarjes së zjarrit në zonat pyjore për të parandaluar përhapjen e zjarreve ➤ Vendosja e sinjalistikës treguese dhe tabelave paralajmëruese për rrezikun e zjarreve në pyje dhe zonat përreth. ➤ Monitorimi i kushteve klimatike dhe natyrës për të identifikuar ndërlikimet që mund të sjellin emergjenca (p.sh. thatësira, temperature ekstreme, etj.). ➤ Bazuar në vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë, ajo ndërmerr masat e nevojshme strukturore dhe jostrukturore për zvogëlimin e tij. ➤ Ndjek përgjegjësitë ligjore/nënligjore për ndërtimin e brezave të mbrojtjes nga zjarri në fondin pyjor.
Njësitë Administrative	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me strukturat e Bashkisë në procesin e identifikimit, analizës dhe vlerësimit të risqeve nga fatkeqësitë. ➤ Pjesëmarrje në hartimin e planeve për emergjencat civile dhe strategjisë për ZRF. ➤ Organizimi i fushatave edukative për banorët mbi masat parandaluese dhe procedurat e reagimit në rast emergjencash. ➤ Në bashkëpunim me Bashkinë, asistimi dhe mbështetja në zbatimin e masave mbrojtëse, duke përfshirë ndërtimin e kanaleve kulluese, mureve mbrojtëse dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim zvogëlimin e ekspozimit ndaj risqeve. ➤ Kontributi në sistemin e paralajmërimit të hershëm, duke ndihmuar në monitorimin e situatave të rrezikut.
Institucione dhe struktura në nivel qarku	
<p>Prefektura Gjirokastrë Sektori për Planifikimin,</p>	<p>Vlerësimi i Riskut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe miratimi i dokumentit të vlerësimit të

Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave

riskut në nivel qarku në bashkëpunim me bashkitë dhe institucionet përkatëse.

- Koordinimi me bashkinë për realizimin e vlerësimit të riskut në nivel vendor dhe informimin e publikut për rreziqet.
- Zhvillimi dhe mbajtja e hartave të përditësuara që tregojnë zonat e cenueshme ndaj rreziqeve specifike në qark.

Koordinimi i Aktiviteteve për Zvogëlimin e Riskut:

- Koordinimi i veprimtarisë së institucioneve dhe strukturave në nivel qarku për zvogëlimin e riskut dhe mbrojtjen civile.
- Mbikëqyrja e integritit të masave për zvogëlimin e riskut në politikat dhe programet zhvillimore të bashkive.

Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave:

- Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë në nivel qarku dhe shkëmbimi i informacioneve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Monitorimi i Sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm:

- Sigurimi i funksionimit të sistemeve të monitorimit, paralajmërimit të hershëm dhe alarmit për rreziqet në territorin e qarkut.
- Mbikëqyrja e mekanizmave të monitorimit të rreziqeve dhe informimi në kohë të bashkive dhe komuniteteve të rrezikuara.
- Bashkëpunimi me operatorët telekomunikues për garantimin e shpërndarjes së shpejtë të mesazheve të emergjencës.

Parandalimi dhe Zbutja e Pasojave:

- Vendosja e prioriteteve për investime emergjente dhe masat për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë.
- Bashkëpunimi me bashkitë dhe strukturat qendrore për të siguruar masa efektive në zvogëlimin e pasojave të fatkeqësive.

Promovimi i Kulturës së Sigurisë:

- Bashkëpunimi me AKMC dhe institucionet e tjera për ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit.
- Mbështetja e bashkive në zhvillimin e programeve edukative për mbrojtjen civile dhe reagimin ndaj fatkeqësive.

Bashkëpunimi Ndërinstitucional:

- Lehtësimi i shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkive për përballimin e

	<p>sfidave të përbashkëta në reduktimin e riskut.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijimi i mekanizmave të përbashkët ndërmjet nivelit vendor dhe qendror për forcimin e kapaciteteve në parandalimin e fatkeqësive. ➤ Përgatitja e raporteve periodike për AKMC mbi statusin e masave parandaluese dhe rekomandimet për përmirësim.
<p>Përfaqësues të Forcave të Armatosura në territorin e Qarkut</p> <p>B2k Grehot Gjirokastrë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ka përgjegjësinë e shpërndarjes së gatishmërisë në forcat e ushtrisë dhe aktivizimin e strukturave në lidhje me fazat. ➤ Mbështetja e bashkive në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve specifike të zonës. <p>Promovimi i kulturës së sigurisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesëmarrja në aktivitete ndërgjegjësuese dhe edukative për komunitetin mbi masat parandaluese. ➤ Bashkëpunimi me autoritetet vendore për të informuar publikun mbi praktikat më të mira për zvogëlimin e risqeve.
<p>Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)</p>	<p>Monitorimi i Rreziqeve të Furnizimit me Energji Elektrike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e analizave të rreziqeve për rrjetin e transmetimit, duke përfshirë ndikimin e motit ekstrem, ngarkesat e tepërta dhe faktorët gjeologjikë. ➤ Inspektimi i linjave të tensionit të lartë për të shmangur dëmtime nga stuhitë, zjarret ose ndërhyrjet e jashtme. ➤ Zbatimi i teknologjive inteligjente për mbikëqyrjen e rrjetit në kohë reale dhe optimizimin e furnizimit. <p>Menaxhimi i Infrastrukturës Kritike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi i pikave kritike të sistemit të transmetimit në rajonin e Fierit dhe investimi në masat mbrojtëse (përforcimi i shtyllave, instalimi i izolatorëve rezistentë ndaj kushteve atmosferike). ➤ Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit të transmetimit për të zvogëluar rrezikun e ndërprerjeve masive. ➤ Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm për infrastrukturën kritike dhe publike (spitale, institucione shtetërore, qendra operationale të emergjencave). <p>Bashkëpunimi dhe Koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi me Prefekturën dhe bashkitë për të siguruar mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe për të hartuar plane për menaxhimin e risqeve. ➤ Identifikimi dhe menaxhimi i zonave me ndjeshmëri të lartë ku ndërprerjet e transmetimit mund të shkaktojnë pasoja të mëdha në sektorët strategjikë dhe komunitete. ➤ Vendosja e mekanizmave të komunikimit të drejtpërdrejtë me Prefekturën, njësitë e emergjencave dhe operatorët e shpërndarjes për të siguruar

	<p>koordinimin e shpejtë dhe efektiv gjatë situatave emergjente.</p> <p>Ndërgjegjësimi dhe Masat Parandaluese:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Informimi i institucioneve dhe bizneseve mbi masat parandaluese për sigurinë e furnizimit me energji. ➤ Organizimi i trajnimeve për institucionet lokale mbi sigurinë dhe masat e parandalimit për furnizimin me energji.
<p>Drejtoria Rajonale e OSHEE-së</p>	<p>Monitorimi i Rreziqeve të Furnizimit me Energji Elektrike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kontrolli periodik i rrjetit të shpërndarjes për të evidentuar rreziqet që mund të çojnë në defekte të shumta. ➤ Parandalimi i mbingarkesave në rrjet gjatë periudhave të konsumit të lartë për të shmangur prishjet dhe ndërprerjet.. ➤ Implementimi i sistemeve inteligjente të shpërndarjes për monitorimin dhe optimizimin e shpërndarjes së energjisë. <p>Menaxhimi i Infrastrukturës Kritike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Investimi në rrjetin e shpërndarjes për ta bërë më rezistent ndaj faktorëve klimatikë dhe ngarkesave të papritura. ➤ Forcimi i kabllave ajrore dhe nënkalimi i tyre në zonat e rrezikuara nga erozioni ose rrëshqitjet e tokës. ➤ Mirëmbajtja periodike e linjave dhe stacioneve shpërndarëse për të zvogëluar rrezikun e defekteve. <p>Bashkëpunimi dhe Koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi me bashkitë dhe njësitë administrative për mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe hartimin e masave parandaluese. ➤ Identifikimi i zonave me rrezik të lartë për të siguruar masa mbrojtëse dhe për të shmangur ndërprerjet e energjisë në sektorët kritikë. ➤ Garantimi i furnizimit të pandërprerë për institucionet strategjike si spitalet dhe stacionet e pompimit të ujit. <p>Ndërgjegjësimi i Publikut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Informimi i komunitetit mbi përdorimin e sigurt të energjisë dhe parandalimin e mbingarkesave. ➤ Krijimi i një mekanizmi efektiv komunikimi për njoftimet mbi mirëmbajtjen dhe ndërprerjet e planifikuara. ➤ Sigurimi i shërbimit të mbështetjes teknike për abonentët në rast të emergjencave elektrike.
<p>Drejtoria Rajonale e Kulturës</p>	<p>Planifikimi dhe Zbatimi i Masave Antisizmike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerëson riskun sizmik për objektet dhe infrastrukturën e trashëgimisë kulturore në Bashkinë Mallakastër.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Harton dhe zbaton masa specifike për forcimin strukturor dhe mbrojtjen antisizmike të objekteve të trashëgimisë kulturore, duke ndjekur standardet për mbrojtjen e trashëgimisë në zona të prekura nga risku sizmik. ➤ Krijimi i një Regjistri (Inventar) Dixhital në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për të gjitha pasuritë kulturore dhe materialet arkeologjike të ekspozuara në parqe dhe zona arkeologjike. <p>Mirëmbajtja Preventive dhe Monitorimi i Vazhdueshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Siguron mirëmbajtjen e vazhdueshme të parqeve arkeologjike, duke përfshirë: ➤ Pastrimin e vazhdueshëm të bimësisë që mund të dëmtojë strukturat e trashëgimisë. ➤ Inspektimin dhe riparimin e vogël për të shmangur dëmtimet afatgjata. ➤ Vendos sisteme monitorimi për të identifikuar në kohë shenjat e degradimit të infrastrukturës së trashëgimisë kulturore. <p>Bashkëpunimi për Ndërhyrje Investuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunon me institucione qendrore dhe vendore, organizata ndërkombëtare, dhe donatorë për të realizuar: ➤ Projekte për përmirësimin e infrastrukturës së trashëgimisë kulturore. ➤ Nisma për të integruar teknologjitë moderne në mbrojtjen e trashëgimisë (p.sh., përdorimi i sensorëve për monitorim sizmik). <p>Ndërgjegjësimi dhe Edukimi Publik:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin e komunitetit lokal mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe masat për parandalimin e dëmtimeve. ➤ Bashkëpunon me shkollat dhe qendrat kulturore për të edukuar brezat e rinj mbi vlerën e trashëgimisë kulturore dhe metodat për mbrojtjen e saj.
<p>Agjencia Rajonale e Mjedisit</p>	<p>Vlerësimi i risqeve dhe planifikimi mjedisor:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve të risqeve dhe mjedisore në rajon, duke analizuar rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe ndikimet e mundshme mbi ekosistemet dhe komunitetet ➤ Zhvillimi i strategjive për mbrojtjen e ekosistemeve që zvogëlojnë ndikimet e fatkeqësive mjedisore. ➤ Ofrimi i udhëzimeve teknike për përdorimin e tokës dhe zonimin për të minimizuar risqet mjedisore dhe

	<p>ndikimet e urbanizimit në zonat e mbrojtura.</p> <p>Monitorimi dhe Raportimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe burimeve natyrore, duke identifikuar rreziqe që mund të kërcënojnë shëndetin publik. ➤ Informimi i autoriteteve për çdo kërcënim mjedisor, si ndotje kimike apo degradim ekosistemesh. <p>Paralajmërimi i hershëm dhe masat parandaluese:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbatimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për fatkeqësi mjedisore si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës apo ndotjet masive. ➤ Hartimi dhe zbatimi i planeve për mbrojtjen dhe ruajtjen dhe restaurimin e burimeve natyrore. <p>Mbështetje dhe Ndërgjegjësim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i të dhënave dhe politikave për zvogëlimin e risqeve mjedisore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. ➤ Organizimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi risqet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit.
<p>Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit</p>	<p>Përgatitja dhe Mirëmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryen mirëmbajtjen dhe pastrimin e vazhdueshëm të kanaleve të ujitjes dhe kullimit për të parandaluar përmbytjet dhe degradimin e tokës. ➤ Identifikon zonat me rrezik për grumbullimin e ujërave dhe merr masa parandaluese për të siguruar funksionalitetin e rrjetit të kullimit. ➤ Ndërmerr masa strukturore dhe jostrukturore të nevojshme për rritjen e kapaciteteve. <p>Planifikimi dhe Koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Harton plane për menaxhimin efektiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë masat për përballimin e kushteve ekstreme të motit. ➤ Koordinon me autoritetet lokale për të siguruar që masat për ujitjen dhe kullimin janë në përputhje me planet e emergjencave civile.
<p>Shoqëria e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a</p>	<p>Sigurimi i Cilësisë së Ujit të Pijshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitoron dhe garanton kushtet higjieno-sanitare të furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën. ➤ Kryen analiza të vazhdueshme për cilësinë e ujit, duke identifikuar dhe parandaluar ndotjet që përbëjnë rrezik për shëndetin publik. ➤ Kryen menaxhimin e përgjithshëm të monitorimit të cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të ndotura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujor

	<p>sipërfaqësor ose nëntokësor pas trajtimit që duhet të kryhet nga organet e përcaktuara me ligje të veçanta.</p> <p>Parandalimi i Rreziqeve dhe Menaxhimi i Riskut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbaton masa parandaluese për të minimizuar riskun nga defektet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. ➤ Bashkëpunon me institucionet vendore për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë në kushte normale dhe emergjente.
<p>Zyra Arsimore Vendore/ Drejtoritë e Shkollave</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve/rinisë për risqet dhe masat parandaluese. ➤ Edukimin për gatishmërinë ndaj fatkeqësive në kurrikulën shkollore ➤ Identifikimi i aseteve infrastrukturore që mund të vihen në dispozicion të bashkisë Mallakastër në rast fatkeqësish. ➤ Hartimi nga çdo shkollë i një plani paraprak evakuimi dhe përcaktimi i një vendi grumbullimi për nxënësit dhe mësuesit në rast emergjence civile. ➤ Hartimi i një plani të detajuar veprimi nga stafi mësimor i shkollës për emergjencat natyrore, i cili duhet të publikohet në çdo korridor dhe në çdo kat të godinave. ➤ Vendosja e tabelave në vende të dukshme: Ndalohet pirja e duhanit, Nuk lejohet zjarr. Rreziku nga zjarri etj. ➤ Pajisja e ndërtesave me shenja evakuimi dhe drita emergjence <p>Zhvillimi i materialeve ndërgjegjësuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, librave edukativë, dhe materiale vizuale për risqet dhe masat për parandalimin e tyre. <p>Trajnimi i stafit mësimdhënës për menaxhimin e risqeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i trajnimeve për mësuesit mbi identifikimin e rreziqeve dhe rolin e tyre në edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve. <p>Monitorimi i gjendjes së infrastrukturës shkollore për rreziqe të mundshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi i problematikave strukturore që mund të shkaktojnë rrezik (shembje, rrëshqitje, zjarre, etj.) dhe raportimi për ndërhyrje të mëtejshme. <p>Organizimi i fushatave të komunitetit për ndërgjegjësim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Angazhimi i shkollave në aktivitete komunitare për ndërgjegjësimin e familjeve dhe banorëve për masat parandaluese. <p>Promovimi i projekteve shkollore për qëndrueshmërinë mjedisore:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetja e aktiviteteve që inkurajojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e faktorëve që mund të rrisin risqet, si pyllëzimi dhe zvogëlimi i ndotjes.
<p>Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One)</p>	<p>Mirëmbajtja e Rrjetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i funksionalitetit të vazhdueshëm të rrjeteve telekomunikuese për të shmangur ndërprerjet. <p>Mbështetja e Paralajmërimit të Hershëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me Bashkinë për shpërndarjen e paralajmërimeve dhe njoftimeve emergjente përmes rrjeteve ekzistuese. <p>Sigurimi i Infrastrukturës Kritike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi dhe parandalimi i dëmtimeve në pikat kritike të rrjetit telekomunikues. <p>Koordinimi me Bashkinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesëmarrja në takime dhe shkëmbimi i informacionit mbi kapacitetet e telekomunikacionit në raste emergjencash. <p>Ndërgjegjësimi i Popullatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me Bashkinë për të informuar komunitetin mbi përdorimin e rrjeteve të telekomunikacionit në situata të rrezikut.
<p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor</p>	<p>Vlerësimi i Riskut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe përditësimi i dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, për institucionet shëndetësore në nivel qarku. ➤ Identifikimi i risqeve që mund të ndikojnë në funksionimin e spitaleve dhe hartimi i masave parandaluese për adresimin e tyre. <p>Parandalimi i Ndikimeve Shëndetësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i masave parandaluese për zvogëlimin e riskut të ndërprerjeve të shërbimeve mjekësore në rast fatkeqësish. ➤ Hartimi dhe zbatimi i protokolleve për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve që ndikojnë në shëndetin publik, si përhapja e sëmundjeve ngjitëse. <p>Ndërgjegjësimi i Komunitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me autoritetet vendore për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi masat parandaluese për fatkeqësitë shëndetësore. ➤ Ofrimi i udhëzimeve për popullatën mbi menaxhimin e situatave emergjente shëndetësore (p.sh., kujdesi për të moshuarit, menaxhimi i sëmundjeve kronike gjatë emergjencave).
<p>Qendrat Shëndetësore/Ambulancat</p>	<p>Edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Promovimi i informacioneve mbi masat e parandalimit,

	<p>si: edukimi në lidhje me rreziqet e shëndetit, higjienën, ushqyerjen e shëndetshme, shmangien e duhanpirjes, etj.</p> <p>Përgatitja dhe trajnimi i stafit mjekësor dhe të qytetarëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i trajnimeve të rregullta për mjekët, infermierët dhe personelin e urgjencës për të njohur dhe reaguar ndaj situatave të mundshme emergjente, si dhe përgatitja e popullsisë për përdorimin e teknikave bazë të ndihmës së shpejtë. <p>Identifikimi i grupeve të rrezikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi i grupeve të rrezikuara si: personat me sëmundje kronike, të moshuarit, grate shtatzëna, dhe fëmijët, për t'i siguruar ata me mbështetje dhe masa parandaluese. <p>Menaxhimi i infrastrukturës shëndetësore dhe emergjente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për trajtimin e shpejtë dhe efikas të emergjencave. <p>Koordinimi me institucionet dhe strukturat e tjera vendore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me strukturat e policisë dhe zjarrfikësit, për të zhvilluar plane të përbashkëta për parandalimin e situatave emergjente. <p>Ndihma në mbrojtjen e shëndetit publik:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive përmes vaksinimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të grupeve me rrezik të lartë.
<p>Spitali Përmet, Spitali Rajonal Gjirokastrë</p>	<p>Edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i fushatave për informimin dhe edukimin e komunitetit mbi rreziqet shëndetësore dhe mënyrat për t'i parandaluar ato. <p>Promovimi i shëndetit të përgjithshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i aktiviteteve edukative për parandalimin e sëmundjeve kronike. <p>Trajnimi i personelit shëndetësor:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerje e trajnimeve të rregullta për mjekët, infermierët dhe stafin tjetër shëndetësor. <p>Mbikëqyrja e sëmundjeve infektive dhe epidemive:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimin e rasteve të sëmundjeve infektive. <p>Përmirësimi i infrastrukturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Marrja e masave për përshtatjen e infrastrukturës së tyre për të menaxhuar fluksin e mundshëm të pacientëve në rast emergjencash.
<p>Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Përmet</p>	<p>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i fushatave të informimit mbi masat

	<p>parandaluese për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive të shkaktuara nga rreziqet natyrore dhe në veçanti, emergjencave shëndetësore.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Promovimi i sjelljeve të sigurta dhe masave vetëmbrojtëse, duke ndihmuar komunitetet të zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve. <p>Mbështetja e Strukturave Vendore për Zvogëlimin e Riskut.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Këshillimi i institucioneve lokale për përcaktimin e masave të duhura parandaluese, bazuar në vlerësimin e riskut. ➤ Bashkëpunimi me komunitetet për të identifikuar faktorët e riskut dhe për të promovuar masa mbrojtëse afatgjata. ➤ Bashkëpunimi me Institucionet Shtetërore dhe Organizatat Ndërkombëtare. ➤ Kontribut në përcaktimin e prioriteteve për zvogëlimin e riskut në nivel vendor dhe kombëtar. ➤ Shpërndarja e udhëzimeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të adaptuara për realitetin lokal.
<p>Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër / Komisariati Policisë Përmet</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe zbatimi i planeve për menaxhimin e sigurisë dhe rendit publik në rastet e rreziqeve të identifikuar. ➤ Identifikimi dhe monitorimi i zonave të ndjeshme nga kërcënimet e mundshme për sigurinë publike. ➤ Sensibilizimi i komunitetit për rëndësinë e sigurisë dhe masat parandaluese në rast fatkeqësish. ➤ Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe institucionet përkatëse për të koordinuar masat parandaluese dhe lehtësuese në komunitet.

5. Gatishmëria

5.1 Analiza Riskut për Bashkinë Përmet

Bashkia e Përmet përballet me disa risqe të rëndësishme që kërkojnë vlerësim të plotë dhe planifikim proaktiv. Më poshtë vijon një përmbledhje e gjashtë risqeve kryesore të identifikuara nga VRFNV në bashkinë e Mallakastrës duke reflektuar terrenin lokal, të dhënat historike dhe faktorët socio-ekonomikë, në funksion të ndërtimit të një SVZRF efikase. *(Një analizë e Riskut për Bashkinë Përmet jepet në VRFNV)*

Risku Biologjik

Rreziqet biologjike në bashkinë Përmet lindin kryesisht nga përhapja e mundshme e sëmundjeve infektive, të theksuara ndjeshëm gjatë pandemisë COVID-19 (gjatë të cilës humbën jetën 33 persona). Bashkia duhet të jetë e përgatitur për riskun nga shpërthimet epidemike që mund të ndodhin për shkak të patogjenëve nga kafshët që prekin popullatat njerëzore. Sfidat e menaxhimit të këtij risku kërkojnë hartimin e strategjive efektive duke pasur parasysh dendësinë e popullsisë, statusin shëndetësor dhe karakteristikat patogjene për të zbutur në mënyrë efikase shpërthimet e mundshme.

Risku nga përmytjet

Përmytjet përfaqësojnë një risk të konsiderueshëm të bashkisë Përmet që përkeqësohet nga faktorë mjedisorë dhe njerëzorë. Risku nga përmytjet vlerësohet i ulët deri në mesatar në shumicën e njësive administrative, me përjashtim të njësisë Përmet, ku konsiderohet i lartë. Përmytjet mund të dëmtojnë rëndë ekonominë lokale dhe të zhvendosin popullsinë.

Risku nga përmytjet vjen kryesisht për shkak të daljeve nga shtrati të Vjosës dhe Përroit të Bardhë si dhe dëmtimeve të mundshme të digave.

Risku i rrëshqitjes së tokës

Shtrirja gjeografike e Bashkisë Përmet është kryesisht kodrinore e malore dhe paraqet sfida specifike në lidhje me rrëshqitjet e dherave, çka e ka vendosur riskun nga rrëshqitjet e tokës si të moderuar, me përjashtim të disa zonave, ndër të cilat përjashtim bën Njësia Administrative Përmet, ku risku është i ulët.

Risku Sizmik

Kërcënimi sizmik në bashkinë Përmet është evident për shkak të vendndodhjes së tij në një zone sizmike aktive. Tërmetet e forta kanë ndikuar historikisht në rajon, me ngjarjet e kaluara që tregojnë ndjeshmëri ndaj lëkundjeve të konsiderueshme të tokës. Për sa i takon gatishmërisë së infrastrukturës, për shkak të vjetërsisë dhe cilësisë së ndërtimit të ndërtesave ekzistuese, humbjet e mundshme ekonomike nga ngjarjet sizmike janë të konsiderueshme, duke bërë të nevojshme vlerësimet e Riskut të fokusuar në rritjen e aftësisë ripërtëritëse.

Risku teknologjik

Potenciali për efekte kaskadë nga fatkeqësitë natyrore (p.sh., tërmetet që shkaktojnë aksidente industriale) kërkon një

planifikim gjithëpërfshirës të emergjencës. Megjithëse gjasat për fatkeqësi të rëndësishme teknologjike janë përgjithësisht të ulëta, pasojat mund të jenë të rënda nëse ndodhin fatkeqësi, prandaj masat e rrepta të sigurisë janë vendimtare.

Risku nga zjarret në pyje

Risku i zjarrit në Bashkinë Përmet kërkon vlerësim të kujdesshëm, veçanërisht lidhur me menaxhimin e pyjeve dhe bimësisë. Risku nga zjarret është i moderuar në territorin e bashkisë. Vlerësimet afatgjata të riskut nga zjarri, së bashku me strategjitë e gatishmërisë së menjëhershme gjatë sezonit të zjarrit, do të rrisin aftësinë e bashkisë për të menaxhuar dhe për t'iu përgjigjur kërcënimeve nga zjarri.

5.2 / Informimi dhe ndërgjegjësimi publik

Komunikimi është një element kyç gjatë situatave emergjente. Ai shërben për të garantuar sigurinë e popullatës, rrit besimin e publikut dhe redukton ndjeshëm situatat e panikut. Për këtë arsye, informacioni duhet të jetë i qartë, i saktë dhe në kohë reale, si për banorët e kërcënuar nga rreziku, ashtu edhe për çdo palë tjetër të përfshirë në proces. Në vijim PVEC paraqet strategjitë kryesore për koordinimin ndërinstitucional dhe komunikimin me publikun në kuadër të PVEC të bashkisë Përmet.

Komunikimi ndërinstitucional

Gjatë emergjencave është e rëndësishme që të gjitha institucionet e përfshira (qeverisja vendore, SHUM, kujdesi shëndetësor dhe agjencitë kombëtare) të komunikojnë në mënyrë efektive. Në bazë të VKM nr. 923, datë 25.11.2020, pika nr. 17: “*Komunikimi me publikun në rastet e emergjencave/fatkeqësive natyrore kryhet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile*”.

Komunikimi ndërinstitucional siguron:

- ✚ *Unifikimin e informacionit:* Institucionet e përfshira në menaxhimin e emergjencave duhet të shpërndajnë informacion të unifikuar për të shmangur dezinformimin.
- ✚ *Rolet e qarta:* Asnjë institucion nuk duhet të japë informacion të pakoordinuar me partnerët e tjerë.


Prandaj, protokollat e komunikimit duhet të paracaktohen ndërmjet tyre. (shih tabelën më poshtë)

- ✚ *Koordinimi i centralizuar:* është shumë e rëndësishme të krijohet një qendër për të menaxhuar informacionin që vjen nga institucionet e tjera që veprojnë në koordinim. Kjo siguron që mesazhet të jenë të qarta dhe pa keqkuptime.
- ✚ *Përdorimi i teknologjisë:* Platformat dixhitale ose sistemet e brendshme të komunikimit mund të lehtësojnë ndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve.
- ✚ *Pajisje radiomarrëse:* Në raste emergjente mund të ndërpritet energjia elektrike, jo vetëm për zonën e prekur nga fatkeqësia, por edhe më gjerë, duke përfshirë antenat e operatorëve celularë. Mbyllja e këtyre kanaleve të komunikimit e bën edhe më të vështirë situatën e emergjencës. Prandaj, është e nevojshme që të gjitha institucionet të

pajisen me një numër të caktuar radiomarrësish me vale të gjata të cilat duhet të testohen periodikisht.

Figura 6 shërben si udhëzues për rrjedhën e informacionit për situatat para emergjencave dhe në rastet kur përgjigja ndaj fatkeqësive/emergjencave ka filluar dhe vazhdon.

Figura 6: Protokoll i Komunikimit gjatë Emergjencave Civile



🚒 Popullsia < Bashkia < Prefektura Gjirokastër < AKMC

🚒 AKMC < Ministria e Mbrojtjes < Komiteti i Mbrojtjes Civile < Bashkia

Shigjetat e kuqe përfaqësojnë pas fillimit të emergjencës(ave) dhe sipas nivelit të alarmit, ai mund të zgjerohet nga institucioni në institucion.

🚒 Bashkia/Prefektura < AKMC < Ministria e Mbrojtjes < Këshilli i Ministrave

Fushata ndërgjegjësuese

Është thelbësore që popullata të informohet periodikisht. Në fund të sezonit të verës në periudhën Shtator - Tetor duhet të bëhen fushata ndërgjegjësimi me komunitetin lidhur me reshjet / stuhitë / përmytjet për periudhën vjeshtë - dimër, kurse në fund të muajit Shkurt dhe fillim në të Marsit për reshjet gjatë sezonit të pranverës. Ndërsa për zjarret që mund të ndodhin gjatë stinës së verës, fushatat e ndërgjegjësimit me komunitetin duhet të zhvillohen qysh gjatë muajit Maj e në vazhdim. Qëllimi i saj është të informojë popullatën për kërcënimet e ardhshme, si të parandalohen rreziqet tashmë të njohura në kohë reale, sipas një protokollit të detajuar, i cili përfshin institucionet publike hap pas hapi. Gjithashtu, bashkia Përmet duhet të informojë banorët me postera dhe fletëpalosje të shpërndara në të gjithë zonën ku operon (*Shih Kreu 4.2*). Fushata informimi duhen ndërmarrë edhe me institucionet arsimore për të kultivuar parimin e parandalimit të kërcënimeve nga risqet e fatkeqësive.

Në funksion të këtyre fushatave, bashkia e Përmet, në bashkëpunim me AKMC, të nënshkruajnë një marrëveshje me operatorët celularë në Shqipëri për të dërguar një SMS në çdo pajisje të lidhur në rrjetin celular në raste emergjencash, për të përgatitur popullatën dhe për t'i mbajtur të informuar vazhdimisht për kërcënimet nga risqet e ndryshme.

Komunikimi me publikun gjatë një emergjence

Komunikimi publik është një aspekt shumë i rëndësishëm përpara dhe gjatë emergjencave. Informacioni i dhënë gjatë kësaj kohe parandalon përhapjen e panikut. Megjithatë duhet të bëhet kujdes që publikut jo vetëm t'i ofrohet informacioni i duhur por edhe në kohën e duhur. Në rast emergjence, popullata duhet të informohet për nivelin e riskut, masat që duhen marrë dhe procedurat për evakuim, nëse është e nevojshme.

Njoftimi i popullatës në rast emergjence jepet nga Sektori që mbulon çështjet e MC/QOECB Përmet kur ajo është e aktivizuar, i cili /e cila duhet të sigurohet të shmangë situatat e alarmit të panevojshëm. Gjithashtu, jo të gjitha informacionet duhet të ndahen me publikun, për shkak të aftësive të ulëta që ata kanë në analizimin e situatës dhe për pasojë mund të shkaktojnë panik.

- ✓ Informacioni duhet të vijë drejtpërdrejt nga përfaqësues/zyrtarë të institucioneve publike.
- ✓ Informacioni i përzgjedhur për transmetim duhet të miratohet nga autoritetet përkatëse, si në nivel qarku ashtu dhe në nivel qendror (QKOEK pranë AKMC-së). Nuk duhet të transmetohet më shumë informacion sesa ai i miratuar, për të shmangur keqkuptimet.
- ✓ Gjuha e përdorur duhet të tregojë se autoritetet janë të përgatitura për t'u marrë me një situatë të tillë dhe se janë marrë masat e duhura.
- ✓ Ndonëse është e rëndësishme të shmangët paniku, kjo nuk duhet të komprometojë transparencën në lidhje me rreziqet reale. Të gjitha kërcënimet duhet të bëhen publike. Në të kundërtën do të cenohet besueshmëria e institucioneve.
- ✓ Rekomandohet që koordinatori të caktuar për informimin publik t'i ruhet qëndrueshmëria në detyrë, për të siguruar vazhdimësinë dhe saktësinë e komunikimit.

Ndryshimi i koordinatorit duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur situata e kërkon dhe një autoritet tjetër e merr përsipër këtë përgjegjësi. Një ndryshim i paarsyeshëm mund të shkaktojë konfuzion dhe të ndikojë negativisht në besimin e publikut.

- ✓ Pasi të përcaktohet natyra e informacionit, ai duhet të transmetohet përmes kanaleve më të njohura dhe më të aksesueshme nga popullata, si televizioni, radio, rrjetet sociale, SMS, etj.

Plani i komunikimit dhe fazat e emergjencës

Çdo institucion duhet të hartojë një plan komunikimi, bazuar në strukturat e sipërpërmendura.

Këtij plani duhet t'i shtohen hapat e nevojshëm.

- ✓ Përpara emergjencës (*Parandalim/Gatishmëri*): Duhet të transmetohen mesazhe për gatishmërinë dhe edukimin e popullatës për kërcënimet e mundshme, të njohura dhe të panjohura.
- ✓ Emergjencia (*Përgjigje*): Çdo informacion duhet të jetë i qartë dhe të ofrojë një pasqyrë të gjerë të situatës, sigurisë, planit të masave dhe veprimeve konkrete që do të ndërmerren. Është e rëndësishme që publiku të mos marrë shumë informacion menjëherë.
- ✓ Përshkallëzimi i emergjencës (*Përgjigje*): Vetëm në këtë rast duhet të rritet frekuenca e komunikimit, duke transmetuar përditësime më të detajuara me tone të qeta.
- ✓ Pas emergjencës (*Rimëkëmbje*): Në këtë fazë transmetohet informacioni për rehabilitimin/rimëkëmbjen, normalitetin e shërbimeve publike dhe pasojat afatgjata (nëse ka).

Komunikimi para emergjencës

Përgatitja është çelësi për një përgjigje efektive emergjente. Komunikimi publik përpara se të ndodhë një emergjencë mund të zvogëlojë ndjeshëm risqet dhe të rrisë aftësinë ripërtëritëse të komunitetit. Komunikimi para emergjencës duhet të fokusohet në:

- ✓ *Fushatat e ndërgjegjësimit publik*: Edukimi i publikut për rreziqet/risqet e mundshme dhe rëndësinë e gatishmërisë përmes fushatave të vazhdueshme.
- ✓ *Trajnime dhe stërvitje*: Aktivitetet e angazhimit publik, të tilla si stërvitjet dhe sesionet e trajnimit, do të ndihmojnë në njohjen e publikut me rrugët e evakuimit, kontaktet emergjente dhe masat e ndihmës së parë.
- ✓ *Bashkëpunimi me drejtuesit lokalë*: Partneriteti me drejtuesit e komunitetit lokal për të shpërndarë informacionin e gatishmërisë emergjente siguron kontakt më të mirë me komunitetet.
- ✓ Duke kultivuar një kulturë gatishmërie, publiku do të ketë më shumë gjasa të ndjekë udhëzimet gjatë një emergjence aktuale, duke minimizuar panikun dhe konfuzionin.

Fluksi i informacionit dhe fazat e emergjencës

Plani i komunikimit duhet të pasqyrojë fazat e ndryshme të një emergjence:

- ✓ *Parandalimi dhe Gatishmëria* – Fokusimi në mesazhet e gatishmërisë dhe edukimit për risqet.
- ✓ *Përgjigja* – Sigurimi i informacionit të menjëhershëm dhe të qartë për situatën, masat e sigurisë dhe veprimet e reagimit. Shmangia e ngarkesës së publikut me shumë informacione në të njëjtën kohë. Rritja e frekuencës së komunikimit ndërsa situata evoluon, duke ofruar përditësime të detajuara dhe duke ruajtur qetësinë.
- ✓ *Rimëkëmbja* (ose situata post-emergjencë) – Dhënia e informacionit mbi përpjekjet për rimëkëmbje, shërbimet publike dhe çdo ndikim afatgjatë. Garantimi i publikut dhe inkurajimi i nismave për rimëkëmbjen e komunitetit.

Angazhimi i komunitetit

Përfshirja e komunitetit në PVEC është jetike për zbatimin e suksesshëm të Planit. Strategjitë e angazhimit duhet të përfshijnë:

- ✓ *Ndërtimi i besimit*. Lejimin e publikut për të bërë pyetje ose për të dhënë komente gjatë dhe pas emergjencave ndërton besimin dhe ofron njohuri të vlefshme për të ardhmen.
- ✓ *Vullnetarët e komunitetit*. Trajnimi i vullnetarëve lokalë të cilët mund të veprojnë si ndërlidhës komunikimi ndërmjet autoriteteve dhe anëtarëve të komunitetit në lagjet e tyre.
- ✓ *Angazhimi gjithëpërfshirës*. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet garantimit që të gjitha grupet demografike, përfshirë popullsinë e marginalizuar, të përfshihen në përpjekjet e komunikimit dhe angazhimit.

5.3 / Masat e gatishmërisë

Faza e *Gatishmërisë* në ciklin e MEC lidhet me njohuritë dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, si dhe të komunitetit për t'iu përgjigjur fatkeqësive të mundshme. PVEC i bashkisë Mallakastër është një mjet operacional për MEC bazuar në njohuritë e marra dhe organizimin e miratuar përpara se të ndodhë ngjarja.

Faza e *Gatishmërisë*, përbëhet nga shtatë komponentë kryesorë:

- ✓ Informimi dhe edukimi lidhur me risqet kryesore me të cilat përballet bashkia Përmet, bazuar edhe në VRFNV.
- ✓ Sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe komunikimi i emergjencave përfshijnë zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi risqet, përmirësimin e kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, si dhe sigurimin e aksesit gjithëpërfshirës në informacion për të gjitha grupet e popullsisë, veçanërisht për grupet e cenueshme.

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor, trajnimi dhe stërvitjet e vazhdueshme për t'u përballur me skenarët më të mundshëm të emergjencave civile në nivel bashkie.
- ✓ Lokalizimi, përgjigja dhe përgatitja janë një tjetër komponent i fazës së gatishmërisë që lidhet me përgatitjen e kapaciteteve, testimin e gatishmërisë së tyre.
- ✓ Vlerësimi i riskut (VRFNV) i kryer paraprakisht është një prej dokumenteve bazë të identifikimit të kërcënimeve dhe të shkallës së tyre.
- ✓ Vazhdimësia e shërbimeve lidhet me nevojën që të gjitha bizneset në territorin e bashkisë dhe shërbimet e institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë, të ruajnë vijimësinë e tyre në mënyrë sa më praktike dhe të sigurt të jetë e mundur.
- ✓ Partneritetet: fuqizimi i bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve përgjegjës për emergjencat civile si dhe rritja e bashkëpunimit me grupet vullnetare dhe komunitetet vendore në përgjithësi.

Figura 7: Buletini ditor nga IGJEO mbi parashikimin e rrezikut hidro-meteorologjik

Niveli i Rrezikut	Rrëshje shiu (mm / 24 orë)
S'ka rrezik	të dobëta (0-15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ulët	mesatare (15-45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I moderuar	intensive (45-90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike
I lartë	shumë intensive (>90 mm / 24 orë) Moti është i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike mjaft intensive.

Legjenda: Rrëshjet 24-orëshe

Figura 8: Rreziku i zjarreve në pyje - Buletini ditor i IGJEO

S'ka rrezik	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
I ulët	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I moderuar	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I lartë	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

Legjenda: Zjarre në pyje

Në nivel vendor, roli më i rëndësishëm i bashkisë është shpërndarja e sinjalizimeve meteorologjike. Pas një alarmi meteorologjik, bashkia Përmet ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- ✓ Komunikon alarmin meteorologjik tek strukturat operacionale, administrative dhe vullnetare;
- ✓ Aktivizon informacionin paraprak për popullatën në lidhje me alarmin dhe skenarët e tij. Ofron këshilla për rregullat e vetëmbrojtjes dhe kanalet zyrtare të informacionit;
- ✓ Kontrollon gatishmërinë e shërbimeve teknike bashkiake për të garantuar aktivizimin e menjëhershëm të tyre në rastin e emergjencës;
- ✓ Kontrollon disponueshmërinë e shoqatave vullnetare vendore;
- ✓ Verifikon disponueshmërinë e burimeve shtesë (publike ose private) të pranishme në territor;
- ✓ Verifikon nevojën për aktivizimin e QOECB;
- ✓ Verifikon kushtet specifike të cënueshmërisë të strukturave kritike ose përkohshme (p.sh. ngjarje ose punime) dhe aktivizon masat parandaluese të sigurisë ose bllokimin e zonave me risk të lartë;
- ✓ Verifikon funksionimin e sistemeve teknologjike e lidhjeve telefonike dhe rrjetit të QOECB;
- ✓ Ndjek zhvillimin e emergjencës, për të aktivizuar të gjitha resurset që në fazat fillestare të emergjencës;
- ✓ Informon prefekturën për çdo veprim operacional të ndërmarrë;

Mjetet që do të përdoren për të shpërndarë sinjalizimet janë si më poshtë:

- ✓ Televizioni dhe media e shkruar
- ✓ Buletinet radiofonike
- ✓ Mesazhe zanore nga ndërtesat fetare (kisha, xhami, etj.)
- ✓ Media sociale
- ✓ SMS dhe e-mail celular
- ✓ Njoftimet e komunitetit
- ✓ Njoftimet përmes automjeteve nga policia/Forcat e Armatosura/Kryqi i Kuq
- ✓ Ekrane publike dhe tabela
- ✓ Sinjalet tymuese ose fluturuese.

5.4 Qendrat e Koordinimit dhe zonat e paracaktuara për evakuim dhe përdorimin e tyre për aktivitete në funksion të përgjigjes në raste të emergjencave civile

Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në territorin e bashkisë, aktivizohet menjëherë QOECB. Kryetari i bashkisë emëron një Koordinator të QOECB dhe personelin me përgjegjësi ditore të menaxhimit të situatës. Kryetari i Bashkisë cakton me urdhër DOB që është përgjegjës për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë në territorin e bashkisë.

Në rastet kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, vendimi për aktivizimin e QOECB merret nga kryetari i bashkisë/KMKB në bashkërendim me prefektin dhe AKMC-në, bazuar në ashpërsinë e fatkeqësisë së pritshme dhe në kapacitetet e disponueshme. Kjo qendër

është përgjegjëse për koordinimin e burimeve dhe asistencën për popullatën. Në varësi të situatës, në QOECB mund të atashohen përfaqësues të institucioneve të përfshira në menaxhimin e situatës.

Për të zgjedhur një vendndodhje të përshtatshme të ambientit të një qendre operacionale të emergjencës, është e nevojshme të merren në konsideratë jo vetëm elementët strukture të godinës, por edhe karakteristikat gjeomorfologjike përreth, përshtatshmërinë nga pikëpamja hidrogeologjike, kushtet e amplifikimit të vendit në rast tërmeti, kushtet e rrezikshmërisë nga rrëshqitjet/instabiliteti i shpatit, lëngëzimi i tokës dhe risku hidraulik, si dhe elementët që burojnë nga risqet antropike.

Qendra Operacionale e Emergjencave Civile e bashkisë Përmet ndodhet brenda godinës së bashkisë. Qendra do të shërbejë si vend ku do të mbledhen gjithë aktorët përkatës në rast emergjencash. Në QO do të marrin pjesë aktorë të ndryshëm sipas detyrave të tyre përkatëse siç janë: Shtabi i Bashkisë për EC, përfaqësues të rendit publik, shëndetësisë dhe arsimit.

Zonat e emergjencës dhe kriteret për identifikimin e tyre

Zonat e emergjencës janë vendndodhje të identifikuara paraprakisht si të përshtatshme për aktivitetet e MC në raste emergjencash ose fatkeqësish. Ato identifikohen paraprakisht në PVEC. Në kuadër të kompetencave të tyre, autoritetet vendore identifikojnë:

- ✓ Zonat dhe qendrat e ndihmës për popullsinë (vendet e pritjes, akomodimit dhe të strehimit të popullsisë së evakuuar ose të shpërngulur nga banesat e tyre për shkak të emergjencës), të cilat mund të jenë terrene të hapura në të cilat ngrihen strukturat për ndihmën e popullsisë së prekur nga një ngjarje emergjente ose të mbyllura (Palestra shkollash, pallate sporti, hotele).
- ✓ Zonat për grumbullimin e personelit që merret me shpëtimin e popullsisë, materialeve pajisjeve, mjeteve, automjeteve të tyre, në të cilat të kanalizohen personeli që merret me shpëtimin, burimet dhe automjetet e nevojshme për shpëtimin e popullsisë;
- ✓ Pikat e hyrjes për burimet (personel, pajisje, mjete, automjete), në të cilat të priten dhe regjistrohen kolonat e shpëtimit, që vijnë nga zona të jashtme, duke lejuar më pas kalimin e tyre drejt zonës së prekur;
- ✓ Zonat e uljes emergjente, të nevojshme për të arritur pjesë të territorit që janë të vështira për të arritur dhe në të cilat planifikohet ulja e mjeteve ajrore.

Zonat e emergjencës duhet të vendosen në vende që nuk janë subjekt rreziku, duke shmangur për shembull zonat e përmbytjeve, zonat pranë shpateve të paqëndrueshme, shembjet e strukturave ngjitur, në rrezik zjarresh në pyje. Të gjitha zonat duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme edhe nga automjete të mëdha. Numri i zonave që përzgjidhen varet nga disponueshmëria në territor, numri i banorëve dhe shtrirja e bashkisë.

Zonat e Pritjes

Janë zonat ku në momentet menjëherë pas fatkeqësisë, do të grumbullohen njerëzit të cilët janë larguar nga banesat e tyre pas ngjarjes ose pas dhënies së urdhërit për tu evakuuar nga zona kur ka ndodhur fatkeqësia në të cilat garantohet ndihma e parë për popullatën, në pritje të përgatitjes së vendeve të strehimit ose kthimit në kushte normale të jetesës. Këto zona duhen të jenë të sigurta. Zonat e pritjes do të përdoren për një periudhë kohore nga disa orë në disa ditë.

Zonat e ndihmës ose qendrat e akomodimit/strehimit të popullsisë

Këto hapësira i dedikohen menaxhimit të popullsisë për periudha që variojnë nga disa javë deri në disa muaj. Zona të ndihmës për popullsinë janë zonat me një minimum zhvillimi urban dhe infrastrukture (ujë, kanalizim, energji elektrike) në të cilat është e mundur ngritja e një kampi të përkohshëm strehimi. Për një kamp të përkohshëm strehimi tendash me 250 shtretër nevojiten përafërsisht 6000 m². Qendra e akomodimit/strehimit të popullsisë konsiderohen strukturat ekzistuese publike ose private që përmbushin nevojat për strehim të popullsisë (hotele, qendra sportive, objekte ushtarake, shkolla, kampingje etj.).

Qendra e akomodimit/strehimit të popullsisë konsiderohen strukturat ekzistuese publike ose private që përmbushin nevojat për strehim të popullsisë (hotele, qendra sportive, objekte ushtarake, shkolla, kampingje etj.). Preferohet që zonat dhe qendrat e asistencës të kenë afër hapësira të lira të përshtatshme për një zgjerim të mundshëm dhe për të siguruar ruajtjen e materialeve mbështetëse të aktivitetit të tyre.

Zonat për grumbullimin e personelit që merret me shpëtimin e popullsisë, materialeve pajisjeve, mjeteve, automjeteve të tyre

Zonat e grumbullimit të burimeve emergjente dhe ekipeve të shpëtimit janë zonat ku dislokohen/magazinohen burimet dhe forcat operationale për të mbështetur autoritetin lokal në operationet e shpëtimit. Këto zona duhet të jenë veçanërisht të mëdha (minimumi 6000 m²) dhe të kenë një karrexhatë sepse duhet të lejojnë parkimin e shumë kamionëve dhe trajtimin e mallrave me anë të pajisjeve ngritëse. Bashkia Përmet duhet të identifikojë vetëm një zone të tillë për ekipet e shpëtimit dhe ruajtjen e burimeve të ndihmës emergjente.

Zonat e uljes emergjente

Zona të përshtatshme për ulje emergjente të helikopterëve. Këto zona duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- ✓ Sipërfaqe pa pengesa (tokë dhe ajër), e sheshtë, me përmasa minimale 40m x 40m;
- ✓ Prania e barit kompakt ose toka asfalti/betoni;

- ✓ Nuk ka pengesa fluturuese në afërsi (p.sh. pemë të larta, shtylla elektrike, kulla, ndërtesa mbi 2 kate dhe kambanore);
- ✓ Prania e lidhjeve rrugore me vendet e koordinimit dhe ndërtesat strategjike.

Lista dhe karakteristikat e zonave të emergjencës paraqiten tek Aneksi: Zonat e Emergjencës

5.5 / Strukturat dhe institucionet përgjegjëse për Gatishmërinë në nivel bashkie

Tabela 2: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e gatishmërisë – Bashkia Përmet

Institucionet, strukturat dhe palët e përfshira	Përgjegjësitë në fazën e Gatishmërisë
Institucione dhe struktura në nivel bashkie	
Sektori i Mbrojtjes Civile Policia Bashkiake	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillon dhe përditëson PVEC. ➤ Organizon dhe koordinon stërvitjet dhe simulimet e gatishmërisë ndaj fatkeqësive duke përfshirë komunitetin dhe institucionet lokale. ➤ Mban një inventar të burimeve dhe furnizimeve emergjente për përgjigjen ndaj situatave emergjente. ➤ Vlerësoni gatishmërinë e ekipeve të reagimit ndaj emergjencave dhe përgatit ato për ndërhyrje në situata të ndryshme emergjente civile. ➤ Koordinon forcat mbështetëse të shpëtimit dhe të ndihmës së pare për të siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv gjatë emergjencave. ➤ Siguron logjistikë për furnizimin me materiale dhe pajisje emergjente për të mbështetur ekipet e shpëtimit dhe për të përmbushur nevojat kritike gjatë emergjencave.
Drejtoria e financë – buxhetit, burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse. Sektori i Financës - Buxhetit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndan buxhetet për aktivitetet e gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe përmirësimet e infrastrukturës. ➤ Krijon paraprakisht një sistem mbrojtjeje, trajtimi financiar, punësimi, mbështetjeje dhe përkujdesjeje sociale për grupet e cënueshme dhe për personat që për shkak të një emergjence civile humbasin masivisht strehimin dhe punën. ➤ Siguron fonde nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare për iniciativa gatishmërie. ➤ Krijon mekanizma financiarë për shpërndarje të shpejtë gjatë emergjencave. ➤ Monitoron dhe auditon fondet e alokuara për projektet e gatishmërisë.

<p>Drejtoria e Përfshirjes Sociale Sektori i Çështjeve Sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikon gupet e cenueshme dhe nevojat e tyre specifike gjatë emergjencave ➤ Kryen trajnime të vazhdueshme të stafit. ➤ Zhvillon një bazë të dhënash të burimeve të shërbimeve sociale për reagimin ndaj emergjencave ➤ Harton dhe vendos paraprakisht një sistem mbrojtjeje, trajtimi, asistence sociale për grupet e cenueshme për shkak të emergjencës civile. ➤ Zhvillon dhe zbaton mjetet, protokollet dhe udhëzimet e nevojshme që rregullojnë përgjegjësinë për mbrojtjen sociale. ➤ Vlerësimi i nevojave sociale të popullsisë në zonat me rrezik të lartë, për të identifikuar individët dhe grupet që mund të kenë nevoja të veçanta gjatë një emergjence.
<p>Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit</p> <p>Sektori Urbanistikës dhe Planifikimit të territorit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet që lidhen me emergjencat civile, duke siguruar që këto sisteme të jenë funksionale dhe të testuara rregullisht. ➤ Monitoron zbatimin e kodeve të ndërtimit dhe rregulloreve të përdorimit të tokës sipas standardeve të përcaktuara, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për të siguruar që ndërtesat dhe infrastruktura të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive. ➤ Kryerja e vlerësimeve të riskut për zhvillime të reja për të zvogëluar ekspozimin ndaj rreziqeve. ➤ Bashkëpunon dhe koordinon me palët e tjera të interesuara për të siguruar që planet urbane dhe burimet logjistike mbështesin gatishmërinë ndaj emergjencave.
<p>Sektori Mbrojtjes Civile, Policia Bashkiake Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikon dhe monitoron ndërtimet në zonat me risk të lartë për të siguruar zbatimin e masave të sigurisë dhe minimizimin e risqeve gjatë emergjencave civile. ➤ Monitoron dhe inspekton përdorimin e tokës për të siguruar që aktivitetet e zhvillimit dhe të ndërtimit të jenë dhe të përputhshme me standardet e gatishmërisë për emergjencat civile. ➤ Pajisja e objekteve me shenja evakuimi dhe llamba emergjence. ➤ Siguron mirëmbajtjen e rrugëve të hapura të transportit dhe garanton aksesin e rrugëve përmes shërbimeve të trafikut rrugor. ➤ Fushata sensibilizuese dhe garantimi i sigurisë rrugore dhe transportit në bashkëpunim me policinë e shtetit. ➤ Asistencë në vendosjen e komunikimit nëpërmjet radiove.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Siguron koordinimin me Policinë e Shtetit për të garantuar lëvizjen e sigurt të mjeteve dhe stafit emergjent gjatë situatave të gatishmërisë dhe përgatitjes për emergjenca civile. Ngritja e strukturave të përkohshme për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit që lidhet me emergjencat civile. ➤ Është përgjegjës për aktivizimin e masës së gatishmërisë përgjatë rrugëve dhe infrastrukturës ku është lëshuar një alarm
<p>Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi që zjarrfikësit dhe personeli i shpëtimit të marrin trajnime të rregullta mbi teknikat, pajisjet dhe protokollet më të fundit. ➤ Kryerja e stërvitjeve të rregullta të zjarrit dhe shpëtimit për të testuar gatishmërinë dhe për të përmirësuar procedurat. ➤ Inspektimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zjarrfikësve, automjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse për t'u siguruar që ato janë funksionale gjatë gjithë kohës. ➤ Mbajtja e një ekipi plotësisht operacional të pajisur dhe në gatishmëri për të ndërhyrë shpejt në rast të emergjencave të parashikuara.
<p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Turizmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve informuese për fermerët dhe komunitetin në lidhje me masat gatishmërisë dhe reagimin në raste emergjencash. ➤ Monitorimi i kushteve klimatike dhe natyrës për të identifikuar ndërlikimet që mund të sjellin emergjenca (p.sh. thatësira, temperature ekstreme, etj.) ➤ Sigurimi i infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për reagimin në situata emergjente, si sistemet e ujitjes për bujqësinë etj.,
<p>Drejtoria e Kordinimit të Integritimit Evropian të Projekteve, Mardhënieve me Pubikun e Median</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Lehtëson koordinimin me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen civile. ➤ Merr pjesë në trajnime dhe ushtrime në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe Mbrojtjes Civile.
<p>Drejtoria e përfshirjes Sociale, Arsim, Kulturë dhe Sporte</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillon aktivitete edukative për komunitetin lidhur me rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe aktiviteteve turistike gjatë emergjencave. ➤ Zhvillon sisteme të komunikimit dhe informacionit për të informuar qytetarët dhe turistët për situatën gjatë emergjencave dhe për masat që duhet të merren për të ruajtur vlerat kulturore dhe pasuritë turistike dhe për çështje shëndetësore. ➤ Ndjek problemet që kanë lidhje me gatishmërinë për sa i takon fushës së arsimit.

<p>Burimet Nerëzore, Shërbimet Mbështetëse. Sektori Juridik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përcaktimi i protokolleve dhe masave ligjore për koordinimin e aktivitetit të evakuimit dhe ndihmës. ➤ Angazhimi për të siguruar që proceset dhe procedurat e emergjencës të respektojnë të drejtat e qytetarëve dhe të jenë në përputhje me ligjet që mbrojnë pronën dhe jetën e individëve. ➤ Ofrimi i mbështetjes ligjore për vullnetarët dhe pjesëmarrësit në operacionet e shpëtimit dhe ndihmës gjatë emergjencave, duke siguruar që ata janë të mbrojtur nga aspektet ligjore dhe të drejtat e tyre janë të garantuara.
<p>Sektori Shërbimit Pyjor</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi i planeve të gatishmërisë për mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit nga emergjencat civile. ➤ Sigurimi i trajnimeve për administrimin e zjarreve dhe krijimi i një infrastrukture të koordinuar për ndërhyrjen sa më shpejt dhe efektivisht për të shpëtuar pyjet dhe ekosistemet përreth. ➤ Monitorimi i ekosistemeve natyrore dhe burimeve natyrore (si pyjet dhe lumenjtë) për të identifikuar rreziqet e mundshme. ➤ Krijimi i sistemeve për mbrojtjen e rezervave natyrore që mund të preken nga situata emergjente. ➤ Implementimi i një platforme për ndarjen e informacionit mbi situatat emergjente që lidhen me pyjet, mjedisin. ➤ Edukimi dhe trajnimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe pyjeve gjatë emergjencave.
<p>Njësitë administrative</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Garanton trajnimin e stafit dhe të vullnetarëve të Njësisë për EC. ➤ Informon qytetarët për risqet e ndryshme dhe për mënyrat e veprimit në situata EC. ➤ Siguron burimet e nevojshme për reagim, si pajisje, shërbime dhe vendstrehime. ➤ Teston në mënyrë periodike sistemet e komunikimit brenda Njësisë për EC. ➤ Identifikon personat me aftësi të kufizuara, banesat me risk të lart dhe të izoluara dhe identifikon të gjitha akseset në raste EC.
<p>Institucione dhe struktura në nivel qarku</p>	
<p>Prefektura Gjirokastrë Sektori i i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave dhe Krizave</p>	<p>Planifikimi dhe Koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe përditësimi i Planit për Emergjencat Civile në Qark, duke siguruar koordinimin me planet e bashkive. ➤ Mbështetja e bashkisë në përgatitjen dhe përditësimin e planeve për Emergjencat Civile dhe vlerësimin të riskut

	<p>për territorin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi me institucionet shtetërore dhe me ato joqeveritare për garantimin e gatishmërisë operacionale. ➤ Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërinsticionale për shkëmbimin e burimeve, ekspertizës, dhe kapaciteteve operacionale me qëllim garantimin e gatishmërisë gjatë emergjencave. <p>Monitorimi dhe Menaxhimi i Burimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbajtja e një baze të dhënash të burimeve të disponueshme emergjente, të tilla si strehimoret, pajisjet dhe personeli i trajnuar. ➤ Sigurimi i funksionimit të sistemeve të monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm për rreziqet në qark. <p>Ndërgjegjësimi dhe Përgatitja Operacionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi i fushatave informuese për publikun mbi rreziqet kryesore, rrugët e evakuimit dhe vendstrehimet e sigurta. ➤ Sigurimi i aksesit të popullatës në informacion të qartë dhe të përditësuar për gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive.
<p>Përfaqësues të Forcave të Armatosura</p> <p>B2K Grehot Gjirokastrë</p>	<p>Organizon ushtrime të vendosjes së shpejtë gjatë emergjencave</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillon plane logjistike për përgjigjen ndaj fatkeqësive, të tilla si transporti i furnizimeve ➤ Përgatit pajisjet ushtarake, transportin dhe spitalet në terren për mbështetje emergjente. ➤ Koordinon me autoritetet vendore dhe shërbimet e mbrojtjes civile për planifikimin dhe zbatimin e përbashkët të gatishmërisë emergjente. ➤ Siguron trajnime për stafin, reaguesit e parë dhe komunitetin mbi gatishmërinë për emergjencat.
<p>Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)</p>	<p>Monitorimi dhe Sigurimi i Infrastrukturës Kritike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendos dhe operon sisteme të avancuara monitorimi për të gjurmuar funksionalitetin e rrjetit të transmetimit të energjisë. ➤ Identifikon dhe zbaton masa mbrojtëse për nënstacionet kritike, transformatorët dhe linjat e transmetimit. <p>Planifikimi dhe Testimi i Gatishmërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Planifikon dhe teston skenarët e furnizimit të vazhdueshëm me energji për shërbimet kritike gjatë emergjencave. ➤ Zhvillon masa parandaluese për të reduktuar ndërprerjet e furnizimit me energji në situata të jashtëzakonshme.

<p>Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE-së</p>	<p>Monitorimi dhe Menaxhimi i Riskut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendos sisteme të avancuara monitorimi për të gjurmuar funksionalitetin e rrjeteve të shpërndarjes dhe për të identifikuar ndërprerjet e mundshme. ➤ Inspekton dhe mirëmban nënstacionet, transformatorët dhe linjat e e shpërndarjes për të parandaluar defektet në rrjet. ➤ Analizon ngarkesat në rrjet për të shmangur mbingarkesat dhe kolapsin e sistemit të shpërndarjes. <p>Planifikimi dhe Sigurimi i Furnizimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Planifikon dhe teston skenarët e furnizimit të vazhdueshëm me energji për infrastrukturën kritike dhe publike si spitalet dhe impiantet e ujit. ➤ Siguron zgjidhje alternative, si furnizimi me gjeneratorë rezervë, për objektet kritike në raste të emergjencave. ➤ Harton dhe përditëson planet e gatishmërisë për ndërprerjet e energjisë, duke përfshirë strategjitë e riparimit të shpejtë. <p>Koordinimi dhe Komunikimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunon me bashkitë dhe institucionet për të garantuar gatishmërinë ndaj emergjencave energjetike. ➤ Krijon një mekanizëm efektiv komunikimi për të informuar autoritetet dhe konsumatorët për ndërprerjet e planifikuara ose situatat emergjente.
<p>Drejtoria Rajonale e Kulturës</p>	<p>Planifikimi dhe Monitorimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rast fatkeqësish. ➤ Monitorimi i aseteve kulturore për identifikimin e rreziqeve dhe nevojave për ndërhyrje parandaluese. <p>Forcimi i Kapaciteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimi i mjeteve të mbrojtjes së aseteve kulturore. ➤ Organizimi i trajnimeve për stafin dhe vullnetarët mbi masat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në situata emergjente. <p>Ndërgjegjësimi dhe Sensibilizimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për komunitetin, pronarët dhe administratorët e aseteve kulturore mbi masat parandaluese dhe gatishmërinë ndaj rreziqeve. ➤ Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e praktikave të mira në ruajtjen e aseteve kulturore në situata emergjente.
<p>Agjencia Rajonale e Mjedisit</p>	<p>Monitorimi dhe Raportimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve mjedisorë për të

	<p>identifikuar sinjalet e hershme të ndotjes ose ndikimeve të tjera mjedisore që mund të çojnë në fatkeqësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Raportimi periodik dhe informimi i autoriteteve përgjegjëse mbi ndryshimet mjedisore dhe rreziqet potenciale. <p>Forcimi i Kapaciteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i trajnimeve për reaguesit dhe autoritetet vendore mbi menaxhimin e rreziqeve mjedisore gjatë fatkeqësive. ➤ Sigurimi i protokolleve të qarta për menaxhimin e ndotjeve të mundshme dhe rreziqeve të tjera që mund të ndikojnë në mjedis dhe shëndetin publik.
<p>Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit</p>	<p>Sigurimi i Funkcionalitetit të Infrastrukturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujitjes dhe kullimit për të garantuar gatishmërinë teknike. ➤ Identifikimi i pikave kritike të rrjetit dhe përgatitja e masave për ndërhyrje të shpejta. <p>Përgatitja e Burimeve Njerëzore dhe Teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i gatishmërisë së menaxherëve dhe specialistëve të jenë në gatishmëri dhe të përgatitur për të vepruar shpejt gjatë situatave emergjente. ➤ Organizimi i trajnimeve për stafin mbi procedurat teknike dhe riparimet emergjente për të garantuar gatishmërinë teknike të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. <p>Planifikimi dhe Koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për menaxhimin e ujit duke u fokusuar në masat ndërhyrjet e menjëhershme dhe sigurinë e infrastrukturës. ➤ Bashkëpunimi me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për koordinimin e masave parandaluese dhe emergjente.
<p>Shoqëria e Ujësjetës Kanalizimeve Sh.a</p>	<p>Sigurimi i Cilësisë së Ujit të Pijshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitoron dhe garanton kushtet higjieno-sanitare të furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën. ➤ Kryen analiza të vazhdueshme për cilësinë e ujit, duke identifikuar dhe parandaluar ndotjet që përbëjnë rrezik për shëndetin publik. ➤ Kryen menaxhimin e përgjithshëm të monitorimit të cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të ndotura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujor sipërfaqësor ose nëntokësor pas trajtimit që duhet të kryhet nga organet e përcaktuara me ligje të veçanta. <p>Parandalimi i Rreziqeve dhe Menaxhimi i Riskut:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbaton masa parandaluese për të minimizuar riskun nga defektet në rrjetin e ujës-jellësit dhe kanalizimeve. ➤ Bashkëpunon me institucionet vendore për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë në kushte normale dhe emergjente.
<p>Zyra Vendore e Arsimit Përmet</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve/rinisë për risqet dhe masat parandaluese. ➤ Edukimin për gatishmërinë ndaj fatkeqësive në kurrikulën shkollore ➤ Identifikimi i aseteve infrastrukturore që mund të vihen në dispozicion të bashkisë Fier në rast fatkeqësish. ➤ Hartimi nga çdo shkollë i një plani paraprak evakuimi dhe përcaktimi i një vendi grumbullimi për nxënësit dhe mësuesit në rast emergjence civile. ➤ Hartimi i një plani të detajuar veprimi nga stafi mësimor i shkollës për emergjencat natyrore, i cili duhet të publikohet në çdo korridor dhe në çdo kat të godinave. ➤ Vendorsja e tabelave në vende të dukshme: Ndalohet pirja e duhanit, Nuk lejohet zjarr. Rreziku nga zjarri etj. ➤ Pajisja e ndërtesave me shenja evakuimi dhe drita emergjence. ➤ Zhvillimi i materialeve ndërgjegjësuese: Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, librave edukativë, dhe materiale vizuale për risqet dhe masat për parandalimin e tyre. ➤ Trajnimi i stafit mësimdhënës për menaxhimin e risqeve: Organizimi i trajnimeve për mësuesit mbi identifikimin e rreziqeve dhe rolin e tyre në edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve. ➤ Monitorimi i gjendjes së infrastrukturës shkollore për rreziqe të mundshme: Identifikimi i problematikave strukturore që mund të shkaktojnë rrezik (shembje, rrëshqitje, zjarre, etj.) dhe raportimi për ndërhyrje të mëtejshme. ➤ Organizimi i fushatave të komunitetit për ndërgjegjësim: Angazhimi i shkollave në aktivitete komunitare për ndërgjegjësimin e familjeve dhe banorëve për masat parandaluese. ➤ Promovimi i projekteve shkollore për qëndrueshmërinë mjedisore: Mbështetja e aktiviteteve që inkurajojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e faktorëve që mund të rrisin risqet, si pyllëzimi dhe zvogëlimi i ndotjes.
<p>Përfaqësues të kompanive të</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mirëmbajtja e Rrjetit: Sigurimi i funksionalitetit të

<p>telekomunikacionit (Vodafone & One)</p>	<p>vazhdueshëm të rrjeteve telekomunikuese për të shmangur ndërprerjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetja e Paralajmërimit të Hershëm: Bashkëpunimi me Bashkinë për shpërndarjen e paralajmërimeve dhe njoftimeve emergjente përmes rrjeteve ekzistuese. ➤ Sigurimi i Infrastrukturës Kritike: Identifikimi dhe parandalimi i dëmtimeve në pikat kritike të rrjetit telekomunikues. ➤ Koordinimi me Bashkinë: Pjesëmarrja në takime dhe shkëmbimi i informacionit mbi kapacitetet e telekomunikacionit në raste emergjencash. ➤ Ndërgjegjësimi i Popullatës: Bashkëpunimi me Bashkinë për të informuar komunitetin mbi përdorimin e rrjeteve të telekomunikacionit në situata të rrezikut.
<p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet</p>	<p>Vlerësimi i Riskut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe përditësimi i dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, për institucionet shëndetësore në nivel qarku. ➤ Identifikimi i risqeve që mund të ndikojnë në funksionimin e spitaleve dhe hartimi i masave parandaluese për adresimin e tyre. <p>Parandalimi i Ndikimeve Shëndetësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i masave parandaluese për zvogëlimin e riskut të ndërprerjeve të shërbimeve mjekësore në rast fatkeqësish. ➤ Hartimi dhe zbatimi i protokolleve për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve që ndikojnë në shëndetin publik, si përhapja e sëmundjeve ngjitëse. <p>Ndërgjegjësimi i Komunitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me autoritetet vendore për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi masat parandaluese për fatkeqësitë shëndetësore. ➤ Ofrimi i udhëzimeve për popullatën mbi menaxhimin e situatave emergjente shëndetësore (p.sh., kujdesi për të moshuarit, menaxhimi i sëmundjeve kronike gjatë emergjencave).
<p>Qendrat Shëndetësore/Ambulancat</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës: Promovimi i informacioneve mbi masat e parandalimit, si: edukimi në lidhje me rreziqet e shëndetit, higjienën, ushqyerjen e shëndetshme, shmangien e duhanpirjes, etj. ➤ Përgatitja dhe trajnimi i stafit mjekësor dhe të qytetarëve: Ofrimi i trajnimeve të rregullta për mjekët, infermierët dhe personelin e urgjencës për të njohur dhe reaguar ndaj situatave të mundshme emergjente, si

	<p>dhe përgatitja e popullsisë për përdorimin e teknikave bazë të ndihmës së shpejtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi i grupeve të rrezikuara: Identifikimi i grupeve të rrezikuara si: personat me sëmundje kronike, të moshuarit, grate shtatzëna, dhe fëmijët, për t'i siguruar ata me mbështetje dhe masa parandaluese. ➤ Menaxhimi i infrastrukturës shëndetësore dhe emergjente: Krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për trajtimin e shpejtë dhe efikas të emergjencave. ➤ Koordinimi me institucionet dhe strukturat e tjera vendore: Bashkëpunimi me strukturat e policisë dhe zjarrfikësit, për të zhvilluar plane të përbashkëta për parandalimin e situatave emergjente. ➤ Ndihma në mbrojtjen e shëndetit publik: Monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive përmes vaksinimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të grupeve me rrezik të lartë.
<p>Spitali bashkiak Përmet</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës: Organizimi i fushatave për informimin dhe edukimin e komunitetit mbi rreziqet shëndetësore dhe mënyrat për t'i parandaluar ato. ➤ Promovimi i shëndetit të përgjithshëm: Organizimi i aktiviteteve edukative për parandalimin e sëmundjeve kronike. ➤ Trajnimi i personelit shëndetësor: Kryerje e trajnimeve të rregullta për mjekët, infermierët dhe stafin tjetër shëndetësor. ➤ Mbikëqyrja e sëmundjeve infektive dhe epidemive: Monitorimin e rasteve të sëmundjeve infektive. ➤ Përmirësimi i infrastrukturës: Marrja e masave për përshtatjen e infrastrukturës së tyre për të menaxhuar fluksin e mundshëm të pacientëve në rast emergjencash.
<p>Kryqi i Kuq, Dega Përmet</p>	<p>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i fushatave të informimit mbi masat parandaluese për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive të shkaktuara nga rreziqet natyrore dhe në veçanti, emergjencave shëndetësore. ➤ Promovimi i sjelljeve të sigurta dhe masave vetëmbrojtëse, duke ndihmuar komunitetet të zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve. <p>Mbështetja e Strukturave Vendore për Zvogëlimin e Riskut</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Këshillimi i institucioneve lokale për përcaktimin e masave të duhura parandaluese, bazuar në vlerësimin e riskut.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me komunitetet për të identifikuar faktorët e riskut dhe për të promovuar masa mbrojtëse afatgjata. <p>Bashkëpunimi me Institucionet Shtetërore dhe Organizatat Ndërkombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kontribut në përcaktimin e prioriteteve për zvogëlimin e riskut në nivel vendor dhe kombëtar. ➤ Shpërndarja e udhëzimeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të adaptuara për realitetin lokal.
<p>Drejtoria Vendore e Policisë Fier/ Komisariati Përmet</p>	<p>Planifikimi dhe Trajnimi për Situata Emergjente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi dhe përditësimi i planeve të sigurisë për mbrojtjen e popullsisë dhe infrastrukturës gjatë emergjencave. ➤ Trajnimi i oficerëve për evakuim, menaxhimin e turmave dhe reagim ndaj fatkeqësive ➤ Organizimi i ushtrimeve dhe simulimeve në bashkëpunim me shërbimet e emergjencës. <p>Masat për Sigurinë dhe Rendin Publik:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Planifikimi dhe zbatimi i masave paraprake për garantimin e rendit dhe sigurisë publike para ndodhjes së emergjencave. ➤ Identifikimi dhe hartimi i skenarëve për menaxhimin e trafikut dhe lëvizjen e qytetarëve në rast evakuimi. <p>Koordinimi dhe Mbështetja Operacionale në Fazën e Gatishmërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Planifikimi i mbështetjes logjistike për operacionet e evakuimit, përfshirë identifikimin e rrugëve të sigurta, zonave të grumbullimit dhe mjeteve të transportit emergjent. ➤ Koordinimi me institucionet dhe strukturat e emergjencave për hartimin e strategjive të evakuimit dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël. ➤ Përcaktimi i protokolleve për asistencën ndaj popullsisë në rrezik, duke siguruar që mekanizmat e ndihmës të jenë të qarta dhe të gatshme për zbatim.

6. Përgjigja

Faza e *Përgjigjes* ndaj një emergjence i referohet ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës emergjente përpara, gjatë ose menjëherë pas një fatkeqësie, për të mbrojtur jetën e njerëzve, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

6.1 / Qëllimet kryesore të përgjigjes

Shpëtimi i jetëve. Objektivi kryesor është ruajtja dhe mbrojtja e jetës njerëzore duke kërkuar ndihmë për ata që janë në rrezik dhe duke garantuar sigurinë e viktimave dhe strukturat e *Përgjigjes*. Mirëqenia e tyre duhet të trajtohet në mënyrë efektive që ata të jenë në gjendje t'u përgjigjen nevojave të njerëzve në rrezik.

Zbutja e vuajtjeve. Dëmtimi fizik dhe psikologjik mund të shkaktojë ndikime afatshkurtra dhe afatgjata te individët, familjet dhe komunitetet. Masat e përgjigjes duhet të marrin parasysh të gjitha masat e arsyeshme për të reduktuar ose eliminuar vuajtjet njerëzore.

Kufizimi i emergjencës. Kufizimi i përshkallëzimit ose përhapjes së emergjencës dhe zbutja e ndikimeve të saj. Përgjigja ndaj nevojave imediate të situatës emergjente për të parandaluar përkeqësimin e situatës duke kontrolluar rreziqet dhe duke zbutur rreziqet e mëtejshme për të zvogëluar humbjet ose dëmtimet e mëtejshme.

Mbrojtja e shëndetit publik. Adresimi i nevojave mjekësore, parandalimi i sëmundjeve dhe sigurimi i aksesit në objektet e kujdesit shëndetësor për të lënduarit ose të prekurit nga emergjenca.

Sigurimi i nevojave thelbësore. Sigurimi i furnizimit me ujë, ushqim dhe strehim për ata që janë zhvendosur ose janë prekur nga emergjenca.

Mbrojtja e pronës. Minimizimi i dëmit të pronës dhe ruajtja e infrastrukturës kritike, duke përfshirë shtëpitë, bizneset dhe objektet publike.

Mbrojtja e mjedisit. Mjedisi është thelbësor për komunitetet. Minimizimi i dëmit në mjedis duhet të jetë qëllimi i masave mbrojtëse për personelin e reagimit.

Rivendosja e funksionimit të komunitetit. Përqendrimi në rivendosjen e funksionimit të komunitetit dhe mbështetjen e individëve të prekur. Kjo përfshin rihapjen e shërbimeve thelbësore, lehtësimin e rivendosjes së shpejtë të shërbimeve dhe funksioneve komunitare, shërbimet komunitare, transportin dhe sistemet e komunikimit, ofrimin e ndihmës financiare dhe rivendosjen e besimit dhe moralit të publikut.

6.2 / Aktivizimi i përgjigjes në bashkinë Përmet

Në PVEC të bashkisë Përmet faza e *Përgjigjes* kalon nëpër katër etapa aktivizimi.

Tabela 3: Etapat e Përgjigjes

Etapa I	> Alarmi për rritjen e gatishmërisë	> Të gjitha masat për njoftimin e parë. > Mbledhja e informacionit. > Sinjalizimi për të rritur gatishmërinë.
Etapa II	> Vendosja e gjendjes së gatishmërisë	> Gatishmëri e plotë. > Njoftimi i situatës së pashmangshme
Etapa III	> Aktivizimi	> Dislokimi i plotë dhe mobilizimi
Etapa IV	> Dalja nga situata	> Rikthimi i burimeve në veprimtaritë e zakonshme




Figura 9: Modeli i Ndërhyrjes për Menaxhimin e Emergjencës

6.3 / Aktivitetet e bashkisë në fazën e përgjigjes

6.3.1 / Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë

Tabela 4: Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë

Përgjegjësi i sektorit për emergjencat në Bashki/KMCB. Ai është koordinatori i QOECB.	Koha e reagimit
Informon Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin për situatën dhe nevojën e aktivizimit të Etapës I: “Alarm për rritjen e gatishmërisë”. Kryetari i bashkisë pas vlerësimit të situatës dhe konsultimeve vendos për fillimin e kësaj faze.	Urgjente
Komunikon me drejtuesit e Njësive Administrative të bashkisë për situatën.	E menjëhershme
Verifikon nëse QOECB ka staf dhe pajisje të mjaftueshme për të punuar 24 orë gjatë etapës "Alarm për rritjen e gatishmërisë".	E menjëhershme
Verifikon dhe jep informacion prefektit, QOECQ ose QKOEC për ngjarje të mundshme rreziku.	Brenda 1 ore
Informon institucionet dhe strukturat përkatëse monitoruese dhe informuese/njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre monitorimin e vazhdueshëm të rrezikut, dhënien e informacionit dhe parashikimin e zhvillimit të situatës.	Brenda 1 ore
Në koordinim me prefekturën, informon strukturat operacionale MM, FA dhe PSH etj. dhe kërkon prej tyre të vënë në gatishmëri strukturat e tyre dhe të japin informacion të vazhdueshëm për situatën.	Brenda 1 ore
Verifikon nëse mjetet e transportit ose më saktë kapacitetet e deklaruara në PVEC të bashkisë Përmetjanë në gatishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme dhe nëse kanë rezerva karburanti.	Brenda 1 ore
Kërkon informacion për rezervat monetare të gatishme, të mbajtura nga bashkia dhe njësitë administrative për situata emergjente.	Brenda 1 ore
Kontrollon mjetet e komunikimit, përditësimin e listave të kontaktit të planit të emergjencave civile dhe aktivizon sistemin e paralajmërimit.	Brenda 1 ore
Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit.	Brenda 1 ore
Përgatit informacion të përmbledhur për Institucionin e Prefektit dhe, nëse është e nevojshme, për AKMC-në.	Cdo 2 orë

6.3.2 / Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Vlerësohet nevoja për të hyrë në fazën e dytë “Vendosja e gjendjes së gatishmërisë”, kur një rrezik i afërt është i pashmangshëm dhe ka gjasa të shkaktojë dëme në njerëz, pasuri ose mjedis.

Tabela 5: Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Përgjegjësi i sektorit për EC në Bashki/KMCB	Koha e reagimit
Informon kryetarin e bashkisë për situatën dhe nevojën e fillimit të Etapës II “Vendosja e gjendjes së gatishmërisë”. Kreu i bashkisë pas konsultimeve dhe vlerësimeve vendos nisjen e kësaj faze.	Urgjente
Pas miratimit të kryetarit të bashkisë mblidhet KMCB dhe kërkohet përgatitje për vendimmarrje, takime informuese për median dhe popullatën.	Brenda 2 orësh
Komunikon me drejtuesit e njësive administrative dhe i informon për fillimin e Etapës II “Vendosja e gjendjes së gatishmërisë” dhe u kërkon të ndjekin situatën.	Menjëherë
Në koordinim me prefekturën informon strukturat e MM, FA dhe PSH dhe u kërkon atyre të ndjekin situatën sipas PVEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për situatën.	Brenda 1 ore
Në koordinim me prefekturën komunikon me strukturat e tjera monitoruese dhe informuese/njoftuese, operacionale aktive, operacionale mbështetëse dhe me strukturat e decentralizuara që operojnë në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre të ndjekin situatën sipas PVEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për zhvillimin e situatës.	Brenda 1 ore
Harton raportin e parë mbi situatën dhe informacionin periodik që i dërgohet prefektit dhe AKMC-së sipas rastit.	Brenda 2 orësh
Kontrollon dhe konfirmon që të gjitha masat e mëparshme janë përmbushur.	Brenda 1 ore
Aktivizon QOECB që punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në etapën e “Vendosjes të gjendjes së gatishmërisë” për 24 orë.	Menjëherë
Përgatit informacion për Institucionin e Prefektit, AKMC, publikun, median, donatorët dhe OJF-të e interesuara.	Brenda 2 orësh
Në bashkëpunim me prefekturën krijon dhe merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimi të të dhënave për situatën në zonat në rrezik fatkeqësie.	Brenda 4 orësh
Informon popullatën për situatën e pritshme dhe i komunikon nevojën e zbatimit të masave vetëmbrojtëse. Prioritet i jepet banorëve të zonave në rrezik dhe në veçanti grupeve të cenushme, si personat me	Brenda 2 orësh

aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat që jetojnë vetëm, duke siguruar që informacioni të arrijë te të gjithë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

Verifikon disponueshmërinë/funksionalitetin e zonave të emergjencës, Brenda 2 orësh objekteve për pritjen e popullsisë dhe rrugëve të evakuimit.

6.3.3 Etapa III: Aktivizimi

Aktivizimi fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëme në njerëz dhe materiale ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mund të sjellë të njëjtat pasoja që tejkalojnë aftësitë e strukturave të MC në nivel vendor.

Ministri përgjegjës për MC është autoriteti që shpall nisjen e Etapës së tretë, “Aktivizimi”, duke angazhuar në mision vetëm strukturat e përhershme që kanë detyra të mbrojtjes civile.

Në rastet e EC kombëtare kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijohet KNEC krijohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në mbledhjen e tij të parë, KNEC emëron DQO, i cili do të marrë drejtimin e përgjithshëm të përgjigjes në nivel qendror dhe koordinon e ndihmën ndërkombëtare sipas nevojës.

Tabela 6: Etapa III: Aktivizimi

Për emergjencat e shkallës më të ulët, kryetari i bashkisë/KMCB	Koha e reagimit
Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel bashkie, ngritjen e KMCB dhe aktivizimin e QOECB.	Brenda 1 ore
Kërkon informacion nga drejtori/përgjegjësi i strukturës së emergjencave në bashki për gjendjen emergjente.	Brenda 1 ore
Mbledh KMCB ose thërret urgjentisht atë pjesë të nevojshme të saj për konsultime sipas llojit të emergjencës për procesin e vendimmarrjes.	Brenda 2-4 orësh
Së bashku me prefektin dhe AKMC siguron që gjitha strukturat e nevojshme monitoruese dhe informuese/njoftuese si edhe strukturat operacionale aktive dhe operacionale mbështetëse të jenë funksionale 24/7 dhe në veprim për situatën.	Vazhdimisht
Nëse është e nevojshme, i propozon prefektit shpalljen e “Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore” për zonën e prekur.	Sipas situatës
Përgjegjësi i sektorit për EC në bashki/KMCB.	
Kërkon informacion periodik për situatën në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit të situatës.	Çdo 2 orë
Nëse është e nevojshme, i propozon kryetarit të bashkisë shpalljen e “Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore” për zonën e prekur.	Sipas situatës
Harton raportin e parë për situatën dhe informacionin periodik, të cilat i dërgohen prefektit dhe AKMC-së sipas rastit.	Çdo 2 orë

Për emergjenca të shkallës së lartë , pas emërimit, DOB do të sigurojë këto aktivitete	
Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel bashkie, si dhe aktivizimin e KMCB dhe ngritjen e QOECB.	Menjëherë
Harton raporte me shkrim të situatës për prefektin, QOECQ ose drejtpërdrejt për QKOE	Çdo 2 orë
Koordinon strukturat vendore në nivel vendor, si dhe strukturat e tjera qendrore apo ndërkombëtare që vijnë në ndihmë	Vazhdimisht
Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtues të tjerë të forcave operationale në nivel qarku dhe bashkitë fqinje, informon dhe kërkon ndihmë nga DOQ.	Vazhdimisht
Zbaton detyrat dhe urdhrat e marra nga KMC në bashki dhe DOQ, si edhe nga DQO.	Vazhdimisht

6.3.4 / Etapa IV: Dalja nga situata

Në etapën IV, "Dalja nga situata", mund të kalohet:

- ❖ Drejt nga etapa I ose etapa II, pa kaluar në situatën e fatkeqësisë.
- ❖ Nga etapa III, kur një fatkeqësi ka ndodhur realisht dhe situata është stabilizuar.

Etapa IV përfaqëson rikthimin në situatë normale, ku nuk ka më një kërcënim të drejtpërdrejtë.

Dalja nga situata bëhet kur:

- ❖ Është kryer një vlerësim i plotë i situatës.
- ❖ Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme.
- ❖ Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e pritshme.
- ❖ Nevojat më urgjente janë adresuar.


Tabela 7: Etapa IV. Dalja nga situata.

Drejtori/përgjegjësi i sektorit të emergjencave në bashki/ KMCB	Koha e reagimit
Raporton tek kryetari i bashkisë dhe komunikon me të gjithë kryetarët e Njësimin Administrative për shpalljen e Etapës “ <i>Dalja nga situata</i> ”.	Menjëherë
Informon të gjitha strukturat në varësi, institucionet dhe strukturat e tjera që veprojnë në territorin e bashkisë për etapën “ <i>Dalja nga situata</i> ”.	Menjëherë
Verifikon nëse informacioni dhe këshillat e nevojshme i janë transmetuar popullatës nëpërmjet mjeteve të informimit publik.	Brenda 2 orësh
Përgatit informacion përmbledhës, për Etapën “ <i>Dalja nga situata</i> ”, për mediat, donatorët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.	Në vazhdim
Përgatit informacion përmbledhës, për shpalljen e Etapës “ <i>Dalja nga situata</i> ”, për mediat, donatorët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.	Në vazhdim
Harton raportin përfundimtar të situatës dhe ia dërgon prefekturës dhe AKMC.	Brenda 2-4 orësh

Grumbullon të gjitha të dhënat, raportet, hartat dhe korrespondencën duke i vendosur në dosjet përkatëse nën datën/numrin dhe titullin përkatës.	Brenda 2-4 orësh
Kthen çdo pajisje të marrë hua nga institucione dhe struktura të tjera.	Brenda ditës
Siguron rikthimin e QOECB në gjendjen e mëparshme dhe administratës së bashkisë në gjendjen normale të funksionimit.	
Kontrollon që mjetet e transportit dhe asetet e tjera të marra nga institucionet dhe kompanitë private gjatë situatës, të kthehen në pronësi dhe gjendje normale pranë tyre.	Brenda ditës
Kërkon inventarizimin e gjendjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse	Brenda ditës
Kontrollon funksionimin e mjeteve të komunikimit, përditësimin e listës së kontakteve dhe rishikimin e numrave të celularëve të personelit kyç.	Në vazhdim

Diagrami më poshtë ilustron katër raste se si mund të arrihet Etapa 4.

Figura 10: Etapa 4 “Dalja nga Situata”



6.4 / Përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve për përgjigjen në nivel bashkie

Tabela 8: Institucionet dhe strukturat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e Përgjigjes – Bashkia Përmet

Institucionet, strukturat dhe palët e përfshira	Përgjegjësitë në fazën e Përgjigjes
Institucione dhe struktura në nivel bashkie	
<p>KMCB Sektori i Emergjencave Civile</p>	<p>Roli kryesor:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi, koordinimi, bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e bashkisë, me institucione dhe struktura të tjera që veprojnë në nivel vendor, me Institucionin e prefektit të qarkut, me bashkitë fqinje, me subjektet private, me organizatat e shoqërisë civile dhe me komunitetin për të përballuar emergjencën ose fatkeqësinë. <p>Përgjegjësi të detajuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi, aktivizimi dhe koordinimi i burimeve njerëzore, materiale, teknike, financiare në nivel bashkie për përballimin e emergjencës apo fatkeqësisë. ➤ Koordinimi i punës së strukturës së SHMZSH me strukturat e tjera përkatëse për kryerjen e procesit të kërkim-shpëtimit. ➤ Evakuimi në kohë i popullatës civile. ➤ Sigurimi i strehimit/akomodimit të përkohshëm për banorët gjatë emergjencës dhe plotësimi i kushteve dhe nevojave të tyre. ➤ Adresimi i nevojave të popullatës së prekur nga fatkeqësia për ofrimin e kujdesit shëndetësor, si dhe për shëndetin mendor. ➤ Ofrimi i ndihmës ushqimore dhe ndihmës gjatë emergjencës për banorët e prekur nga fatkeqësia. ➤ Bashkëpunimi me strukturat e PSH për garantimin e sigurisë publike në zonat e prekura nga fatkeqësia. ➤ Koordinim dhe bashkëpunim me strukturat bashkiake dhe strukturat e tjera në nivel vendor për mbrojtjen e gjësë së gjallë. ➤ Lëshimi i paralajmërimeve të hershme dhe informimi publik për emergjencat civile. ➤ Vlerësimi i situatës në terren për të kuptuar natyrën dhe shtrirjen e emergjencës dhe masat që duhen marrë për përballimin e saj. ➤ Vlerësimi fillestar dhe i specializuar i dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura nga fatkeqësia.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përgatitja e informacionit, raporteve për situatën për kryetarin e bashkisë, KMCB dhe sipas nevojës për prefekturën dhe AKMC . ➤ Mbështetja e QOECB dhe DOB në zbatimin e detyrave të tyre (në rastet kur ato janë krijuar). ➤ Komunikimi i vazhdueshëm me Drejtorinë e Emergjencave Civile në prefekturë dhe sipas nevojës me AKMC-në për situatën, si dhe nevojat për përballimin e saj. ➤ Komunikimi i vazhdueshëm me njësitë administrative për situatën, si dhe me strukturat që janë të angazhuara për përballimin e emergjencës apo fatkeqësisë. ➤ Komunikimi dhe bashkëpunimi me bashkitë fqinje për kryerjen e reagimit emergjent. ➤ Aktivizimi i QOECB, bazuar në kriteret e përcaktuara në PKEC dhe PVEC. ➤ Caktimi i SHO-së bashkiake, sipas rastit, për të përballuar fatkeqësinë në territorin e saj. ➤ Nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga emergjenca ose fatkeqësia nëse është e nevojshme. ➤ Informimi i publikut dhe i medias për situatën. ➤ Menaxhimi i asistencës ndërkombëtare duke kryer procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës (MVP). ➤ Koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse për sigurimin dhe restaurimin e infrastrukturës publike dhe kritike (ujë, rrugë, energji elektrike, kanalizime, qendra publike, shkolla etj.). ➤ Garantimi që të gjitha aktivitetet e përgjigjes të jenë në përputhje me praktikat ligjore në fuqi. ➤ Dokumentimi i të gjithë ciklit të menaxhimit të emergjencave civile ose fatkeqësive për analiza të ardhshme, llogaridhënie dhe raportim tek autoritetet më të larta.
<p>Drejtorie e financës dhe Buxhetit Sektori i Financës - Buxhetit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Alokon fonde për aktivitetet e përgjigjes së menjëhershme. ➤ Identifikon dhe siguron burimet e financimit. ➤ Monitoron disbursimin dhe përdorimin e fondeve të përgjigjes për të siguruar transparencë dhe për të parandaluar keqpërdorimet. ➤ Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes së shërbimeve kryesore.

<p>Burimet Njerëzore Sektori Juridik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi i burimeve: Aktivizimi i personelit dhe burimeve për të përballuar emergjencën. ➤ Vlerësimi i dëmeve: Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes. Mbështetë Sektorin e Planifikimit të Emergjencave Civile dhe të Strehimit, si dhe sektorët e tjerë për hartimin e akteve të ndryshme ligjore për menaxhimin e emergjencës. ➤ Kontrollon që i gjithë procesi të kryhet konformë akteve ligjore në fuqi.
<p>Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të territorit</p>	<p>Mobilizimi i burimeve për vlerësimin e dëmeve dhe nevojave:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi dhe përdorimi i burimeve për të kryer vlerësime fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura nga fatkeqësia. ➤ Mbështetja në restaurimin e infrastrukturës kritike: Bashkëpunimi dhe koordinimi me drejtori të tjera dhe autoritete përgjegjëse për sigurimin dhe rikthimin e funksionalitetit të infrastrukturës publike dhe kritike si furnizimi me ujë, rrugët, dhe kanalizimet. Siguron përgjigje në kohë reale gjatë fatkeqësive natyrore.
<p>Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim, Kulturë dhe Sporte</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve: Koordinon dhe aktivizon personelin, automjetet, pajisjet, dhe burimet e tjera specifike për emergjencat civile, duke u fokusuar në shërbimet sociale. ➤ Evakuimi dhe mbështetja e popullatës: Koordinon procesin e zhvendosjes së popullatës civile nga zonat e rrezikshme në bashkëpunim me strukturat e tjera. ➤ Mbështetje për të prekurit: Sigurimi i asistencës sociale, mbështetjes psiko-sociale dhe ndihmës për banorët e prekur nga fatkeqësia. Sigurimi i ndihmës ushqimore dhe ndihmës tjetër gjatë emergjencës. ➤ Organizimi i ndihmave: Përgatit dhe shpërndan ndihma ushqimore dhe bazike për popullsinë e prekur gjatë emergjencës. ➤ Planifikimi për kategoritë e grupeve të cënueshme: Identifikon dhe asiston grupet në nevojë, duke përfshirë të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.
<p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësi, Taksave dhe Mjedisit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi i burimeve: Aktivizimi i personelit dhe burimeve për të përballuar emergjencën. ➤ Paralajmërimet dhe informim publik: Siguron paralajmërimet të hershme dhe shpërndan informacione kritike për publikun lidhur me emergjencën për sa i

	<p>takon cështjeve të mjedisit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i dëmeve: Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes.
<p>Drejtoria e Integritit European dhe Informimit Publik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i zbatimit të procedurave të Mbështetjes së Vendit Pritës (MVP): Siguron që procedurat për pranimin dhe koordinimin e ndihmës ndërkombëtare të zbatohen në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare. ➤ Koordinimi i ndihmës ndërkombëtare: Ndërmjetëson ndërmjet autoriteteve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë për shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe burimeve në zonat e prekura. ➤ Mbështetja logjistike për ekipet ndërkombëtare: Siguron mbështetje logjistike dhe informacione për ekipet ndërkombëtare që veprojnë në terren gjatë emergjencave. ➤ Raportimi mbi ndihmën ndërkombëtare: Përgatit raporte për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ndihmën e marrë dhe shpërndarjen e saj. ➤ Paralajmërimet dhe informim publik: Siguron paralajmërimet të hershme dhe shpërndan informacione kritike për publikun lidhur me emergjencën.
<p>Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në bashki</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi i burimeve: Aktivizon personelin dhe burimet për të përballuar situatat emergjente që lidhen me territorin. ➤ Informim dhe këshillim publik: Siguron paralajmërimet të hershme dhe informacione kritike për publikun lidhur me emergjencën. ➤ Vlerësimi i dëmeve: Bashkëpunon në vlerësimin e dëmeve dhe nevojave të lidhura me strukturat dhe zonat e prekura.
<p>Shërbimet Publike</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve teknike dhe infrastrukture: Siguron burimet materiale dhe teknike për garantimin e shërbimeve bazike (ujë, kanalizime, energji) gjatë emergjencave. ➤ Strehim i përkohshëm: Organizimi i strukturave të përkohshme për akomodimin e popullatës së evakuuar nga zonat e prekura. ➤ Riparimi i infrastrukturës kritike: Koordinon rivendosjen e funksionimit të infrastrukturës publike dhe kritike, si ujësjellësi, energjia dhe kanalizimet. ➤ Ndihma logjistike: Transporti dhe ruajtja e mallrave emergjente për operacionet e shpëtimit dhe mbështetjes. ➤ Pastrimi dhe rikuperimi: Ndërhyn për pastrimin dhe riparimin e infrastrukturës pas emergjencës, në

	<p>bashkëpunim me strukturat e tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Paralajmërimet dhe informimi publik: Siguron paralajmërimet të hershme dhe shpërndan informacione kritike për publikun lidhur me emergjencën. ➤ Vlerësimi i dëmeve: Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes. Ofrimi i shërbimeve të nevojshme për qytetarët gjatë emergjencave, duke siguruar që infrastruktura si furnizimi me ujë, kanalizime, energji elektrike et
<p>Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit</p>	<p>Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivizimi i burimeve njerëzore, materiale dhe teknike për t'u përgjigjur emergjencave dhe fatkeqësive në mënyrë efektive. ➤ Sigurimi që pajisjet dhe personeli të jenë në gatishmëri të plotë për operacione emergjente. <p>Bashkëpunimi dhe koordinimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunim i ngushtë me strukturat vendore, si policia, strukturat e mbrojtjes civile dhe organizatat ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit. ➤ Pjesëmarrje në operacione të integruara për menaxhimin e emergjencave dhe fatkeqësive. <p>Kryerja e operacioneve të kërkim-shpëtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zhvillimi i operacioneve për kërkimin dhe shpëtimin e personave të bllokuar ose të humbur në zonat e prekura. ➤ Ndërhyrje për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet në pronë dhe mjedis. ➤ Shmangia e rreziqeve dytësore gjatë operacioneve emergjente. <p>Paralajmërimet të hershme dhe informimi publik:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Lëshimi i paralajmërimeve për situata potencialisht të rrezikshme, duke informuar publikun për masat që duhen marrë. ➤ Këshillimi i publikut për veprime të sigurta gjatë situatave emergjente dhe fatkeqësive. <p>Menaxhimi i zjarreve dhe mbrojtja e mjedisit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërhyrje në shuarjen e zjarreve në zonat urbane, rurale dhe pyjore
<p>Sektori Shërbimit Pyjor</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi i burimeve: Aktivizimi i personelit dhe burimeve për të përballuar emergjencën. ➤ Paralajmërimet dhe informimi publik: Siguron paralajmërimet të hershme dhe shpërndan informacione kritike për publikun lidhur me emergjencën. ➤ Vlerësimi i dëmeve: Merr pjesë në vlerësimin e

	<p>dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes.</p>
<p>Policia Bashkiake</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe koordinimi: Aktivizimi i burimeve për përballimin e emergjencave dhe fatkeqësive dhe koordinimi me strukturat vendore të policisë dhe strukturat e tjera: ➤ Evakuimi i popullatës: Zbatimi i procesit të evakuimit të popullatës civile në zonat e prekura nga fatkeqësia duke siguruar një lëvizje të sigurt dhe të rregullt. Strehim dhe akomodim i përkohshëm gjatë emergjencës. ➤ Siguria dhe rendi: Siguron masat e nevojshme për ruajtjen e rendit publik, kontrollin e trafikut dhe garantimin e sigurisë në zonat e prekura nga fatkeqësia; Monitorimi i zonave me rrezik për të parandaluar veprimet e paautorizuara apo të rrezikshme. ➤ Mbështetje për strehimin dhe akomodimin: Asistenca në ruajtjen e rendit dhe sigurisë në vendet e strehimit të përkohshëm, duke ndihmuar në lëvizjen dhe organizimin e popullsisë së evakuuar dhe duke mbështetur strukturat përgjegjëse për menaxhimin e kushteve në këto vende.
<p>Njësitë administrative</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivizimi i Planeve të Emergjencës, përmes zbatimit të planeve të miratuara për reagim, duke përcaktuar hapat e duhur për menaxhimin e situatës. ➤ Koordinimi i veprimeve përmes bashkëpunimit me agjencitë e tjera, si shërbimet e emergjencës dhe organizatat joqeveritare, për të siguruar një reagim të koordinuar. ➤ Organizimi i ndihmës për ata që preken nga emergjenca, duke përfshirë shpërndarjen e ndikimit, shërbime shëndetësore dhe ndihmë humanitare. ➤ Ofrimi i informacionit të saktë dhe të shpejtë për qytetarët, përfshirë udhëzimet mbi sigurinë dhe procedurat e emergjencës. ➤ Vëzhgimi i situatës në terren për të përcaktuar nevojat e vazhdueshme dhe për të adresuar ndonjë ndryshim në situatën emergjente. ➤ Pas përfundimit të emergjencës, kryerja e një vlerësimi të dëmeve dhe nevojave për rindërtim dhe mbështetje.
<p>Institucione dhe struktura në nivel qarku</p>	
<p>Prefektura Gjirokastrë</p>	<p>Bazuar në PQEC:</p>

<p>Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave</p>	<p>Koordinimi dhe menaxhimi i emergjencës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi i struktura në nivel qarku për për reagim të harmonizuar. ➤ Sigurimi i aktivizimit dhe mbështetjes së forcave operacionale dhe vullnetarëve ➤ Ndërmjetësimi i ndihmës nga AKMC nëse kapacitetet në nivel qarku janë të pamjaftueshme. <p>Monitorimi dhe raportimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vëzhgimi i situatës dhe raportimi tek AKMC dhe institucionet përkatëse. ➤ Përditësimi i të dhënave mbi burimet emergjente dhe zonat e prekura. <p>Menaxhimi i burimeve dhe ndihmës</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi i shpërndarjes së ndihmës ndërkombëtare dhe furnizimit të infrastrukturës kritike dhe publike. ➤ Sigurimi i mbështetjes logjistike për operacionet e emergjencës. <p>Bashkëpunimi ndërinstytucional:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me bashkitë e qarkut dhe me prefektët e qarqeve fqinje për të bashkuar kapacitetet e tyre për përballimin e emergjencës; <p>Shkëmbimi i informacionit me AKMC-në, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve të tjera të prekura nga fatkeqësia ose në rrezik prej saj.</p> <p>Monitorimi dhe aktivizimi i masave emergjente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinon marrjen e masave të nevojshme për përballimin e situatës, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve të emergjencës, ➤ Aktivizon institucionet dhe administratat për ndërhyrje specifike. <p>Kërkesa për mbështetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Drejtimi i një kërkesë për mbështetje në AKMC, sipas kërkesës së bashkive
<p>Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Gjirokastrë</p>	<p>Menaxhimi i emergjencës dhe mobilizimi i burimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për menaxhimin e situatave emergjente, në veçanti për ujitjen dhe kullimin. ➤ Zbatimi i masave emergjente të menaxhimit të ujit gjatë fatkeqësive (p.sh. çlirimet e kontrolluara të ujit për të shmangur përmytjet dhe dëmtimet e infrastrukturës). <p>Monitorimi dhe vlerësimi i dëmeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave në bujqësi, në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në zonat e prekura nga fatkeqësia dhe identifikimi i ndërhyrjeve të menjëhershme për stabilizimin e rrejtës. ➤ Raportimi i dëmeve në sektorin e bujqësisë dhe

	<p>ndikimit në prodhimin bujqësor në zonat e prekura.</p> <p>Ndihma dhe mbështetja emergjente</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i funksionalitetit të rrjetit të kullimit për të shmangur përkeqësimin e situatës në zonat bujqësore. ➤ Koordinimi me autoritetet vendore dhe fermerët për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me ujë
<p>Agjencia Rajonale e Mjedisit</p>	<p>Mobilizimi dhe aktivizimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për adresimin e emergjencave që ndikojnë në mjedis. ➤ Monitorimi dhe menaxhimi i ndotjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, duke identifikuar zonat me risk të lartë. <p>Vlerësimi i dëmeve dhe ndikimit mjedisor</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Pjesëmarrja në bashkëpunim me strukturat e tjera për vlerësimin e dëmeve në mjedis. ➤ Identifikimi i rreziqeve mjedisore shtesë të shkaktuara nga emergjenca dhe propozimi i masave mbrojtëse. <p>Komunikimi dhe Koordinimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Shkëmbimi i informacionit me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencës dhe autoritetet vendore ➤ Ofrimi i udhëzimeve teknike për minimizimin e pasojave mjedisore dhe zbutjen e ndotjes në zonat e prekura.
<p>Shoqëria Ujësjellës Kanalizimeve sh.a Gjirokastër</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për furnizimin e vazhdueshëm me ujë në zonat e prekura. ➤ Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullatën dhe objektet kritike në zonat e prekura nga emergjenca. ➤ Ndërhyrja dhe riparimi i avarive në rrjetin e ujësjellësit për të rikthyer funksionalitetin sa më shpejt të jetë e mundur. ➤ Informimi i publikut për ndërprerjet, masat e ndërmarra, dhe këshilla për ruajtjen e higjienës në kushte emergjence. ➤ Koordinimi me strukturat e emergjencës për shpërndarjen alternative të ujit dhe asistencën në transportin e ujit në zonat e prekura.
<p>Drejtoria Rajonale e OSHEE-së/OST</p>	<p>Menaxhimi i ndërprerjeve dhe riparimi i rrjetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Menaxhimi i situatave të shkaktuara nga dëmtimet ose aksidentet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë energjetike. ➤ Organizimi i ekipeve të emergjencës për riparimin e defekteve dhe rikthimin e furnizimit me energji në zonat e prekura. <p>Koordinimi dhe reagimi operativ</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i sistemit të njoftimit dhe ndërhyrjes

	<p>emergjente në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe strukturat e emergjencave civile.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm për infrastrukturën kritike dhe publike si spitalet, institucionet publike dhe qendrat e emergjencës. <p>Informimi dhe komunikimi me publikun</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Njoftimi i publikut mbi ndërprerjet e energjisë dhe afatet e rikuperimit. ➤ Bashkëpunimi me institucionet vendore për të siguruar transparencë dhe koordinim efektiv gjatë emergjencave. <p>Ruajtja e funksionimit të infrastrukturës kritike</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i vazhdueshëm i rrjetit të shpërndarjes dhe parandalimi i mbingarkesave që mund të çojnë në dështime sistemike. ➤ Aktivizimi i mekanizmave alternativë për furnizim të energjisë në rast të ndërprerjeve të gjata.
<p>Drejtoria Rajonale e Kulturës</p>	<p>Mobilizimi dhe aktivizimi i strukturave.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivizimi i menjëhershëm të grupeve përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonat e prekura. ➤ Koordinimi me strukturat operationale të qarkut dhe qeverisjen vendore për ndërhyrje emergjente. <p>Mbrojtja e vlerave të trashëgimisët kulturore</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i evakuimit, sistemimin dhe ruajtjes së materialeve të rëndësishme nga institucionet e trashëgimisë kulturore, muzeumet dhe objektet monumentale. ➤ Sigurimi i masave mbrojtëse për parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme në objektet e trashëgimisë kulturore. <p>Mbështetja e komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe ndërhyrjeve psikosociale për lehtësimin e stresit të komunitetit të prekur nga fatkeqësia. <p>Vlerësimi i dëmeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objektet e trashëgimisë kulturore dhe institucionet muzeale. ➤ Hartimi i raporteve mbi dëmet dhe nevojat për restaurim dhe mbështetje.
<p>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijimi i linjave të qarta të komunikimit ndërmjet shkollave, mësuesve, prindërve për të ofruar përditësime dhe udhëzime për situatën. ➤ Identifikimi i nevojave emergjente të nxënësve dhe stafit (ushqim, ujë, mbështetje psikologjike). ➤ Garantimi i sigurisë së nxënësve dhe personelit dhe

	<p>evakuimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbatimi i protokolleve të sigurisë për nxënësit, stafin dhe ndërtesat e shkollave, duke u siguruar që ato të jenë të sigurta nga dëmtimet e mëtejshme. ➤ Mbështetja e evakuimit të shkollave të rrezikuara dhe sigurimi i transportit emergjent për nxënësit në zona të sigurta. ➤ Ofrimi i mbështetjes mjekësore, ndihmës së parë dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur. ➤ Mbështetje për popullatat e cenueshme (p.sh., fëmijët me aftësi të kufizuara ose ata në rrethana të veçanta). ➤ Sigurimi i vazhdimësisë së edukimit: ➤ Vlerësimi i shkollave që mund të rifillojnë funksionimin dhe përcaktimi i afateve për rikthimin në mësim. ➤ Përdorimi i metodave alternative të ofrimit të arsimit, si mësimi nëpërmjet programeve në internet, objektet e përkohshme shkollore ose metoda të tjera të mësimin në distancë, në rast të mbylljes së shkollave ose dëmtimit të infrastrukturës fizike. ➤ Koordinimi me personelin arsimor për të siguruar që mësimdhënia dhe të nxënësit mund të vazhdojnë edhe në mjedise të përkohshme ose të ndërprera.
<p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor /Spitali Bashkisë Përmet</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi i burimeve shëndetësore: Mbajtja në gatishmëri e dhomave të urgjencës, laboratorëve dhe mjekëve dhe infermierëve spemergjencat civileialistë për t’u përgjigjur emergjencave . ➤ Ndihma e parë dhe kujdesi emergjent: Ofrimi i ndihmës së parë dhe kujdesit mjekësor emergjent për të lënduarit në zonat e prekura. ➤ Kujdesi shëndetësor gjithëpërfshirës: Ofrimi i kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet për qytetarët e lënduar. ➤ Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës: Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës për t’iu përgjigjur situatave kritike. ➤ Rezerva farmaceutike: Sigurimi i një rezerve farmaceutike dhe një shërbimi farmaceutik rezervë për rastet e emergjencave masive. ➤ Parandalimi i sëmundjeve infektive: Marrja e masave për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve epidemike dhe infeksioneve. ➤ Trajtimi i kontaminimeve radioaktive dhe kimike: Trajtimi i rasteve të kontaminimit me materiale të rrezikshme dhe të kontaminuara. ➤ Karantina shëndetësore: Shpallja e gjendjes së

	<p>karantinës shëndetësore nëse është e nevojshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Evakuimi i pacientëve: Menaxhimi i operacioneve të evakuimit të pacientëve nga spitalet e dëmtuara në spitale të tjera. ➤ Transporti i të lënduarve: Sigurimi i transportit tokësor dhe ajror për personat e lënduar në zonat e prekura. ➤ Rezervimi i pajisjeve shtesë shëndetësore dhe gjakut: Aktivizimi i pajisjeve shtesë shëndetësore dhe rezervimi i gjakut për të përmbushur nevojat urgjente. ➤ Kontrolli i cilësisë së ujit: Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm dhe ujërave për përdorim shtëpiak. ➤ Kontrolli i higjienës: Monitorimi dhe sigurimi i higjienës shëndetësore në zonat e emergjencës dhe në vendet e akomodimit dhe strehimit të përkohshëm. ➤ Trajtimi i zonave të kontaminuara: Ofrimi i mbështetjes për trajtimin e zonave të prekura nga materiale të rrezikshme, nëse është e nevojshme. ➤ Mbështetja për strehimoret kolektive: Dhënia e ndihmës për strukturat që trajtojnë popullsinë e strehuar në strehimore kolektive të përkohshme. Shpërndarja e barnave: Organizimi i shpërndarjes së barnave mjekësore për pacientët dhe këshillimi për përdorimin e tyre.
<p>Përfaqësues të Forcave të Armatosura b2k Grehot Gjirokastrë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për evakuimin e popullatës civile. ➤ Asistencë për procesin e strehimit (të përkohshëm)/akomodimin e popullsisë së evakuuar gjatë emergjencës. ➤ Asistencë gjatë procesit të shpërndarjes të ndihmës ushqimore dhe ndihmës tjetër gjatë emergjencës. ➤ Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e tjera operacionale që veprojnë në territor. ➤ Në rastin e vërshimeve të lumenjve, asistencë për vendosjen e digave mbrojtëse dhe për punimet mbrojtëse në argjinatura. ➤ Asistencë për operacionet e mbrojtjes nga zjarret. ➤ Mbron infrastrukturën kritike dhe ndihmon në riparimet dhe pastrimin e mbeturinave gjatë emergjencave. ➤ Siguron rendin publik, menaxhon turmat dhe ruani asetet strategjike gjatë emergjencave
<p>Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë/ Komisariati</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivizimi dhe mobilizimi i burimeve për operacionet e kërkim-shpëtimit;

<p>Policisë Përmet</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Asistencë në ofrimin e ndihmës së parënë bashkëpunim me strukturat shëndetësore; ➤ Evakuimi dhe sigurimi i zonës së emergjencës; ➤ Identifikimi dhe dokumentimi i personave të lënduar dhe të vdekur në bashkëpunim me institucionet përkatëse; ➤ Izolimi dhe mbrojtja e zonës së emergjencës për të parandaluar hyrjet e paautorizuara; ➤ Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike; ➤ Garantimi i qarkullimit normal në akset rrugore dhe devijimi sipas nevojës; ➤ Bashkëpunimi në veprimet e mëtejshme hetimore; ➤ Shoqërimi i automjeteve të evakuimit, emergjencave dhe ndihmës humanitare; ➤ Vënien në dispozicion të operacioneve në zonat e dëmtuara, automjetet, materialet dhe burimet njerëzore, sipas nevojës dhe kapacitetit; ➤ Asistencë në komunikim informativ dhe radio përfshirë mbështetjen në koordinimin me strukturat operacionale; ➤ Organizimi i shërbimit të përforcuar në të gjitha objektet e një rëndësie të veçantë, dhe në degët territoriale të institucioneve qendrore ose të institucioneve në varësi të tyre; ➤ Garantimi i kushteve normale për ekipet e huaja të ndihmës dhe mediat që operojnë në zonën e dëmtuar; ➤ Mbrojtja e kampingjeve të ngritura për familjet e evakuuara; ➤ Marrja dhe përpunimi i informacionit mbi situatën dhe nevojat emergjente; ➤ Vigjilenca dhe gatishmëria për situata të tjera të mundshme.
<p>Dega e Kryqit të Kuq Gjirokastër</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mobilizimi dhe grumbullimi i ekipeve që ndërhyjnë në raste fatkeqësish. ➤ Vlerësimi paraprak i situatës dhe prioritizimi i ndërhyrjeve në zonën më problematike në bashkëpunim me strukturat përkatëse. ➤ Sigurimi i masave të menjëhershme mbrojtëse dhe jetëshpëtuese për zonat e prekura nga fatkeqësitë duke ofruar ndihmën e parë dhe mbështetje për strehimin emergjent. ➤ Mbledhja dhe raportimi i të dhënave mbi dëmet dhe nevojat e komunitetit, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse. ➤ Shpërndarja e ndihmave humanitare për grupet më të

	<p>cenueshme.</p> <ul style="list-style-type: none">➤ Informimi i popullatës për masat e higjienës dhe shëndetit publik në kushte emergjente.➤ Vepron në përputhje me rolin e shoqatës dhe standardet ndërkombëtare në përgjigjen ndaj fatkeqësive.➤ Ofrimi i mbështetjes psikologjike për të prekurit nga fatkeqësia. <p>Dega rajonale koordinon punën me KMCB për çdo ndërhyrje gjatë emergjencave.</p>
--	---

6.5 / Funkcionet e Përgjigjes

1. Organizimi, drejtimi dhe koordinimi

- Në nivel bashkie: KMCB kryesohet nga kryetari i bashkisë. Ajo është struktura kryesore përgjegjëse për marrjen e masave për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe drejtimin e menaxhimit të emergjencave për bashkinë.
- Në nivel qarku: KMCQ kryesohet nga prefekti. Ajo struktura kryesore që merr masa për menaxhimin dhe drejtimin gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave për qarkun.
- Për emergjencat kombëtare kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, AKMC/MM dhe KMC janë përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Për emergjencat kombëtare kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, KNEC është përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Në rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për të drejtuar strukturat e emergjencës civile caktohen drejtuesit e mëposhtëm të operacioneve:
- DQO në nivel qendror, i cili emërohet nga KNEC;
- DOQ, i cili emërohet nga prefekti;
- DOB, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë.

2. Aktivizimi dhe koordinimi i strukturave operacionale në nivel bashkie

Aktivizimi i forcave operacionale në nivel bashkie, bëhet nga Kryetari i bashkisë, ndërsa bashkërendimi i strukturave të Policisë së Shtetit (PSH), Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), Forcave të Armatosura (FA) dhe Shërbimit të Urgjencës Mjekësore (SHUM) në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë, janë përgjegjësi e Prefektit, i cili këshillohet nga KMCQ.

3. Evakuimi

Evakuimi është një proces i planifikuar për zhvendosjen e popullsisë nga një zonë e rrezikuar ose me një kërcënim të afërt drejt një vendndodhjeje të sigurt. Ky proces mund të jetë **i paracaktuar**, bazuar në analiza të riskut dhe skenarët e identifikuar të rrezikut, ose **i menjëhershëm**, kur situatë përkeqësohet papritur dhe kërkohet reagim urgjent.

Duke qenë një masë thelbësore për mbrojtjen e **jetës dhe pronës**, evakuimi kërkon **një qasje të koordinuar** midis strukturave shtetërore, autoriteteve vendore dhe komunitetit. Një zbatim efektiv siguron që popullsia të zhvendoset në mënyrë të sigurt dhe të organizuar, ndërsa rikthimi në zonat e prekura ndodh vetëm pas vlerësimit dhe garantimit të sigurisë nga autoritetet përgjegjëse.

Përgjegjësitë institucionale për evakuimin

- Në nivel bashkiak, përgjegjësia kryesore për planifikimin dhe ekzekutimin e evakuimit i takon kryetarit të bashkisë, duke përfshirë identifikimin e zonave të mundshme të evakuimit në mjediset urbane dhe rurale, bazuar në Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor dhe analizat e territorit në kohë reale.
- Në nivel qarku, evakuimi është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, i cili koordinon me bashkitë për të siguruar mbështetje shtesë, burime dhe menaxhimin e evakuimit masiv në situata të gjera emergjente.
- Forcat operacionale në terren, duke përfshirë Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe struktura të tjera, mund të urdhërojnë evakuim të menjëhershëm në territore të kufizuara kur identifikohen kërcënime të menjëhershme për jetën dhe sigurinë publike.

Prioritetet dhe menaxhimi i evakuimit

- Evakuimi priorizon popullsinë në rrezik, duke nisur me individët më të cënueshëm, si të miturit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna dhe të sëmurët.
- Pas popullsisë, evakuohet gjëja e gjallë dhe më pas sendet e domosdoshme shtëpiake, nëse situata e lejon.
- Në rastet kur mundësitë për transport të menjëhershëm janë të kufizuara, evakuimi kryhet në fazat e përparësisë, duke siguruar fillimisht largimin e grupeve më të rrezikuara.

Zbatimi i evakuimit dhe kthimi në zonën e evakuuar

- Strukturat përgjegjëse për zbatimin e evakuimit përfshijnë strukturat bashkiake, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, institucionet publike dhe operatorët privatë, duke siguruar mbështetje logjistike dhe operacionale.
- Rikthimi i popullsisë në zonën e evakuuar bëhet vetëm pas vlerësimit dhe deklarimit të sigurisë nga autoritetet përgjegjëse.
- Policia e Shtetit merr masa për kontrollin e aksesit në zonën e evakuuar dhe monitoron territorin për të parandaluar hyrjet e paautorizuara dhe veprimtaritë e paligjshme pas emergjencës.
- Objektet e strehimit të përkohshëm, në rast të evakuimi shif Aneks 4: “Tabela e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike”

4. Kërkim shpëtimi

Qëllimi i kërkim-shpëtimit është gjetja e vendndodhjes së të lënduarve dhe shpëtimi i atyre që janë ende në rrezik. Ekipe të Kombëtare të Kërkimit dhe Shpëtimit (EKKSH) sigurohen nga FA e MM, MB, strukturat e shërbimit zjarrfikës, grupet vullnetare etj. Në rastet e emergjencave civile kombëtare, Operacionet e Kërkimit dhe Shpëtimit (OKSH) mbështeten nga EKKSH dhe strukturat e shërbimit zjarrfikës, PSH, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIEn) dhe grupet ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit kur thirren për të ndihmuar.

Në bashkinë Përmet forcat që angazhohen në operacionet e kërkim shpëtimit janë forcat e MZSH-së bashkisë personel 14 veta, Komisariati Përmet dhe nëse është e nevojshme Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, Komisariatet Gjirokastër, Tepelenë dhe Stacionet e Policisë Memaliaj dhe Këlcyrë të mbështetura nga NJVKSh Përmet, strukturat e MZSH-së të bashkive të tjera të qarkut, Reparti Ushtarak grehot Gjirokastër, të cilat mbështeten nga Policia bashkiake e cila ka një personel prej 5 vetash, Dega KKSHPërmet, si dhe struktura të tjera të kërkim shpëtimit që mund të vijnë nga institucionet qendrore, si dhe ekipe ndërkombëtare në raste kur ato janë thirrur për ndihmë.

5. Ndihma e parë në situata emergjente

Ndihma e parë do të jepet nga SHUM, ekipe të urgjencës, autoambulancat, qendrat shëndetësore dhe nga spitali rajonal në bashkinë ose qarkun përkatës. Të gjitha këto njësi dhe shërbime do të mbështeten nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH).

Në bashkinë Përmet, çdo njësi administrative ka qendrën shëndetësore apo ambulancën e saj. Ambulancat e fshatrave kanë personel vetëm infermierë.

Ka prezencë të autoambulancave në raste rreziku të cilat janë në varësi të Spitalit. Staf i mjekësor është i trajnuar dhe vazhdimisht bën trajnime për ndihmën e parë dhe për çështjet e shërbimit shëndetësor në përgjithësi.

6. Mirëmbajtja e infrastrukturës publike në situata emergjente

Fatkeqësitë mund të dëmtojnë ose shkatërrojnë infrastrukturën publike dhe kritike, si rrjetin rrugor, ujësjellësin, kanalizimet, rrjetin elektrik, telekomunikacionin, etj. Këto shkatërrime kanë pasoja negative për funksionimin ekonomik dhe social të komunitetit. Bashkia në bashkëpunim me prefektin punojnë me ofruesit e shërbimeve bashkiake për mbrojtjen, menaxhimin dhe riparimin e infrastrukturës publike gjatë emergjencave dhe fatkeqësive.

Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për punimet emergjente për riparimin dhe rikuperimin e infrastrukturës publike dhe kritike, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”. Bashkia Mallakastër duhet të identifikojë strukturat kryesore me përgjegjësi në fushën e rehabilitimit të infrastrukturës publike dhe kritike.

7. Vlerësimi i Nevojave

Koordinimi për vlerësimin e nevojave për emergjenca civile vendore, është nën përgjegjësinë e bashkisë të prekur, e mbështetur nga Prefekti i Qarkut që koordinon degët territoriale dhe kapacitete të tjera në qark, sipas nevojës.

Koordinimi kombëtar i emergjencave civile për vlerësimin e nevojave është nën përgjegjësinë e KNEC kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përmes Grupeve të Vlerësimit Ndërinstitucional. Këto grupe mbështeten drejtpërdrejt nga AKMC dhe përmbajnë specialist nga ministritë e linjës dhe institucione të tjera në varësi

8. Vlerësimi i dëmeve (në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit)

Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturë dhe ndërtesa për emergjencat shkallës së ulët, sipas rastit, është përgjegjësi e bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut. Për infrastrukturën dhe asetet në administrim të ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe subjekteve private, ato janë vetë përgjegjëse kryesore për vlerësimin e dëmeve.

Në rastet e emergjencave të shkallës më të lartë, përgjegjësia kryesore për vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë dhe objektet e ndërtimit është e pronarëve apo administratorëve të tyre të cilët do të mbështeten, sipas nevojës, nga grupet e përbashkëta të vlerësimit.

Në bashkinë e Mallakastrës për vlerësimin e dëmeve do të angazhohen Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Territorit dhe Policisë Bashkiake; Drejtoria Administrimit, Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve; Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit; Drejtoria e Bujqësisë, Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit; Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Arsimit dhe Shëndetësisë, njësitë administrative që bëjnë pjesë në strukturën e bashkisë, kurse disa nga degët territoriale që angazhohen në vlerësimin e dëmeve janë Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Gjirokastër, Agjencia Rajonale e Mjedisit Gjirokastër, etj.,

Komisioni i vlerësimit të dëmeve në nivel bashkie ngrihet dhe funksionon me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Gjithashtu, formularët, afatet, procedurat për vlerësimin e dëmeve dhe çështje të tjera që do të lidhën me këtë proces do të miratohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Në nivel qarku komisioni i vlerësimit të dëmeve ngrihet dhe funksionin me urdhër të Prefektit të qarkut, si dhe formularët, afatet, procedurat për vlerësimin e dëmeve dhe çështje të tjera që do të lidhën me këtë proces do të miratohen me urdhër të Prefektit.

9. Identifikimi dhe sigurimi i strehimeve të përkohshme

Vlerësimi i nevojave për strehim dhe identifikimi paraprak i objekteve dhe zonave për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut. Menaxhimi i strehimit të të evakuuarve gjatë emergjencës është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut, të mbështetur nga AKMC/ DQO në nivel qendror.

Duhet të sigurohet që grupet më të cënueshme të mos diskriminohen në planifikimin, hartimin ose caktimin e strehimit të përkohshëm pas fatkeqësisë, i cili duhet të jetë i arritshëm dhe funksional në përputhje me nevojat e tyre. Ata nuk duhet të diskriminohen as në caktimin e strehimeve të përkohshme dhe as në banesat e përhershme. Për vendstrehimet shif Aneks 4:

Tabela e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike.

10. Sigurimi dhe shpërndarja e ndihmës

Emergjencat civile vendore dhe rajonale

Dhënia e ndihmës së parë ushqimore dhe ndihmave të tjera gjatë një situatë EC kryhet nga bashkia nëpërmjet mobilizimit të kapaciteteve të saj, bazuar në PVEC. Bashkia mund të kërkojë edhe angazhimin e kapaciteteve të subjekteve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe të bizneseve. Nëse është e nevojshme, për këtë qëllim kërkon edhe mbështetjen e prefektit të qarkut.

Emergjencat civile kombëtare

Koordinimi për sigurimin, furnizimin, magazinimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës kombëtare kryhet nga DOQ/AKMC në bashkëpunim me DPRMSH, prefektin dhe bashkinë. Në nivel kombëtar shpërndarja e ndihmave koordinohet nga AKMC. Në nivel vendor nga prefekti dhe organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSH (për asistencën me barnat), vullnetarët dhe Kryqin e Kuq.

11. Shëndeti publik

NJVKSH është përgjegjëse për Ndihmën e Parë Shëndetësore në nivel bashkie. Ajo është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve emergjente dhe kujdesit parësor shëndetësor përmes qendrave/ klinikave shëndetësore. NJVKSH dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) janë përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe higjienës, si dhe për zbatimin e programit të vaksinimit të popullatës.

Në bashkinë Përmet qendrat shëndetësore, ambulancat i kanë të evidentuar personat e sëmurë që marrin trajtim mjekësor në mënyrë të vazhdueshme, personat me aftësi të kufizuara, vendodhjen e tyre, në mënyrë që në raste emergjente të ju vihet në ndihmë dhe të mos ju mungojnë shërbimet shëndetësore.

12. Shëndeti mendor dhe shërbimet mbështetëse

Mbështetja psiko-sociale në emergjencë është thelbësore për të ndihmuar individët dhe komunitetet të përballen me ndikimet psikologjike dhe sociale të krizave, të tilla si fatkeqësitë natyrore, konfliktet e armatosura ose ndërprerjet e rëndësishme të jetës. Ky PVEC fokusohet në elementët kryesorë të mbështetjes shëndetësore mendore, si:

- **Mbështetje emocionale e menjëhershme** Sigurimi i një ndjenje sigurie dhe qetësie. Kjo mund të përfshijë ndihmën e parë psikologjike, e cila përfshin dëgjimin aktiv, sigurinë dhe ndihmën e njerëzve për të rivendosur njëfarë ndjenje të normalitetit.
- **Nevojat dhe shërbimet bazë** Sigurimi i aksesit në ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe nevoja të tjera bazë, pasi mungesa e tyre mund të përkeqësojë stresin dhe traumën.
- **Rrjetet e mobilizimit dhe mbështetjes së komunitetit** Forcimi ose rindërtimi i rrjeteve të komunitetit për të ofruar lidhje dhe mbështetje sociale, të cilat mund të jenë një mbrojtës jetik kundër stresit.
- **Qasja në shërbimet e shëndetit mendor** Ofrimi i këshillimit, terapisë ose grupeve të organizuara mbështetëse për individët ose familjet, duke i ndihmuar ata të përpunojnë emocionet dhe përvojat.

- **Edukimi dhe hapësira miqësore për fëmijët** Krijimi i mjediseve ku fëmijët mund të luajnë, të mësojnë dhe të rifitojnë ndjenjën e rutinës, stabilitetit dhe normalitetit. Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki ka rolin drejtues në këtë funksion.
- **Mbështetja psikosociale për forcat e reagimit ndaj emergjencave** Zjarrfikësit, policia, personeli mjekësor dhe punonjësit e ndihmës në raste fatkeqësish hasin në situata stresuese dhe traumatike gjatë përgjigjes në raste emergjencash apo fatkeqësish. Mbështetja psikosociale për forcat e reagimit pas emergjencave është thelbësore për mirëqenien dhe efektivitetin e tyre. Një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin diskutimin, mbështetjen e kolegëve, këshillimin, menaxhimin e stresit, mbështetjen organizative i ndihmon forcat e përgjigjes që të menaxhojnë sfidat emocionale dhe psikologjike me të cilat përballen në mjediset me stres të lartë. Në bashkinë Përmet rolin kryesor për mbështetjen psiko-sociale në emergjencë do ta luajë bashkia nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, si dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Përmet nëpërmjet punonjësve të shërbimit psikosocial që punojnë në shkolla.

13. Logjistika (transport, magazinim, etj.)

Në rastet e emergjencave civile vendore, nevojat për shërbime transporti dhe ruajtjeje në përgjithësi plotësohen nga vetë kapacitetet e bashkisë. Kur bashkia nuk ka kapacitetet e nevojshme, i drejtohet prefektit për të koordinuar sigurimin e kapaciteteve shtesë nga degët territoriale të institucioneve në qark. Bashkia mund të kërkojë, në koordinim me Prefektin sigurimin e kapaciteteve të caktuara të subjekteve private ose OJF-ve sipas deklaratave të tyre të marra zyrtarisht në periudhën para fatkeqësisë.

14. Bashkimi familjar

Kur ndodh një fatkeqësi në këto raste, ndodh shpesh që familjarët apo të afërmit të ndahen dhe të humbasin lidhjet me njëri-tjetrin dhe për rrjedhojë, bëhet e nevojshme rivendosja e lidhjeve familjare. Shërbimet e ribashkimit ofrojnë ndihmë për fëmijët e ndarë nga prindi/kujdestari ligjor, si dhe të rriturit nga familjet e tyre, për shkak të fatkeqësisë, si dhe mbështesin përpjekjet e ribashkimit në nivel lokal ose më gjerë me asistencë teknike.

Në bashkinë Përmet rolin kryesor në këtë funksion e ka Sektori e Mbrojtjes Civile, Territorit dhe Policisë Bashkiake e cila do të jetë përgjegjëse për koordinimin e veprimeve dhe menaxhimin e situatës. Gjithashtu, Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale në bashki, do të jetë përgjegjëse për identifikimin e nevojave të qytetarëve dhe ofrimin e mbështetjes për ribashkimin. Komisarati i Policisë Përmet do të jetë përgjegjës për të siguruar sigurinë dhe për të lehtësuar lëvizjen e njerëzve përmes zonave të ndikuara nga emergjenca, si dhe do të ndihmojnë për realizimin e bashkimit familjar. NJVKSH Përmet do të jetë në mbështetje për realizimin e mbështetjes shëndetësore. Kryqi i kuq Përmet do të kontribuojë gjithashtu në ribashkimin familjar.

Protokollet Specifike që mund të përdoren:

Komunikimi dhe Identifikimi: Krijimi i një sistemi të shpejtë dhe efikas për të ndihmuar individët të identifikojnë dhe të lokalizojnë anëtarët e familjes. Kjo mund të përfshijë përdorimin e databazave për emra dhe informacion personal.

Qendra të Ribashkimit Familjar: Krijimi i pikave të koordinuara në qendra emergjence, ku individët mund të regjistrohen dhe të kërkojnë informacion për të afërmit e tyre.

Verifikimi i Informacioneve: Përdorimi i teknologjisë për të verifikuar identitetin e individëve dhe për të siguruar që ribashkimi të bëhet në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

Përgatitja dhe Trajnimi i Stafit: Stafit që do të merret me ribashkimin duhet të jetë i trajnuar për të menaxhuar stresin dhe për të zbatuar protokollin e emergjencës.

Koordinimi me Qendrat Kombëtare dhe Ndërkombëtare: Bashkitë duhet të kenë marrëveshje dhe protokolle për të bashkëpunuar me qendrat kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare për ndihmën humanitare dhe transportin e sigurt të individëve.

Mjetet që do të Përdoren për të realizuar bashkimin familjar:

Teknologjia e Komunikimit: Përdorimi i aplikacioneve mobile, rrjeteve sociale dhe sistemeve të informacionit për të shpërndarë informacion rreth statusit të emergjencës dhe për të ndihmuar individët të lokalizojnë të afërmit e tyre.

Databaza të Përshtatshme: Përdorimi i një databaze të centralizuar për regjistrimin e individëve të humbur dhe të gjetur, që mund të lehtësojë kërkimet dhe ribashkimin. Transporti dhe Lëvizshmëria: Përdorimi i mjeteve të transportit për të mundësuar lëvizjen e sigurt të personave dhe rikthimin e tyre në vendet ku ndodhen të afërmit e tyre.

Kamera dhe Sisteme të Sigurisë: Përdorimi i kamerave dhe sistemeve të tjera për të monitoruar dhe verifikuar sigurinë e qendrave të ribashkimit.

Mbështetje Psikologjike: Ofrimi i mbështetjes psikologjike për individët, fëmijët dhe familjet që janë të goditura nga trauma emocionale pas një emergjence, për të siguruar një ribashkim të qetë dhe të kontrolluar.

15. Rendi dhe siguria publike

Për situata të jashtëzakonshme, çështjet e sigurisë drejtohen nga Presidenti i Republikës, këshillohen nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe mbështeten nga MM, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë. Në rastet e emergjencës kombëtare, kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përgjegjësia e përgjithshme për sigurinë dhe rendin publik i përket KNEC nëpërmjet strukturave të PSH, FA dhe autoriteteve në nivel qarku e bashkie nëpërmjet strukturave së tyre.

Në nivel bashkie masat e sigurisë, ruajtja e rendit publik dhe kontrolli i qarkullimit sigurohen përkatësisht nëpërmjet strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër dhe Komisarariatit të Policisë Përmet, si dhe nëse është e nevojshme dhe nga Komisarariatet e Policisë , dhe stacionet e Policisë të qarkut Gjirokastër

Në të gjitha rastet e emergjencave, në nivel bashkie, rolin kryesor në zbatimin e ligjit dhe masat e ruajtjes së rendit do ta ketë Komisarati i Policisë Përmet i mbështetur nga Policia Bashkiake. Në raste të veçanta do të mbështeten edhe nga FA. E rëndësishme në rastet e evakuimeve është si mbrojtja e vendbanimeve të braktisura për shkak të emergjencës ndaj autorëve, ashtu edhe mbrojtja e qendrave të pritjes dhe strehimit.

7. Rimëkëmbja

7.1 / Parimet e Rimëkëmbjes dhe zbatimi i tyre në bashkinë Përmet

Faza e *Rimëkëmbjes* pason atë të përgjigjes emergjente dhe luan një rol kyç në kthimin e komunitetit drejt normalitetit. Sukses i kësaj faze varet nga vazhdimësia dhe integrimi i saj me fazat e parandalimit dhe gatishmërisë. Për Bashkinë Mallakastër, nevoja për t'u mbështetur në Planin Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) është thelbësore në këtë periudhë.

Një komponent kyç i rimëkëmbjes është planifikimi i zonave të emergjencës, duke përfshirë:

- ✚ Zonat e dedikuara për vendosjen e qendrave të pritjes dhe akomodimit emergjent të Mbrojtjes Civile (MC).
- ✚ Strukturat e mbuluara për strehimin e përkohshëm të popullsisë.

Këto hapësira duhet të jenë të mbrojtura nga çdo lloj rreziku, duke siguruar përdorimin e tyre pa kufizime gjatë emergjencave. (*Shih Kreun 5, Seksioni 5.4.*)

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është menaxhimi i mbetjeve dhe rrënojave, i cili kërkon planifikim të saktë për të shmangur ndikimet negative mjedisore dhe shëndetësore.

Në aspektin programor, faza e rimëkëmbjes në nivel bashkie duhet të jetë në përputhje me parimet që përmban PKEC, i cili parashikon identifikimin e masave të rimëkëmbjes afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Masat afatshkurtra (ditë)	Masat afatmesme (javë-muaj)	Masat afatgjata (muaj, vite)
<p>Strehimi dhe kujdesi emergjent</p> <p>–Ofrimi i strehimit të përkohshëm dhe shërbimeve të emergjencës për popullsinë e prekur.</p> <p>• Mbetjet/Infrastruktura</p> <p>–Pastrimi i akseve kryesore të transportit.</p> <p>• Sektori tregtar</p> <p>–Krijimi i infrastrukturës së përkohshme për mbështetjen e rihapjes së bizneseve</p> <p>• Aspektet psikosociale</p> <p>–Identifikimi i të rriturve dhe fëmijëve që kanë nevojë për këshillim psikosocial dhe fillimi i trajtimit të</p>	<p>•Strehimi dhe kujdesi emergjent</p> <p>–Sigurimi i zgjidhjeve të aksesueshme dhe të qëndrueshme për strehimin.</p> <p>•Mbetjet/Infrastruktura</p> <p>–Fillimi i largimit të mbetjeve dhe rrënojave, si edhe planifikimi i riparimeve dhe restaurimit të menjëhershëm të infrastrukturës së dëmtuar.</p> <p>•Sektori tregtar</p> <p>–Mbështetja e rimëkëmbjes dhe rifillimit të bizneseve aty ku është e realizueshme.</p> <p>•Aspektet psikosociale</p> <p>–Angazhimi i rrjeteve mbështetëse për ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes së vazhdueshme.</p> <p>•Shëndeti Publik dhe</p>	<p>• Strehimi dhe kujdesi emergjent</p> <p>–Zgjidhje të përhershme strehimi</p> <p>• Mbetjet/Infrastruktura</p> <p>– Rindërtimi i infrastrukturës në funksion të nevojave të ardhshme të komunitetit.</p> <p>• Sektori tregtar</p> <p>– Zbatimi i strategjive të rigjallërimit ekonomik.</p> <p>• Aspekte psikosociale</p> <p>– Vijimi i programeve të këshillimit psikosocial dhe mbështetjes shëndetësore për komunitetin e prekur.</p> <p>• Shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor</p>

<p>përshtatshëm shëndetësor.</p> <p>•Shëndeti Publik dhe Kujdesi Shëndetësor</p> <p>–Sigurimi i kujdesit mjekësor urgjent dhe të përkohshëm, si dhe krijimi i protokolleve të përshtatshme të mbikëqyrjes.</p> <p>•Aktivitetet lehtësuese/zbutëse</p> <p>–Vlerësimi i risqeve dhe cenueshmërive</p>	<p>Kujdesi Shëndetësor</p> <p>–Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore përmes strukturave të përkohshme, sipas nevojës.</p> <p>•Aktivitetet lehtësuese/zbutëse</p> <p>–Informimi i komunitetit mbi mundësitë për një rindërtim më të qëndrueshëm dhe të sigurt.</p>	<p>– Rimëkëmbja dhe rehabilitimi i objekteve të dëmtuara të kujdesit shëndetësor.</p> <p>• Aktivitetet lehtësuese/zbutëse</p> <p>–Zbatimi i strategjive dhe masave të lehtësimit/zbutjes.</p>
---	--	--

Aktivitetet duhet të zhvillohen sipas madhësisë dhe karakteristikave të bashkisë.

7.2 / Aktivitetet afatshkurtra

1. Ndihma për popullatën

QOECB merr masa për hapjen e strehimoreve emergjente dhe pajisjen e tyre me dyshekë, çarçafë, jastëkë dhe batanije për të pritur popullatën e prekur nga emergjenca dhe të evakuuar përkohësisht nga shtëpitë e tyre dhe organizon praninë e të paktën një ekipi të përbërë nga të paktën katër persona përgjegjës për çdo zonë. Çdo zonë mund të menaxhojë deri në 250 persona (në këtë rast me të paktën 10-20 persona të përkushtuar për ndihmën e tyre) dhe në fazën e parë vijon me regjistrimin e personave që vijnë në zona dhe realizimin e çdo nevoje shërbimi shëndetësor. Sigurimi dhe shpërndarja e furnizimeve bazë ushqimore në zonat e emergjencës dhe përgatitja e vakteve.

2. Rivendosja e infrastrukturës dhe shërbimeve

Gjatë periudhës afatshkurtër strukturat operationale janë përgjegjëse për restaurimin e infrastrukturave të zëna nga mbeturinat, rrënojat, mbetjet e përmytjeve, mbetjet e grumbulluara nga popullata e prekur nga ngjarja. Punime jashtëzakonisht urgjente duhet të kryhen për restaurimin e rrugëve dhe infrastrukturës teknologjike që mund të kenë pësuar dëmtime.

7.3 / Aktivitetet afatmesme

1. Ndihma për popullatën

Verifikimi i strehimit dhe kthimi i të evakuuarve në shtëpitë e tyre të përhershme. Për ata, shtëpitë e të cilëve janë të papërdorshme, identifikohen sa më shpejt zgjidhjet alternative, duke filluar për shembull nga dhomat e hoteleve, duke marrë parasysh një kufi maksimal prej 30-60 ditësh për pritjen e popullsisë në zonat e emergjencës. Prioritet duhet t'i jepet nënshkrimit, përfshirë prefekturën dhe AKMC, të një marrëveshjeje ndërmjet shoqatave të hotelierisë dhe bashkisë, në të cilën përcaktohet çmimi i dhomës dhe i ushqimeve të servirura.

2. Rivendosja e infrastrukturës dhe shërbimeve

Gjatë periudhës afatmesme KMCB organizon studimin e parë të dëmtimit të infrastrukturës dhe caktimin e punimeve restauruese, duke kërkuar aty ku është e nevojshme mbështetjen ekonomike të prefekturës dhe AKMC. Ofrohen shërbime si furnizimi me ujë, energji elektrike, gaz, të gjitha këto që duhen riparuar në këtë fazë, në mënyrë që zonat e prekura nga ngjarja të bëhen sërish të banueshme.

3. Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor, jo më urgjent, por i vazhdueshëm, kryhet duke u përpjekur të rivendosë sa më shumë kushtet para ngjarjes.

4. Aktivitete prodhuese

Aktivitetet e rikuperimit, pasi të jenë plotësuar nevojat për ndihmë për popullatën e prekur, duhet të kenë të bëjnë edhe me kompanitë që kanë pësuar dëme si pasojë e emergjencës. Në veçanti i referohen aktiviteteve për pastrimin e baltës dhe mbeturinave dhe monitorimin e dëmeve.

7.4 / Aktivitetet Afatgjata

Periudha afatgjatë e rimëkëmbjes mund të zgjasë me muaj apo vite dhe mbështetet në zbatimin e detyrave të një komisioni të posaçëm të ngritur nga qeveria për të kanalizuar të gjitha energjitë drejt aktiviteteve rimëkëmbëse.

1. Ndihma për popullatën

Në këtë fazë duhet të gjenden zgjidhje të qëndrueshme për të ndihmuar popullatën që ka humbur shtëpitë e saj dhe për këtë arsye kërkon ndihmë për periudha të gjata. Ka dy opsione:

- Ndërtimi i zgjidhjeve të përkohshme të banimit;
- Sigurimi i kontributeve për një shtëpi me qira;

2. Restaurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve

Në këtë fazë hartohet plani për restaurimin e plotë të infrastrukturave dhe realizohen ndërhyrjet me synimin për të kryer edhe zbutjen e rrezikut në krahasim me kushtet para ngjarjes.

3. Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor, jo më emergjent, por tashmë i vazhdueshëm, vazhdon në mënyrë progressive duke rivendosur kushtet para ngjarjes.

7.5 / Roli i institucioneve, strukturave dhe aktorëve të tjerë institucionalë gjatë rimëkëmbjes

Tabela 9: Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre në fazën e rimëkëmbjes – Bashkia Përmet

Institucionet, strukturat dhe palët e përfshira	Përgjegjësitë në fazën e Përgjigjes
Institucione dhe struktura në nivel bashkie	
Bashkia Përmet KMCB Sektori Mbrojtjes Civile	➤ Shërben si një qendër për organizimin dhe monitorimin e përpjekjeve për rimëkëmbje ndërmjet palëve të interesuara lokale.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijon një grup pune për rimëkëmbjen për të siguruar komunikim dhe bashkëpunim efektiv midis palëve të interesuara. ➤ Kryen vlerësime gjithëpërfshirëse të dëmeve të infrastrukturës, strehimit dhe shërbimeve kritike. ➤ Identifikimi i nevojave imediate dhe afatgjata të popullsisë së prekur për t'i dhënë përparësi veprimeve të rimëkëmbjes. ➤ Ndhmon në zhvendosjen e individëve dhe familjeve duke garantuar sigurinë e tyre. ➤ Trajnon stafin lokal dhe vullnetarët në strategjitë dhe procedurat e rimëkëmbjes pas fatkeqësisë. ➤ Forcimi i kapaciteteve institucionale për të menaxhuar projektet e rimëkëmbjes afatgjatë. ➤ Dokumenton mësimet e nxjerra për të përmirësuar planet e ardhshme të menaxhimit të emergjencave civile. ➤ Mban komunitetin të informuar për planet e rimëkëmbjes, afatet kohore dhe përparimin përmes përditësimeve të rregullta. ➤ Vlerëson efektivitetin e PVEC bazuar në përvojat e rimëkëmbjes. ➤ Përditëson politikat, protokollet dhe PVEC duke pasqyruar mësimet e nxjerra.
<p>Drejtoria e Financë – Buxhetit</p> <p>Spektori Financës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Alokon fonde për aktivitetet e rimëkëmbjes së menjëhershme dhe afatgjatë. ➤ Identifikon dhe siguron burimet e financimit, duke përfshirë grantet qeveritare, ndihmën ndërkombëtare dhe partneritetet publiko-private. ➤ Aplikon për fondet e ndihmës për fatkeqësitë dhe menaxhon ndihmën financiare nga donatorë të jashtëm. ➤ Monitoron disbursimin dhe përdorimin e fondeve të rikuperimit për të siguruar transparencë dhe për të parandaluar keqpërdorimet. ➤ Lehtëson aksesin në kredi për individët dhe bizneset për të rindërtuar mjetet e jetesës. ➤ Bashkëpunon me departamente të tjera për të siguruar që fondet të shpërndahen në mënyrë efektive në projektet e rimëkëmbjes. ➤ Drejton proceset e prokurimit për të siguruar blerjen në kohë të materialeve, pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për rikuperim. ➤ Alokon fonde për projektet që rrisin aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, të tilla si përmirësimi i infrastrukturës për t'u bërë ballë rreziqeve të ardhshme.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Dokumenton mësimet e nxjerra për të përmirësuar planifikimin financiar për EC në të ardhmen. ➤ Bashkëpunon me sektorin e emergjencave civile për të integruar strategjitë financiare në planet e përditësuara të menaxhimit të emergjencave.
<p>Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Territorit, Monitorimit të Shërbimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të zonave të prekura për të përcaktuar shkallën e dëmtimit të infrastrukturës dhe tokës. ➤ Përdor sistemet GIS për të krijuar harta që informojnë planifikimin e rimëkëmbjes. ➤ Zbatimi i rregulloreve të zonave që parandalojnë rindërtimin në zonat me risk të lartë, duke zvogëluar kështu cenueshmëritë e ardhshme. ➤ Bashkëpunon me departamente të tjera për t'i dhënë përparësi dhe për të mbikëqyrur rindërtimit të infrastrukturës kritike, si rrugët, urat dhe shërbimet komunale. ➤ Harton politika që lehtësojnë proceset e lejeve dhe miratimit për projektet e rimëkëmbjes. ➤ Koordinohet me agjencitë kombëtare dhe donatorët ndërkombëtarë për të siguruar asistencë financiare dhe teknike. ➤ Krijimi i mekanizmave për të ndjekur progresin e projekteve të rimëkëmbjes dhe për të vlerësuar efektivitetin e tyre. ➤ Angazhohet për të identifikuar dhe vlerësuar dëmet strukturore dhe sugjeron/merr masat e nevojshme për t'i përforcuar ato.
<p>Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsim, Kulturë, Sporte</p> <p>Sektori Cështjeve Sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse për të identifikuar ndikimet sociale, ekonomike dhe psikologjike tek individët dhe familjet. ➤ I jep përparësi asistencës për grupet e cenueshme, duke përfshirë fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta. ➤ Koordinon shpërndarjen e ushqimit, veshjeve dhe strehimit për personat e zhvendosur ose të prekur nga fatkeqësia. ➤ Siguron akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë mbështetjen e shëndetit mendor, për të trajtuar traumat dhe kushtet e lidhura me stresin. ➤ Ofron këshillim dhe mbështetje për të ndihmuar individët të përballojnë humbjen dhe të lehtësojnë kthimin e tyre në normalitet. ➤ Partneritet me organizatat joqeveritare, grupet e

	<p>komunitetit dhe aktorë të tjerë për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdor kanale të shumta komunikimi për të arritur popullata të ndryshme. ➤ Merr pjesë në zhvillimin e planeve afatgjata të rimëkëmbjes që përfshijnë përcaktuesit socialë të shëndetit dhe mirëqenies. ➤ Mbledhja e të dhënave për të informuar strategjitë e ardhshme të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive. ➤ Trajnimi i personelit të shërbimit social në reagimin ndaj fatkeqësive dhe praktikat më të mira të rimëkëmbjes për të rritur gatishmërinë për ngjarjet e ardhshme.
<p>Drejtoria e Integritimit European dhe Informimit Publik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikon dhe siguron financime nga programet e Bashkimit Evropian (BE), donatorët ndërkombëtarë dhe agjencitë e huaja të ndihmës për të mbështetur iniciativat e rimëkëmbjes. ➤ Përgatit dhe paraqet propozime gjithëpërfshirëse për të pasur akses në grantet dhe ndihmën financiare në dispozicion. ➤ Shërben si ndërlidhës parësor ndërmjet bashkisë dhe donatorëve ndërkombëtarë, duke siguruar komunikim dhe bashkëpunim efektiv. ➤ Koordinon shpërndarjen dhe përdorimin e ndihmës së huaj për të harmonizuar me prioritetet dhe nevojat e rimëkëmbjes lokale. ➤ Siguron që projektet e rimëkëmbjes të jenë në përputhje me rregulloret, standardet dhe praktikat më të mira të BE-së, veçanërisht ato që lidhen me menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe aftësinë ripërtëritëse.. ➤ Lehtësimi i aksesit në ekspertizën teknike dhe programet e trajnimit të ofruara nga institucionet e BE-së dhe organizatat ndërkombëtare për të forcuar kapacitetet lokale të rimëkëmbjes. ➤ Ndjek progresin e projekteve të rimëkëmbjes të financuara nga burime të jashtme, duke siguruar që afatet dhe objektivat e dakordësuar të jenë përmbushur. <p>Përgatit raporte të detajuara për donatorët dhe organet e BE-së, duke demonstruar transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve.</p>
<p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Taksave</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirës të ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga fatkeqësia, duke përfshirë

dhe Mjedisit	<p>ndikimet në tokë, ujë, cilësinë e ajrit dhe biodiversitetin.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi dhe prioritizimi i zonave që kërkojnë rehabilitim të menjëhershëm mjedisor. ➤ Monitorimi i rreziqeve dytësore mjedisore, si rrëshqitjet e dheut, përmytjet ose ndotja nga materialet e rrezikshme, dhe zbatimi i masave parandaluese për të shmangur dëme të mëtejshme. ➤ Promovon përfshirjen e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në përpjekjet për rimëkëmbje, të tilla si ndërtimi i barrierave natyrore ose rehabilitimi i ekosistemeve që ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve të ardhshme mjedisore. ➤ Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese për të informuar komunitetet për rreziqet mjedisore dhe rëndësinë e praktikave të qëndrueshme të rimëkëmbjes. ➤ Mbështetja e projekteve që forcojnë aftësinë ripërtëritëse ekologjike dhe përmirësojnë infrastrukturën natyrore për të përballuar fatkeqësitë e ardhshme.
Burimet Njerëzore Sektori Juridik	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi, ndryshimi dhe mbikëqyrja e legjislacionit që mbështet përpjekjet e rimëkëmbjes. ➤ Koordinimi me strukturat e tjera për të siguruar rikuperim efektiv nga fatkeqësitë. ➤ Lehtësimi i komunikimit dhe transparencës me publikun dhe komunitetet e prekura. ➤ Avokimi për nevojat e komunitetit dhe siguri që popullatat e cënueshme të mbështeten. ➤ Monitorimi i procesit të rimëkëmbjes për të siguruar efikasitet dhe për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve.
Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitoron dhe zbaton ligjet për të siguruar që rindërtimi është në përputhje me planet e miratuara të përdorimit të territorit. ➤ Parandalon ndërtimet ose aktivitetet e paautorizuara në zona me risk të lartë ose të ndjeshme ndaj mjedisit. ➤ Kryerja e inspektimeve të projekteve të rindërtimit për të siguruar përputhjen me standardet e sigurisë, kodet e ndërtimit dhe rregulloret mjedisore. ➤ Parandalon hedhjen e paligjshme të mbetjeve ose mbeturinave në zonat e ndaluara gjatë operacioneve të rikuperimit. ➤ Mbron zonat e mbrojtura, si ligatinat, pyjet dhe brigjet e lumenjve, nga aktivitetet që mund të përkeqësojnë rreziqet mjedisore ose dëmtimet.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Informon komunitetet dhe palët e interesuara për rregulloret e rindërtimit dhe përdorimit të tokës. ➤ Jep udhëzime për marrjen e lejeve dhe përputhjen me politikat që lidhen me rikuperimin. ➤ Mbështet përditësimet e rregulloreve që forcojnë mbrojtjen territoriale dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive.
<p>Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e inspektimeve strukturore të sigurisë nga zjarri të ndërtesave të dëmtuara dhe infrastrukturës kritike. ➤ Vlerëson rreziqet si rrjedhjet e gazit, keqfunksionimet elektrike ose strukturat e paqëndrueshme për të parandaluar incidente dytësore. ➤ Identifikon dhe neutralizon rreziqet e mundshme të zjarrit në zonat e rikuperimit, duke përfshirë mbeturinat e ndezshme dhe shërbimet e rrezikuara. ➤ Siguron mbështetje të specializuar për detyrat e rikuperimit me rrezik të lartë, të tilla si derdhjet kimike në hapësirë të kufizuar. ➤ Jep udhëzime teknike ekipeve të ndërtimit për materialet e ndërtimit rezistente ndaj zjarrit. ➤ Kryen programe në terren për të edukuar publikun mbi sigurinë nga zjarri gjatë rimëkëmbjes. ➤ Shpërndan informacion mbi rrugët e evakuimit emergjent dhe masat për parandalimin e zjarrit në strehimoret e përkohshme. ➤ Patrullon zonat e rikuperimit për të monitoruar për rreziqet e shfaqura nga zjarri ose praktikatat e pasigurta. ➤ Krijon stacione të përkohshme zjarrfikëse ose njësi reagimi në zonat e prekura. ➤ Ndhmon në evakuimin dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme gjatë aktiviteteve të rimëkëmbjes me rrezik të lartë. ➤ Adreson rreziqet mjedisore të lidhura me zjarret, të tilla si tymrat toksikë ose derdhjet nga përpjekjet për shuarjen e zjarrit. ➤ Vlerëson mësimet e nxjerra nga fatkeqësia për të përmirësuar standardet e sigurisë nga zjarri dhe protokollat e reagimit ndaj emergjencave.
<p>Sektori Shërbimit Pyjor</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerëson dëmet në zonat pyjore të shkaktuara nga fatkeqësia, duke përfshirë pemët e rrëzuara, shpyllëzimin ose shkatërrimin e habitatit. ➤ Rehabilitimi i pyjeve të prekura përmes programeve të ripyllëzimit dhe restaurimit të biodiversitetit. ➤ Bashkëpunon ngushtë me departamentet e tjera

	<p>bashkiake, shërbimet e emergjencës dhe organizatat e komunitetit për të koordinuar aktivitetet e rimëkëmbjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunon me agjencitë mjedisore për të integruar praktikat e qëndrueshme në restaurimin, ujitjen dhe kullimin e pyjeve. ➤ Garanton që përpjekjet për restaurimin e pyjeve dhe ujitjes janë në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.
<p>Policia Bashkike</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Patrullon dhe siguron zonat në rindërtim për të parandaluar vjedhjen, vandalizmin ose aktivitetet e paautorizuara. ➤ Koordinon me autoritetet vendore për mbylljen ose devijimin e përkohshëm të rrugëve. ➤ Ofron mbështetje logjistike për ekipet e rimëkëmbjes, duke përfshirë shoqërimin e autokolonave të ndihmës dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. ➤ Mbështet shpërndarjen e ndihmave për popullatën e prekur. ➤ Monitoron dhe mbron grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, gjatë aktiviteteve të rimëkëmbjes. ➤ Bashkëpunon me shërbimet sociale për të parandaluar shfrytëzimin ose abuzimin në zonat e prekura. ➤ Ofron informacion të përditësuar për publikun në lidhje me masat e sigurisë, mbylljen e rrugëve dhe përparimin e rimëkëmbjes. ➤ Trajton shqetësimet dhe ankesat e publikut në lidhje me sigurinë. ➤ Ndërmjetëson mosmarrëveshjet që mund të lindin midis banorëve, kontraktorëve ose palëve të tjera të interesuara gjatë përpjekjeve për rimëkëmbje. ➤ Raporton çdo incident, shkelje ose rrezik të vërejtur gjatë operacioneve të rimëkëmbjes në departamentet përkatëse. ➤ Bashkëpunon me shërbimet e emergjencës, mbrojtjen civile dhe departamente të tjera për të siguruar një qasje të unifikuar ndaj rimëkëmbjes.
<p>Njësitë Administrative</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i asistencës për procesin e vlerësimit të plotë të dëmeve të shkaktuara nga emergjenca për të identifikuar nevojat për riparim dhe rindërtim, për bashkinë ose agjencitë e tjera shtetërore. ➤ Ofrimi i asistencës në hartimin e planeve për rindërtimin e infrastrukturës dhe objekteve, si dhe për rimëkëmbjen e shërbimeve të komunitetit, duke u

	<p>fokusuar në qëndrueshmërinë dhe sigurinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Organizimi i burimeve financiare për të ndihmuar individët dhe familjet e prekura, si dhe për të mbështetur riparimet dhe rindërtimin. ➤ Ofrimi i shërbimeve për mbështetje psikologjike dhe emocionale për ata që kanë përjetuar trauma gjatë emergjencës. ➤ Shërbimi për rikthimin e shërbimeve të rëndësishme si arsimi, shëndetësia dhe transporti, për të siguruar që komuniteti të kthehet në normalitet. ➤ Komunikimi i vazhdueshëm me qytetarët për progresin e rimëkëmbjes dhe për mundësitë e ndihmës që ofrohen. ➤ Analizimi i dështimeve dhe sukseseve gjatë menaxhimit të emergjencës për të përmirësuar planet e gatishmërisë dhe reagimit në të ardhmen, në bashkëpunim me bashkinë, qarkun dhe AKMC-në.
Institucione dhe struktura në nivel qarku	
<p>Prefektura e Gjirokastrës</p> <p>Spektori i Planifikimit, Perballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave</p>	<p>Koordinimi dhe mbikëqyrja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi i të gjitha përpjekjeve për rimëkëmbjen në nivel qarku, duke bashkërenduar institucionet shtetërore, sektorin privat dhe organizatat ndërkombëtare. ➤ Monitorimi dhe raportimi mbi progresin e rimëkëmbjes tek AKMC, MM dhe MB. <p>Menaxhimi i burimeve dhe infrastrukturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve emergjente për rikuperimin e infrastrukturës kritike (rrugë, ura, shërbime komunale). <p>Sigurimi i Shërbimeve Bazë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetja e bashkive për garantimin e furnizimit me ujë, energji elektrike dhe pastrimin e mbetjeve. ➤ Koordinimi i ndihmës për strehimin e përkohshëm dhe të përhershëm të popullsisë së prekur. <p>Përmirësimi i kapaciteteve dhe planifikimi afatgjatë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetja e bashkive në hartimin e planeve afatgjata për rimëkëmbje dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. ➤ Koordinimi me donatorët për financimin e projekteve të rimëkëmbjes. <p>Siguria dhe Informimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunon me shërbimet e zbatimit të ligjit dhe shërbimet e emergjencës për të ruajtur rendin dhe sigurinë në zonat e prekura. ➤ Mbështet forcimin e kapaciteteve të organeve vendore

	<p>dhe komuniteteve për të menaxhuar rimëkëmbjen dhe përgatitjen për emergjencat e ardhshme.</p>
<p>Operatorii Sistemit të Transmetimit OST qark/bashki në</p>	<p>Vlerësimi i infrastrukturës</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të infrastrukturës energjetike, duke përfshirë nënstationet dhe linjat e transmetimit, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore. <p>Prioritet për objektet kritike</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Identifikimi dhe restaurimi i menjëhershëm i energjisë në objektet kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe furnizimet me ujë. <p>Rikthimi gradual i energjisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Koordinimi për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike, duke përdorur zgjidhje të përkohshme si gjeneratorët në zonat ku riparimet kërkojnë kohë. <p>Siguria e komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Informimi i popullsisë për përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e mundshme gjatë fazës së rimëkëmbjes. <p>Modernizimi i rrjetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Integrimi i masave për rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara si kabllot nëntokësore. <p>Monitorimi dhe masa parandaluese</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vëzhgimi i vazhdueshëm i rrjetit për të parandaluar ndërprerjet dytësore dhe rreziqet si zjarret apo mbingarkesat elektrike. <p>Mbështetja për investime afatgjata</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Promovimi i investimeve në sistemet e ruajtjes së energjisë dhe burimet alternative për të forcuar qëndrueshmërinë e rrjetit pas fatkeqësive.
<p>Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE-së</p>	<p>Vlerësimi i dëmeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e një vlerësimi të hollësishëm të dëmeve në rrjetin e shpërndarjes, kabinat elektrike dhe transformatorët për të përcaktuar nevojat për riparim dhe restaurim. <p>Restaurimi i furnizimit me energji</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rikthimi gradual i energjisë për konsumatorët, duke i dhënë përparësi objekteve kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe infrastrukturës publike. <p>Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendosja e zgjidhjeve të përkohshme si gjeneratorët për zonat ku rikuperimi i plotë kërkon më shumë kohë.

	<p>Siguria e rrjetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i rrjetit të shpërndarjes për të parandaluar mbingarkesat dhe rreziqet elektrike gjatë fazës së rimëkëmbjes. <p>Informimi i komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Komunikimi i qartë me qytetarët për ndërprerjet e planifikuara, përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e furnizimit. <p>Riparimi dhe modernizimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Restaurimi dhe përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes duke integruar masa për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive në të ardhmen. <p>Koordinimi me institucionet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe qendrore për të siguruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për rimëkëmbjen e rrjetit të shpërndarjes.
<p>Drejtoria Rajonale e Kulturës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të dëmeve të vendeve të trashëgimisë kulturore, muzeve, bibliotekave, arkivave dhe pasurive të tjera kulturore. ➤ Identifikon dhe dokumenton humbjet ndaj objekteve kulturore dhe trashëgimisë jo-materiale, të tilla si traditat ose praktikatat e prekura nga fatkeqësia , duke siguruar një bazë për prioritetet e rimëkëmbjes. ➤ Zbatimi i masave për stabilizimin dhe mbrojtjen e vendeve dhe objekteve kulturore të dëmtuara nga përkeqësimi ose humbja e mëtejshme. ➤ Bashkëpunon me ekspertë të restaurimit dhe ruajtjes për të siguruar dhe rivendosur asetet kulturore, si vepra arti, dorëshkrime dhe artefakte, duke respektuar standardet ndërkombëtare të ruajtjes. ➤ Bashkëpunon me qeveritë lokale, organizatat ndërkombëtare (p.sh. UNESCO) dhe institucionet kulturore, për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për restaurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. ➤ Lehtësimi i rifillimit të aktiviteteve kulturore, të tilla si festivale, ekspozita dhe shfaqje, për të kontribuar në rigjallërimin e angazhimit të komunitetit dhe rivendosjen e identitetit kulturor. ➤ Rrit ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore gjatë dhe pas përpjekjeve për rimëkëmbje, duke përfshirë fushata edukative dhe promovuese. ➤ Përfshin komunitetet lokale në përpjekjet për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke inkurajuar pjesëmarrjen

	<p>dhe promovuar një ndjenjë të përgjegjësisë dhe krenarisë ndaj pasurive kulturore.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbaton projekte për dixhitalizimin dhe arkivimin e pasurive kulturore, duke krijuar një kopje rezervë për mbrojtjen e tyre në rast fatkeqësish të ardhshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit.
<p>Agjencia Rajonale e Mjedisit</p>	<p>Vlerësimi dhe Monitorimi i Dëmeve Mjedisore</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirës të ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga fatkeqësia, duke përfshirë ndikimet në tokë, ujë, cilësinë e ajrit dhe biodiversitetin, në bashkëpunim me institucione përkatëse dhe ekspertë të fushës. ➤ Identifikimi dhe prioritizimi i zonave që kërkojnë rehabilitim të menjëhershëm mjedisor, duke i adresuar ato në koordinim me autoritetet lokale dhe qendrore. ➤ Monitorimi i rreziqeve dytësore mjedisore, si rrëshqitjet e dheut, përmytjet ose ndotja nga materialet e rrezikshme, dhe zbatimi i masave parandaluese për të shmangur dëme të mëtejshme. <p>Rehabilitimi i Mjedisit dhe Ekosistemeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Zbatimi i programeve për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara, të tilla si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe restaurimi i habitateve të specieve të egra, në përputhje me standardet e ruajtjes së mjedisit. ➤ Trajtimi i efekteve të fatkeqësisë mbi mjedisin, si erozioni i tokës, ndotja e ujit dhe ajrit, për të rivendosur ekuilibrin ekologjik. ➤ Bashkëpunimi me agjenci të tjera për të siguruar asgjësim të sigurt të mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme nga fatkeqësia në përputhje me rregulloret mjedisore. ➤ Promovon përfshirjen e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në përpjekjet për rimëkëmbje, të tilla si ndërtimi i barrierave natyrore ose rehabilitimi i ekosistemeve që ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve të ardhshme mjedisore. <p>Ndërgjegjësimi dhe Angazhimi i Komunitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e fushatave ndërgjegjësuere për të informuar komunitetet për rreziqet mjedisore dhe rëndësinë e praktikave të qëndrueshme të rimëkëmbjes . ➤ Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në projektet e rehabilitimit mjedisor, të tilla si mbjellja e pemëve ose pastrimi i zonave, për të forcuar angazhimin dhe ndërgjegjësimin publik. ➤ Mbështetja e politikave që promovojnë standarde të

	<p>qëndrueshmërisë në përpjekjet për rimëkëmbje dhe zhvillim afatgjatë.</p> <p>Sigurimi i burimeve për rimëkëmbjen</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbështetja e projekteve që forcojnë aftësinë ripërtëritëse ekologjike dhe përmirësojnë infrastrukturën natyrore për të përballuar fatkeqësitë e ardhshme. ➤ Siguron fonde nga qeveritë kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët për iniciativat për rimëkëmbjen e mjedisit.
<p>Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit</p>	<p>Vlerësimi dhe Prioritizimi i Ndërhyrjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve në kanale, rezervuarë, stacione të pompimit dhe rrjetet e kullimit për të përcaktuar masat e nevojshme të rikuperimit. ➤ Identifikimi i zonave ku dëmtimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ka ndikuar në bujqësi, furnizim me ujë ose sigurinë publike. ➤ Prioritizimi i riparimeve dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar rifillimin e aktiviteteve bujqësore dhe përdorimeve të tjera jetike. <p>Rikuperimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rivendosja e funksionalitetit të rezervuarëve, digave dhe kanaleve të ujit për të siguruar shpërndarjen e ujit në mënyrë të qëndrueshme për bujqësi dhe përdorime të tjera komunitare. ➤ Zbatimi i zgjidhjeve të tjera të përkohshme, si sistemet portative të pompimit për të siguruar funksionalitetin deri në zgjidhjen përfundimtare. ➤ Pastrimi i kanaleve të kullimit nga bllokimet për të shmangur përmytjet dhe për të zvogëluar riskun e përmytjeve në zonat e prekura. ➤ Riparimi dhe përforcimi i sistemeve të kullimit për të garantuar rrjedhje efikase të ujit dhe për të mbrojtur infrastrukturën dhe komunitetet përreth. <p>Monitorimi dhe zbatimi i masave për parandalimin e rreziqeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i sistemeve të kullimit për të parandaluar rreziqet dytësore, të tilla si rrëshqitjet e dheut ose përmytjet e mëtejshme. ➤ Zbatimi i masave të kontrollit të erozionit përgjatë rrjedhave ujore dhe në zonat me risk të lartë, për të zvogëluar ndikimin në tokat bujqësore dhe mjedis. ➤ Promovimi i metodave të qëndrueshme të përdorimit të ujit dhe teknikave efikase të ujitjes për të optimizuar

	<p>përdorimin e burimeve gjatë fazës së rimëkëmbjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i sistemeve të restauruara të ujitjes dhe kullimit për të garantuar që ato funksionojnë me efikasitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë. <p>Mësime të nxjerra dhe planifikimi për të ardhmen</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i ndikimit të përpjekjeve për rimëkëmbje dhe dokumentimi i mësimeve të nxjerra për të përmirësuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive në të ardhmen. ➤ Mbështetja e projekteve të qëndrueshmërisë mjedisore, që ndihmojnë në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrisin aftësinë e qarkut për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë efektive.
<p>Shoqëria e Kanalizimeve Sh.a</p> <p>Ujësjiellës</p>	<p>Vlerësimi dhe prioritizimi i ndërhyrjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve të rrjeteve të furnizimit me ujë, impianteve të trajtimit, stacioneve të pompimit dhe sistemeve kanalizimeve. ➤ Identifikimi i zonave më kritike për ndërhyrje dhe vendosja e prioriteteve për rikuperimin e shpejtë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve. ➤ Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme, të tilla si rezervuarët e ujit ose njësitë e lëvizshme të trajtimit, për t'u shërbyer komuniteteve të prekura. <p>Rikuperimi i infrastrukturës së ujit dhe kanalizimeve</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Riparimi i rrjedhjeve dhe plasaritjeve në tubacione për të minimizuar humbjet e ujit dhe për të parandaluar rreziqet e ndotjes. ➤ Pastrimi dhe rehabilitimi i sistemeve të kanalizimeve dhe ujërave të zeza për të parandaluar ndotjen dhe rreziqet shëndetësore. ➤ Monitorimi dhe garantimi i funksionimit të impianteve të trajtimit të ujit dhe kanalizimeve për të shmangur ndotjen mjedisore. ➤ Zbatimi i masave për reduktimin e ndikimit të fatkeqësive të ardhshme, si përforcimi i tubacioneve dhe rritja e rezistencës së impianteve të trajtimit të ujit ndaj përmbytjeve. <p>Sigurimi i higjienës dhe informimi i publikut</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e testeve të rregullta të cilësisë së ujit për të siguruar që furnizimet e restauruara të ujit janë të sigurta për konsum. ➤ Ofrimi i përditësimeve të vazhdueshme për publikun, mbi ecurinë e rimëkëmbjes dhe afatet kohore për restaurimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. ➤ Edukimi i komuniteteve të prekura për rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe praktikave të sigurta të higjienës

	<p>gjatë rimëkëmbjes.</p>
<p>Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) / Drejtoritë e Shkollave</p>	<p>Vlerësimi dhe rindërtimi i infrastrukturës arsimore</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve të ndërtesave, objekteve dhe burimeve shkollore, duke identifikuar zonat që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. ➤ Dhënia përparësi riparimit dhe rindërtimit të ndërtesave dhe objekteve shkollore të dëmtuara për të siguruar rifillimin sa më të shpejtë të procesit mësimor.. ➤ Zëvendësimi ose riparimi i materialeve arsimore të humbura ose të dëmtuara, si tekstet shkollore, mobiljet dhe pajisjet teknologjike, për të mbështetur mësimdhënien. <p>Sigurimi i vazhdimësisë së arsimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi dhe zbatimi i një plani të përkohshëm për rifillimin e procesit mësimor, duke i dhënë përparësi shkollave dhe komuniteteve më të prekura. ➤ Rregullimi i kalendarit akademik, për të kompensuar kohën e humbur të mësimin dhe për të garantuar përmbushjen e objektivave arsimore. ➤ Krijimi i hapësirave të përkohshme për zhvillimin e mësimin në rast se infrastruktura shkollore nuk është funksionale. <p>Mbështetja psikosociale dhe bashkëpunimi</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes për shëndetin mendor për nxënësit, mësuesit dhe stafin e prekur nga fatkeqësia , përmes këshillimit dhe aktiviteteve psikosociale. ➤ Bashkëpunimi me prindërit, autoritetet lokale dhe komunitetin për të lehtësuar rikthimin në shkollë dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës. ➤ Koordinimi me OJQ dhe donatorë për të siguruar fonde, furnizime dhe mbështetje teknike për rindërtimin dhe restaurimin e infrastrukturës arsimore. <p>Monitorimi dhe përmirësimi i gatishmërisë për të ardhmen</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi i procesit të rimëkëmbjes për të siguruar që ndërtesat dhe objektet arsimore janë funksionale, të sigurta dhe të përshtatshme për nxënësit dhe mësuesit. ➤ Dokumentimi i mësimave të nxjerra nga përpjekjet për rimëkëmbje dhe përdorimi i tyre për të përmirësuar gatishmërinë dhe planifikimin për emergjencat e ardhshme.
<p>Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone</p>	<p>Vlerësimi dhe rivendosja e infrastrukturës</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e një vlerësimi të dëmtimeve në infrastrukturën

<p>& One)</p>	<p>e telekomunikacionit, duke përfshirë kullat celulare, linjat e transmetimit dhe pajisjet e rrjetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Prioritizimi dhe zbatimi i riparimeve për të rivendosur kanalet kritike të komunikimit në përputhje me kërkesat e autoriteteve civile dhe planifikimin e përgjithshëm të rimëkëmbjes. ➤ Vendosja e njësive të përkohshme të komunikimit celular për të siguruar lidhje të menjëhershme në zonat e prekura. <p>Mbështetja e komunikimit për publikun dhe institucionet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i informacionit të rregullt për publikun mbi statusin e , ndërprerjet e shërbimit dhe përparimin e restaurimit. ➤ Sigurimi i linjave të dedikuara të komunikimit për qendrat e operacioneve emergjente dhe ekipet në terren, për të mbështetur përpjekjet e koordinuara të përgjigjes dhe rimëkëmbjes. ➤ Ofrimi i shërbimeve të veçanta për klientët, si ofrimi i telefonatave falas ose internet të limituar pa pagesë, për të ndihmuar popullatën e prekur të komunikojë gjatë periudhës së rimëkëmbjes. ➤ Vendosja e stacioneve të karikimit dhe pikave të Ëi-Fi në qendrat e strehimit dhe ato komunitare për të mbështetur individët e zhvendosur dhe komunitetet e prekura.. <p>Rritja e aftësisë ripërtëritëse të rrjetit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Investimi në teknologji dhe sisteme që përmirësojnë aftësinë ripërtëritëse të rrjetit për të përballuar risqet e fatkeqësive të ardhshme. ➤ Monitorimi i performancës së rrjetit gjatë dhe pas rimëkëmbjes për të identifikuar cenueshmëritë dhe për të përmirësuar aftësinë ripërtëritëse ndaj ndërprerjeve të ardhshme.
<p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet, Shërbimi i Urgjencës Mjekësore / Spitalet (Përmet, Gjirokastrë)</p>	<p>Sigurimi i kujdesit shëndetësor pas fatkeqësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i trajtimeve për dëmtime të lidhura me fatkeqësitë, të tilla si djegiet, lëndimet, infeksionet dhe traumat e tjera. ➤ Prioritizimi i kujdesit për grupet më të cenueshme, si fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me aftësi të kufizuara. ➤ Zbatimi i fushatave të vaksinimit për të parandaluar shpërthimet e sëmundjeve të tilla si kolera, fruthi ose gripi në zonat e prekura. ➤ Bashkëpunimi me autoritetet e shëndetit publik për të monitoruar dhe adresuar rreziqet epidemiologjike që

	<p>mund të shfaqen pas fatkeqësisë.</p> <p>Riorganizimi i infrastrukturës dhe shërbimeve mjekësore</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi i dëmeve në objektet shëndetësore dhe implementimi i riparimeve për të siguruar funksionalitetin e plotë. ➤ Krijimi i objekteve të përkohshme mjekësore ose njësive të lëvizshme në zonat ku strukturat e përhershme nuk janë ende funksionale. ➤ Sigurimi i një furnizimi adekuat të pajisjeve mjekësore dhe medikamenteve për të përmbushur kërkesat e rritura të kujdesit shëndetësor gjatë rimëkëmbjes. <p>Mbështetja psikosociale dhe informimi i publikut</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Adreson nevojat psikologjike dhe emocionale përmes këshillimit dhe shërbimeve të shëndetit mendor për pacientët, për punonjësit e kujdesit shëndetësor, për forcat operationale dhe stafin tjetër të përfshirë në fazën e rimëkëmbjes. ➤ Informon publikun për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor, masat e vaksinimit dhe masat për parandalimin e sëmundjeve.
<p>Përfaqësues të Forcave të Armatosura</p> <p>B2k Grehot Gjirokastrë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndhmon në restaurimin e infrastrukturës kritike, si rrugët, urat dhe ndërtesat publike në bashkëpunim të ngushtë me strukturat përkatëse për të siguruar një qasje të koordinuar dhe efektive në fazën e rimëkëmbjes. ➤ Siguron pajisje të rënda dhe personel të kualifikuar për heqjen e mbeturinave, pastrimin e rrugëve të transportit dhe ndërtimin e strehimoreve të përkohshme, vetëm në rastet kur autoritetet civile nuk disponojnë kapacitete të mjaftueshme dhe pas një kërkesë zyrtare nga autoritetet përkatëse. ➤ Siguron mbështetje logjistike dhe koordinim me autoritetet civile për të ruajtur integritetin e infrastrukturës kritike dhe pikave të shpërndarjes së ndihmës, duke respektuar rolin kryesor të policisë dhe agjencive civile në ruajtjen e rendit dhe sigurisë. ➤ Bashkëpunon me policinë lokale dhe agjencinë e mbrojtjes civile për të mbështetur ruajtjen e sigurisë në zonat e prekura nga fatkeqësitë, vetëm kur kërkohet nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me ligjin. ➤ Vendos personel mjekësor dhe spitale në terren për të ofruar kujdes të menjëhershëm për popullsinë e prekur nëse sistemet lokale të kujdesit shëndetësor janë të mbingarkuar. ➤ Ndhmon në evakuimin dhe transportimin e individëve të lënduar në objektet mjekësore në raste urgjente dhe

	<p>gjithmonë në bashkëpunim me autoritetet civile kompetente.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vazhdon të mbështesë misionet e kërkimit dhe shpëtimit siç kërkohet gjatë fazës së rimëkëmbjes, veçanërisht në zonat e vështira për t'u arritur ose të rrezikshme. ➤ Siguron pajisje dhe personel të trajnuar për të ndihmuar në operacionet e rimëkëmbjes. ➤ Ofron ekspertizë inxhinierike për vlerësimin e dëmeve dhe mbështet hartimin dhe zbatimin e projekteve të rimëkëmbjes, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet civile dhe sipas kërkesës së tyre. ➤ Përdor automjete ushtarake, për të transportuar furnizime, pajisje dhe personel drejt dhe nga zonat e prekura. ➤ Ndihmon gjatë fatkeqësive natyrore (p.sh., përmbytjet, tërmetet) me operacionet e shpëtimit, evakuimet dhe ofrimin e ndihmës humanitare.
<p>Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë/ Komisariati Policisë Përmet</p>	<p>Siguria publike dhe ruajtja e rendit</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sigurimi i rendit në zonat e prekura dhe parandalimi i krimeve si vjedhja, vandalizmi dhe aktivitete të tjera kriminale. ➤ Monitorimi dhe mbrojtja e ndërtesave dhe objekteve publike të dëmtuara për të parandaluar aksesin e paautorizuar dhe dëmtimet e mëtejshme. ➤ Parandalimi i tensioneve sociale dhe konflikteve të lidhura me ndarjen e burimeve apo pronësinë. ➤ Hetimi dhe parandalimi i incidenteve e mashtrimve ose korrupsionit që lidhen me rimëkëmbjen, duke siguruar llogaridhënie, drejtësi dhe transparencë. <p>Menaxhimi i lëvizjes dhe mbështetja logjistike</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rregullimi i trafikut për të lehtësuar lëvizjen e automjeteve, pajisjeve dhe personelit duke prioritetizuar automjetet dhe pajisjet që marrin pjesë në përpjekjet për rimëkëmbje. ➤ Ofrimi i sigurisë dhe mbështetjes logjistike për qendrat e shpërndarjes së ndihmës dhe strehimoret e komunitetit. ➤ Mbështetja e ekipeve të emergjencës dhe koordinimi me autoritetet lokale për të optimizuar operacionet e rimëkëmbjes. <p>Mbrojtja e grupeve të cenueshme</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i sigurisë për grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi dhe ndërhyrja për të parandaluar incidentet e shfrytëzimit, trafikimit të qenieve njerëzore ose abuzimeve të tjera në zonat e prekura nga fatkeqësitë. <p>Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Shpërndarja e informacionit për publikun në lidhje me masat e sigurisë, afatet kohore të rikuperimit dhe burimet e disponueshme për komunitetin. ➤ Inkurajimi i qytetarëve të raportojnë aktivitete të dyshimta duke përfshirë shqetësime sigurie ose aktivitetet kriminale në zonat e prekura. <p>Mbështetja për personelin e policisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i mbështetjes operacionale dhe emocionale për oficerët e policisë dhe stafin e prekur nga fatkeqësia. ➤ Koordinimi me profesionistët e shëndetit mendor për të ofruar këshillim për stafin e prekur ndaj stresit dhe traumës pas fatkeqësisë.
<p>Kryqi i Kuq Shqiptar Dega Gjirokastrë</p>	<p>Sigurimi i nevojave themelore për popullsinë e prekur</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i artikujve thelbësorë, si ushqimi, ujë i pastër, veshjet dhe kompletet e higjienës, për komunitetet e prekur. ➤ Mbështetja e përpjekjeve për strehim të përkohshëm për individët dhe familjet e zhvendosura nga fatkeqësitë. ➤ Lehtësimi i aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe barnat për komunitetet e prekura në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore vendore. <p>Mbështetja psikosociale dhe shëndeti mendor</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i ndihmës së parë psikologjike dhe mbështetjes afatgjatë të shëndetit mendor për individët e prekur nga fatkeqësia si dhe për forcat operacionale dhe stafin e përfshirë në rimëkëmbje. ➤ Organizimi i seancave të këshillimit dhe programeve mbështetëse emocionale për individët që përballen me trauma pas fatkeqësisë. ➤ Promovimi i higjienës dhe parandalimi i sëmundjeveve përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe shpërndarjes së materialeve sanitare. <p>Rimëkëmbja e komunitetit dhe zhvillimi i aftësive</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ofrimi i mbështetje për familjet më të prekura për një periudhë deri në një vit, duke përfshirë ndihmën materiale, asistencën psikosociale dhe promovimin e shëndetit dhe higjienës. ➤ Angazhimi dhe trajnimi i vullnetarëve për të ndihmuar në aktivitetet e rimëkëmbjes, si shpërndarja e ndihmave dhe mbështetja e komunitetit.

	<ul style="list-style-type: none">➤ Trajnimi i komuniteteve për aftësi të veçanta rimëkëmjeje, si ndihma e parë dhe mbështetja psikosociale. <p>Menaxhimi i burimeve dhe monitorimi i rimëkëmbjes</p> <ul style="list-style-type: none">➤ Mobilizimi i fondeve dhe burimeve nga donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur përpjekjet e rimëkëmbjes.➤ Monitorimi i ndikimit të aktiviteteve të rimëkëmbjes për t'u siguruar që ato plotësojnë nevojat e komuniteteve të prekura.➤ Sigurimi i aksesit të barabartë në burimet dhe shërbimet e rimëkëmbjes për të gjitha grupet e prekura.
--	--

7.6 / Roli i palëve të interesuara jofitimprurëse në rimëkëmbje

Roli i palëve të interesuara joqeveritare apo joinstitucionale është shumë i rëndësishëm veçanërisht në lidhje me fazën e rimëkëmbjes.

PKEC identifikon palët e interesuara të OJQ-ve në kategoritë e mëposhtme: nstitucionet fetare

- Organizatat e bazuara në besim
- Organizatat komunitare
- Organizatat e kontrollit, mirëqenies ose shpëtimit të kafshëve
- Organizatat e biznesit
- Organizatat e mjedisit
- Organizatat kulturore
- Organizatat profesionale
- Kërkime universitare dhe akademike.

Është e rëndësishme të theksohet roli i donatorëve në raport me sektorin privat. Duke marrë parasysh përvojat e kaluara, ata ndonjëherë mund të ndihmojnë popullatën duke ofruar mallra ose ushqime. Gjatë emergjencave është shumë e zakonshme të shohësh dhurime ushqimore nga organizata joqeveritare ose kompani të mëdha të shpërndarjes së ushqimit.

QOECB në bashkinë Përmet në bashkëpunim me AKMC dhe Prefektin e Qarkut Gjirokastrë, duhet të jetë e gatshme të mirëpresë donacionet duke koordinuar aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe duke identifikuar, nga pikëpamja logjistike, vendet ku mund të merret donacioni nën përgjegjësinë e sektorit të logjistikës.

Konsiderata të ngjashme duhen bërë për ardhjen e donacioneve të apartamenteve apo dhomave të hoteleve për të akomoduar njerëzit që kanë humbur shtëpitë e tyre. Do të ishte e rëndësishme nënshkrimi i marrëveshjeve gjatë emergjencës me shoqatën e hoteleve në mënyrë që të garantohen të njëjtat kushte për të gjithë personat. Kjo mund të ndodhë edhe nëpërmjet Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, i cili mund të llogarisë edhe në kontributin e bashkive fqinje. Gjithashtu, çdo qytetar dhe familje mund të luajë një rol kyç në fazën e rimëkëmbjes. Siç thuhet nga PKEC,

planifikimi dhe përgatitja para fatkeqësisë duhet të fokusohet në "përgatitjen për rimëkëmbje" ose përgatitjen e individit për atë që do të nevojitet pas një fatkeqësie.

8. Skenarët

8.1 / Skenari i riskut nga përmbytjet

Skenari sipas ngjarjes së ndodhur nga përmbytja në Bashkinë Përmet 30.11.2017 – 02.12.2017

Konteksti

1. Vlerësimi periodik i realitetit në bashkinë Përmet

E gjithë zona në luginën e Vjosës e territorit të Bashkisë Përmet, është mjaft e ekspozuar dhe ka një risk mesatar të përmbytjes. Nga vlerësimet e kryera të përmbytjeve të mëparshme, rezulton se sistemi lumor dhe ai i përrenjëve kryesor, përbën rrezikun më të madh për përmbytjen nga vërshimet e ujërave ku riskun kryesor e kanë zona urbane e qytetit, infrastruktura rrugore, ujësjelles kanalizimet, sektori energjisë elektrike dhe risk të ulët tokat bujqësore

Periudha e vitit: 30 Nëntor deri 2 Dhjetor 2017



Pasarela Përmet



Pasarela e Kutalit



Pasarela e Mesarese



Redhi Badlonjes.(Përmbytje seg.rrugor)



Fig : Foto të përmbytjeve bashkinë Përmet (30 Nëntor deri 2 Dhjetor 2017)

2. Çfarë e shkaktoi përmbytjen?

Në periudhën 31 janar – 4 shkurt, si pasojë e reshjeve të shumta të shiut (280 mm) që përfshinë gjithë territorin e bashkisë Përmet , lumi Vjosa dhe deget kryesore të saj Carshove , Langarice , Lemnice kanë rritur nivelin e ujit në 8 m sipas vërtetimeve në hidrometer nga 7 m që është pika kritike. Po kështu në zonën urbane të qytetit kanë vershuar ujrat e perrenjeve ; perroi Bardhe , i Lipes , Dyshit e i Bodarit duke shkaktuar përmbytje, rrezikuar njerëz , demtime në pasuri , në rrugë , ujësjellës , kanalizime , rrjetin elektrik , paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve të tjera për qytetaret. Në përkeqësimin e përmbytjes ndikuan sidomos bllokimi i pusëtave dhe kanalizime në qytet

Mos kryerja e punimeve për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese

Ndërtimet e reja sidomos në lagjen Sede dhe Teqesë

Linjat e furnizimit me energji elektrike janë të vjetra dhe si të tilla janë amortizuar Si i tillë ai është shumë vulnerabël edhe ndaj stuhive, ngricave sidomos në Nj.Ad Frashër, Petran e Carcovë

3. Vendi i ngjarjes (Zona e emergjencës):

Zona e emergjencës përfshinë :

Njësia Administrative Përmet (Qytet)

Njësia Administrative Carcovë (Vllaho – Psilloterë, Zhepë)

Njësia administrative Petran (Kaludh, Leshicë)

Njësia administrative Piskovë (Kuta, Bual, Kosinë)

4. Ndikimet e përmbytjes mbi njerëzit, pasurinë, infrastrukturën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Popullsia e prekur, ajo e zhvendosur, karakteristikat e tyre.

Ndikimi mbi njerëzit dhe pasuritë e tyre

Popullsia e prekur direkt nga përmbytjet është 20 banorë dhe indirekt vlerësohet të jetë 330 banorë, e ndarë si më poshtë sipas Njësive Administrative:

Njësia Administrative Përmet (Qytet): 20 banorë direkt
Njësia Administrative Carcove (Vllaho – Psilloterë): 30 banorë indirekt
Njësia administrative Petran (Kaludh): 80 banorë indirekt
Njësia administrative Piskovë (Kuta, Bual): 200 banorë indirect
Banorët e prekur indirect janë për shkak të mos funksionimit të pasarelave të dëmtuara për kryerjen e veprimtarisë së përditshme jetësore të komunitetit

Ndikimi në infrastrukturë dhe mjedisin në tërësi ;

Nga ndjekja dhe vlerësimi i situatës rezultoi:

Dalja nga shtrati i lumut Vjosa:

- Demtim te pasarelave ; Mesare, Zhepe , Kaludh, Buhal , Kutal
- Permbytyje te 300 m segment te rruges nacionale Permet- Carshove ne vendin e quajtur Redhi Badlonjes
- 400 m segment rrugor rural Dracove - Zhepe
- Permbytyje te 150 m segmentit rugor Ura – Guri Qytetit Permet
- Permbytyje 4 objekteve te biznesit pergjat rruges Ura – G. Qytetit
- Permbytyje te nje banese ne vendin e quajtur ish karburanti ushtrise
- Permbytyje te siperfaqes se tokes bujqesore rreth 3 ha ne vendin Guri Hatos
- Stacionin e pompimit te ujit te pishem, Guri Hatos
- Stacionin e pompimit te ujit te pishem Kosine
- Erozionin ne te dy brigjet e lumit te tokave bujqesore te njesive administrative Carshove , Petran e Piskove
- Muret mbajtese (Pritese) te ndertuara per mbrojtjen nga erozioni pergjate bregut te majte te lumit ne lagjen e Re – L. Bajame – Ura – L. Mejden - pasarela e Permetit.

Vershimi ujrave te perrenjeve ne zonen urbane (Permet)

Perroi Bardhe :

- Banesat e lagjes Sede , Teqe
- Bizneset pergjate rruges Lagja Bajame - Tregu Kaleshi
- Permbytyje te tregut
- Permbytyje te segmentit rrugor Teqe – Tregu , lagja Bajame – Hotel Redi

Perroi Lipes :

- Lagjen Mejden
- Spitalin
- Rruget Spitali – Hotel Ramizi , Spitali – Guri Qytetit

Perenjte e Dyshit dhe i ish SMT :

- Permbytjen e segmentit rrugor Karburanti – Kryqezimi i rruges per ne Erseke
- Banesen tek ish karburanti i ushtrise
- Dy objekte karburanti dhe nje object biznesi restaurant
- Stacionin elektrik

Përroi i Kaludhit në njësinë administrative Petran

- ❖ Përmbytjen e 5 ha tokë bujqësore
- ❖ 10 strehimore të bagëtive dhe për bazën ushqimore

Përroi i Gjinkarit në njësinë administrative Petran

- Dëmtime të rënda të këmbzave të urës Gjinkar - Petran

Vershimi i ujrave ne zonat rurale rrezikojne :

- Bllkimin e segmenteve te rugeve rurale qe lidhin njesite administrative me fshatrat
- Erozion te tokave bujqesore
- Erozion te rugeve te fshtrave

Nderprerje të energjisë elektrike :

Prej stuhive të erës që ka shoqëruar reshjet e shiut, janë dëmtuar linjat elektrike të TM dhe TU dhe si rrjedhim ka ndërprerje energjie elektrike në fshatrat e Nj.A Frashër, Petran, Carcovë Defektet vijnë si shkak i rrëzimit të disa shtyllave të TM sikurse edhe dëmtimi i 2 transformatorëve;

Për shkak të nivelit të lartë të ujërave, rrëshqitjeve të dherave dhe inerteve të përrenjve malorë ka pasur problem qarkullimi në disa segmente të të rrugëve rurale te nj.administrative

Janë bllokuar disa segmente të rrjetit të kanalizimeve në qytetin Përmet, kryesisht në lagjet “Sede” dhe “Teqe”;

Për shkak të stuhisë në fshatin petran u shkatërua një strehimore bagëtish ku ngordhë 28 krerë të imta. Në fshatin Kosinë u dëmtuan rreth 50 koshere me bletë dhe në fshatin Petran 20 copë

5. Nevojat humanitare tek popullsia e prekur. Nevojat për përgjigje. Burimet dhe pajisjet që do të nevojiten dhe burimet dhe pajisjet që disponohen aktualisht. Trajtimi i problematikave që dolën.

Paralajmërimi i hershëm dhe informacione publike për emergjencën, këshillimi i publikut:

U desh të kryhej gjatë gjithë periudhës së emergjencës;

- **Kërkim shpëtimi:** Nevojitej në një banesë në qytetin Përmet tek ish karburanti
- **Evakuimi:** Nevojitej për 5 familje (20 persona) në qytetin e Përmet. Në nj.ad Petran nevojitej evakuim dhe për 50 kokë bagëti të imta, stallat e të cilave janë dëmtuar nga stuhia;
- **Strehimi:** Përgatitja e ambienteve të pallatit të sportit” me qëllim strehimin e 2 familjeve nga qyteti i Përmet, 2 famile në hotel ”Permeti” dhe 1 familje tek te afërmitë tyre.

• **Sigurimi i furnizimit me ndihmën ushqimore, veshmbathjen dhe artikujt e tjerë të jetesës** për 5 familjet e strehuara përkohësisht

Do të merrej në konsideratë edhe furnizimi me artikujt e emergjencës edhe i familjes të strehuar tek të afërmit e tyre;

• **Nevojat shëndetësore:** Nevojitet shtrim në spital për dy persona të lënduar. Kishin nevojë për asistencë mjekësore gjithsej 10 banorë:

Stafi i Nj.V.K.Sh dhe SRL nevojitet 24/7 në dispozicion të popullsisë sidomos asaj të evakuuar por edhe të forcave operationale në terren për çdo nevojë shëndetësore që mund të paraqitet.

Rehabilitimi i infrastrukturës si më poshtë:

- Pastrimi urgjent i rrugëve në qytetin Përmet dhe të gjithë segmenteve rrugorë të rrugëve kombëtare dhe atyre rurale me probleme nga rrëshqitjet e dherave dhe prania e inerteve në rrugë;
- Pastrimi dhe vënia në funksion të plotë e të gjithë rrjetit të kanalizimeve në qytetin e Përmet;
- Rregullimi i të gjitha avarive të linjave të TM dhe TU në zonën e nj,ad Frashër, Petran e Carcovë.

- Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosë tek Ura në hyrje të qytetit

- Vlerësimi i gjendjes së rezervuarëve Pacomit, kosinë, Qilarisht dhe Iljarë 1.

-Pastrimi dhe dezinfektimi i kateve përdhe të banesave, bizneseve dhe ndërtesave të tjera të përmytura nga balta dhe mbeturinat e tjera;

- Ofrimi i ushqimit për gjënë e gjallë tek fermerët të cilëve u janë dëmtuar rezervat nga përmytja si edhe për gjënë e gjallë që është strehuar në ambiente stallore të reja;

- Kontrolli dhe disiplinimi i trafikut në të gjitha segmentet rrugore, veçanërisht në segmentet e rrugëve të bllokuara ose atyre me thellësi të konsiderueshme të ujit

-Masat e ruajtjes dhe të sigurisë për ndërtesat e evakuara, zbatimi i ligjit, dhe masat për ruajtjen e rendit publik;

-Analiza e vazhdueshme e ujit të pijshëm dhe në rastet e evidentimit të ujërave të ndotura sigurimi i furnizimit të banorëve me ujë të pastër nëpërmjet rrjetit apo ujit të ambalazhuar dhe me autobote;

-Nevoja për mbajtjen nën kontroll të shëndetit publik, sigurimin e shërbimeve të ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut;

- Dezinfektimi dhe groposja e gjësë së gjallë dhe bimëve të ndotura nga përmytja.

Kapacitetet e nevojshme për t'u angazhuar janë:

➤ E gjithë struktura e MZSH-së së bashkisë Përmet;

➤ Kapacitete logjistike dhe njerëzore të strukturave të tjera të bashkisë që nevojiten në veçanti në operationet e ndryshme të përgjigjes ndaj emergjencës janë;

- Njësitë Administrative me gjithë stafin e tyre dhe rrjetin e vullnetarëve;

- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;

- Sektori e Emergjencave Civile, Mbrojtjes të Qytetarit e Mjedisit

- Policia bashkiake;

- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;

- Njësia e Administrimit të Pyjeve dhe Njësia e Bujqësisë, Ujit, Kullimit dhe Transportet specifike;

- Drejtoria e Shërbimit Social;

Nevojat për kapacitete reagimi shtesë përveç atyre të bashkisë janë:

- Strukturat e FA; Batalioni Mbështetës Rajonal i FA Grehot Gjirokastër
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet
- Spitali Përmet
- Komisariati i Policisë në bashkinë Përmet
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Gjirokastër
- Dega përmet e Drejtorisë së OSHEE Përmet
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar –Gjirokastër;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor dhe Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Gjirokastër;
- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Gjirokastër;
- ZVAP Përmet
- Sh.A. Ujësjellës Kanalizime, Dega Përmet
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Përmet.

6. Funkcionet operacionale për përballimin e emergjencësë përmbytjes

Paralajmërimi i hershëm i banorëve të zonave që ishin në risk nga përmbytjet dhe erërat e forta u kryen tre ditë më parë. Kjo u bë bazuar në buletin e parashikimit të motit të publikuar nga IGJEUM dhe SHMU. Popullata e mori informacionin përmes njoftimeve derë më derë që u kryen nga stafi i Nj.A por edhe përmes medias tradicionale (kombëtare dhe lokale) dhe asaj sociale. Paralajmërimi i hershëm, njoftimi dhe alarmi paraprak u pasua edhe nga dhënia e alarmit në orët e vona të mbrëmjes, kur u pa se po vërtetoheshin saktësisht parashikimi i bërë nga IGJEUM dhe SHMU.

Banorët ishin udhëzuar nga stafi i Njësive Administrative dhe bashkisë për masat e sigurisë që duhet të merrnin paraprakisht, veprimet që duhet të kryenin gjatë emergjencës dhe menjëherë pas përfundimit të saj.

Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencë

Organizimi dhe drejtimi u kryen nga KMC në bashki dhe KMC në qark. Bazuar në shkallën e emergjencës dhe përvojës, Bashkia nuk i kërkoi Prefektit të Qarkut dërgimin e kërkesës për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Stuhia dhe reshjet e mëdha të shiut prekën edhe territorin e bashkivetë tjera të Qarkut. Prefekti i Qarkut, bazuar në një analizë të shkallës së emergjencës civile në gjithë qarkun dhe kapaciteteve shtesë të nevojshme nga niveli qendror për përballimin e saj, vendosi mos dërgimin e një kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qark apo bashki.

U aktivizuan planet e emergjencave në nivel qarku dhe në nivel bashkie sikurse QOE-të në qark dhe bashki. KMC dhe QOE në bashki dhe në qark ruajtën komunikimin e tyre duke zbatuar hierarkinë institucionale.

Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve

Bashkia mobilizoi të gjitha kapacitetet administrative, teknike dhe financiare që kishte në dispozicion. Nga një analizë që KMC në bashki i bëri gjendjes së burimeve ekzistuese në bashki dhe atyre të nevojshme për përballimin e situatës emergjente të krijuar, u nxorrën kërkesat për burime shtesë të cilat iu drejtuan menjëherë Prefektit të qarkut. Pas analizës që u bë në KMC në

qark për burimet ekzistuese në rang qarku dhe nevojave, u kërkuan kapacitete shtesë nga niveli qendror siç ishin ato të FA, dhe kapacitete nga niveli lokal.

Kujdesi mjekësor / ndihma e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);

Në dispozicion të përballimit të emergjencës ishin:

- Nj.V.K.Sh, ISHP dhe Spitali Përmet.
- Ambulancat 5 gjithsej të Spitalit Përmet, dhanë ndihmën e parë për njerëzit në nevojë:
- Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KSSH, Dega Përmet.
- U dha asistenca e nevojshme shëndetësore për:
- Shtrimin në spital për dy persona të lënduar.

Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura

Grupet e vlerësimit të nevojave dhe dëmeve u ngritën nga Kryetari i Bashkisë dhe kryen urgjentisht vlerësimin me qëllim angazhimit të kapaciteteve të duhura përballuese.

Grupet e vlerësimit të nevojave u drejtuan nga Sektori i MZSH së bashkisë Përmet, ndërsa ato të vlerësimit të dëmeve nga Sektori Emergjencave Civile.

Grupet përbëheshin nga ekspertë të strukturave më poshtë:

- Sektori Emergjencave Civile;
- Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit;
- specialist të fushave të ndryshme

Sipas rastit, në vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë, bujqësi dhe biznese grupet angazhuan ekspertë nga:

- Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar –Gjirokastër;
- Drejtorisë së OSHEE Gjirokastër;
- Sh.A.Ujës-jellës Kanalizime;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit;
- Sektori i Ekstensionit Bujqësor dhe Sektori i Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Gjirokastër
- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- ZVAP

Bazuar në përcaktimet e VKM nr.329, datë 16.05.2012, komisionet e konstatimit të dëmeve dhe ato të vlerësimit të tyre, të përbërë nga ekspertë dhe punonjës së bashkisë kryen sipas afateve ligjore konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve me qëllim dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut

Zbatimi i ligjit dhe sigurisë në rastin e emergjencës së përmbytjes lidhej me:

- Disiplinimin e trafikut në rrugët e dëmtuara dhe të përmbytura dhe devijimin e tij sipas zhvillimit të situatës;
- Sigurimin e lëvizjes pa pengesa të automjeteve zjarrfikëse, FA, ambulancave dhe automjeteve të strukturave të tjera në mbështetje të operacioneve për në destinacionet e tyre. Për kryerjen e detyrave më lart ishin mobilizuar postblloqe shtesë të Policisë Rrugore;

- Sigurimin nga plaçkitësit të banesave dhe bizneseve të dëmtuara nga dëmet e shkaktuara nga përmytja dhe atyre të cilat u evakuuan për arsye sigurie. Kjo u krye nga disa patrulla shtesë të PSH që kryen shërbim 24/7 deri në kthimin e banorëve të evakuuar dhe pronarëve të bizneseve; Në zbatimin e funksioneve të mësipërme, strukturat e PSH u asistuan edhe nga struktura e Policisë Bashkiake dhe FA.

Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit

Komunikimi operacional u krye midis niveleve të ndryshme, paralele, nga lart poshtë dhe anasjelltas. Komandanti i incidentit raportonte tek Drejtuesi i Operacionit në Bashki/DOB i cili nga ana e tij raportonte tek KMC në bashki. Komandanti i incidentit raportonte edhe tek Drejtuesi i Operacionit në Qark/DOQ i cili raportonte tek KMC i Prefektit. DOB nga ana e tij raporton tek DOQ i cili nga ana e tij raporton tek AKMC. Mjetet e komunikimit të përdorura ishin të ndryshme si me telefon fiks, smartfone, radiokomunikim me mediat lokale (Radio, TV Gjyrokastra). Nuk pati ndonjë problem në komunikimin me celular pavarësisht trafikut të thirrjeve për shkak të situatës emergjente. Në kushtet kur nuk ekziston ende një komunikim me radio midis forcave të ndryshme operationale, strukturat e PSH asistuan me radiot e tyre për këtë qëllim.

Shërbimet e Ndhmës Sociale, mbështetja psikosociale

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki e udhëhoqi këtë funksion, së bashku me Nj.V.K.Sh dhe ISHSH. Psikologët e bashkisë, SRL ishin në dispozicion dhe u angazhuan në ndihmë të popullatës së evakuuar por edhe të forcave operationale dhe punonjësve të tjerë të angazhuar në përgjigjen ndaj emergjencës. Asistuan në këtë funksion edhe vullnetarët e KKSH-së dhe Psikologët e ZVAP asistuan në mënyrë të veçantë gjatë evakuimit.

Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike

Impakti i fatkeqësisë në infrastrukturën publike dhe kritike është përmendur më lart në skenar.

Informimi i publikut për situatën/edukimin shëndetësor (marrëdhëniet me publikun dhe mediat)

Institucioni i Prefektit të qarkut dhe bashkia informuan në mënyrë konstante, para, gjatë dhe pas fatkeqësisë, popullatën e zonave në risk por edhe publikun në lidhje me fatkeqësinë, masat e marra nga organet shtetërore dhe udhëzuan qytetarët për veprimet që duhet të ndiqeshin prej tyre. Ata mbajtën një komunikim shumë të ngushtë si me median kombëtare ashtu edhe me median lokale TV Gjyrokastra Media tradicionale ndihmoi qysh në fazën e paralajmërimit të hershëm të dhënë nga AKMC mbështetur në parashikimin e rreziqeve nga IGJEUM dhe SHMU, në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit dhe në alarmin përfundimtar për popullatën. Ajo sensibilizoi dhe informoi për veprimet që duhet të ndërmerre popullata (p.sh., rrugët e kalimit, rrugët e sigurta të evakuimit, strehimi etj.).

Në informimin e publikut ndihmoi edhe interneti dhe media sociale, në veçanti faqja e internetit të bashkisë Përmet

Strukturat e përfshira në informimin e publikut ishin Sektor i EC në bashki, Policia bashkiake, PSH dhe Njësitë Administrative

Logjistika (transporti, magazinimi etj.)

Bazuar në shkallën e emergjencës, nevojat për shërbime transporti u përballuan kryesisht nga kapacitetet e automjeteve të vetë bashkisë. Në raste të veçanta, kur bashkia nuk i dispononte kapacitetet e nevojshme, ishte Prefekti i qarkut që koordinonte vendosjen në dispozicion të kapaciteteve shtesë nga degët territoriale të institucioneve në qark

Magazinimi i pakove ushqimore për banorët e evakuuar por edhe të atyre në nevojë si pasojë e dëmtimit të banesave, u siguroi në një ambientet e bashkisë.

Kapacitete magazinimi të nevojshme veçanërisht për sasi të barit të thatë, kashtës dhe koncentratit për gjënë e gjallë, u vendosën në dispozicion nga një subjekt privat.

7. Institucionet, agjencitë, strukturat dhe organizatat që u përfshinë në përgjigje të emergjencës së përmbytjes. Si u përfshinë dhe çfarë angazhuan ato

Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KMC në qark

- Prefekti mbledhi urgjentisht KMC në Qark për emergjencën dhe dha detyrat përkatëse për koordinimin e veprimeve.
- Aktivizoi 24/7 KMC-në dhe QOE-në sikurse aktivizoi planin e emergjencave civile;
- Bazuar në kërkesat e bashkisë Lezhë dhe nevojave të evidentuara nga grupi i saj i vlerësimit të nevojave, KMC kreu koordinimin e të gjithë aktorëve në nivel qarku me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave me kapacitete shtesë për përgjigjen ndaj emergjencës;
- Pas konkludimit të nevojave të bashkisë për kapacitete shtesë për përballimin e emergjencës, Prefekti koordinoi punën për angazhimin e të gjitha kapaciteteve që disponoheshin nga degët territoriale dhe strukturat në qark, OJQ dhe bizneset;
- Dërgoi menjëherë tek AKMC kërkesën për t'iu drejtuar ShPFA-së për kapacitetet përkatëse shtesë nga FA , evakuim, transport, asistencë në shpërndarje ndihmash, asistencë në rehabilitimin e infrastrukturës etj.;
- Dërgoi menjëherë kërkesën për ekspertë rezervuarësh nga MBZHR;
- Përgatiti informacione periodike sipas kërkesës, për AKMC-në si dhe për publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara;
- Organizoi grupe pune për të ndjekur, kontrolluar e zbatuar detyra për monitorimin e situatës dhe marrjen e masave të ndryshme sipas problematikave të përgjigjes ndaj emergjencës;
- Nëpërmjet KMC-së mori të gjitha masat koordinuese dhe bashkërenduese për mbrojtjen e jetës së komunitetit, evakuimin, strehimin, furnizimin me artikujt e nevojshëm ushqimor, medikamente mjekësore, etj.

Bashkia Përmet

- Mbledhi urgjentisht KMC për emergjencën dhe mori në vijimësi vendimet respektive;
- Aktivizoi 24/7 KMC-në dhe QOE-në sikurse aktivizoi planin e emergjencave civile;
- Siguroi 24/7 funksionalitetin dhe vënien në veprim për reagimin ndaj emergjencës të të gjitha strukturave të saj;

- Nën koordinimin e Prefektit, siguroi pjesëmarrjen e ekspertëve të bashkisë në grupe të përbashkëta si ato të vlerësimit, verifikimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave për situatën në zonat e prekura;
- Hartoi raportin e parë për situatën dhe informacione të mëtejshme periodike, të cilat iu dërguan Prefektit;
- Përgatiti informacione sipas kërkesës për Institucionin e Prefektit.
- Vendosi në funksion të mbështetjes emergjente të gjitha kapacitetet e duhura administrative, teknike dhe financiare;
- Menaxhoi të gjithë punën për vlerësimin e nevojave dhe dëmeve nga përmbytja

Njësitë Administrative Përmet, Piskovë, Frashër, Petran, Carcovë

- U mblodh menjëherë stafi i Njësisë Administrative i cili mobilizoi të gjithë burimet njerëzore mjetet logjistike që kishte në juridiksionin e tij nën drejtimin e KMC në bashki dhe Qark në funksion të operacioneve për përballimin e situatës;
- Kreu paralajmërimin e hershëm, njoftimin dhe alarmin për banorët e zonave në risk si edhe informimin e vazhdueshëm të KMC në bashki;
- Aktivizoi ekspertë nga Nj.A në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe të specializuar të dëmeve dhe të nevojave në zonën e fatkeqësisë;
- Organizoi punën me kapacitetet e Nj.A dhe me rrjetin e vullnetarëve që ka në zonë në ndihmë të operacioneve të evakuimit, strehimit, shpërndarjes së ndihmave etj.,

Strukturat e Forcave të Armatosura

Pas kërkesës së AKMC e cila përcolli shkresën urgjente të Prefektit të qarkut, angazhoi në mbështetje të operacioneve emergjente:

Batalionin Mbështetës Rajonal të FA, Grehot Gjirokastër me 20 forca në;

- Kryerjen e punimeve për zhblokimin e akseve rrugore nga lëndët inerte, pemët rrëshqitjet e dheut etj.
- Kontribuuan, kur ishte e nevojshme në masat për zbatimin e ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik dhe kontrollin e trafikut;

Komisariati i Policisë në bashkinë Përmet (Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokaster)

- Siguruan paralajmërimet të hershme dhe marrjen dhe përpunimin e informacioneve publike për përmbytjen. Në bashkëpunim me Njësitë Administrative, Policinë bashkiake kryen informimin urgjent të popullatës që ndodhej në zonat me risk pranë zonës së emergjencës;
- Salla operative e Komisarariatit të Policisë në bashkinë Përmet funksionoi në koordinim të QOE-së në Institucionin e Prefektit dhe QOE-në në bashki;
- Nga strukturat e qarkullimit rrugor u morën masat e duhura për garantimin e lëvizjes së mjeteve zjarrfikëse dhe mjeteve të tjera të rënda të gërmimit, të evakuimit, të urgjencës dhe të transportit dhe devijimet e detyruara të trafikut për shkak të situatës së emergjencës;
- Morën pjesë në operacionet, evakuimit dhe sigurimit të zonës si edhe të strehimit të banorëve të evakuuar;
- Morën pjesë në identifikimin e banorëve të dëmtuar;
- Kryen izolimin dhe ruajtjen e zonës së emergjencës dhe ruajtjen 24/7 të ndërtesave të evakuuara;

- Siguruan ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si edhe bashkëpunimin në veprimet e mëtejshme hetimore;
- Siguruan ndihmë në informim dhe radiokomunikim gjatë emergjencës;

Nj.V.K.Sh dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Përmet

- Mbajtën në gatishmëri urgjencat, laboratorët e specialistët mjekë e infermierë;
- Siguruan pajisje shëndetësore shtesë dhe gjak rezervë sikurse të gjithë sasinë e barnave të nevojshme në sasi të bollshme;
- Siguruan ndihmën e parë mjekësore dhe të urgjencës për të dëmtuarit;
- Krijuan ekipet shëndetësore të emergjencës dhe siguruan kujdesin mjekësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Vendosën në dispozicion personelin e domosdoshëm shëndetësor për t'u ardhur në ndihmë komunitetit në zonat e përmytura;
- Siguruan përkujdesjen shëndetësore në të gjitha nivelet për shtetasit e dëmtuar;
- Siguruan transportin tokësor dhe trajtimin e personave të dëmtuar;
- Siguruan dhënien e asistencës për popullsinë e strehuar tek të afërmit e tyre;
- Kryen kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe të përdorimit familjar si dhe trajtimin etj.
- Siguruan kontrollin dhe ruajtjen e higjienës shëndetësore;
- Siguruan trajtimin e zonave të ndotura;
- Vendosën ekspertët e kërkuar në dispozicion të grupeve të punës së ngritur nga bashkia për vlerësimin e nevojave dhe të dëmeve;

Spitali Përmet

Drejtoria e Spitalit Përmet vendosi në dispozicion të operacioneve 4 ambulanca.

- Mbështeti operacionet dhe evakuimit të pacientëve nga banesat e dëmtuara dhe atyre në rrezik;
- Siguroi kujdesin shëndetësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Asistoi në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale dhe zvogëlimin e panikut;
- Vendosi ekspertë në dispozicion të grupeve të punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;

Dega Përmet e Drejtorisë së OSHEE Gjirokastrë

- Riparoi në kohën më të shpejtë të mundshme defektin e krijuar në linjën e TM që la pa energji elektrike për 12 orë disa fshatra në Nj.A Frashër, Petran e Carcovë
- Mbajti në gatishmëri rrjetin me qëllim furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, veçanërisht në zonat e prekura nga përmytja;
- Në shërbim të operacioneve të përgjigjes ndaj emergjencës, kreu ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej si edhe njoftimin paraprak të publikut për to;
- Bashkëpunoi për furnizimin në mënyrë të pandërprerë me energji elektrike të pompave të ujit të ujësjellësve dhe gjithë infrastrukturës publike dhe kritike;
- Mori masa për sigurimin e vazhdueshëm të furnizimit me energji elektrike të zonave të emergjencës (grumbullimit, zonave të pritjes);
- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;

- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të përgjigjes emergjente, veçanërisht për rehabilitimin e infrastrukturës publike dhe kritike, të gjitha kapacitetet logjistike të kërkuara

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Rrugor Shqiptar – Gjirokastrë

- Informoi në kohë për segmentet e bllokuara të rrugëve kombëtare dhe nëpërmjet kompanive kontraktore, garantoj zhblokimin dhe mbajtjen gjithmonë funksionale të tyre;

- Ofroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;

- Nëpërmjet kontraktorëve asistoi në ofrimin e logjistikës për transportin dhe sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike;

- Nëpërmjet kontraktorëve ofroi kapacitete mbështetëse në riparimin e segmenteve rrugore nën juridiksionin e bashkisë.

ZVA Përmet

- Ofroi ekspertizën institucionale në grupet e punës për vlerësimet fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe të nevojave në arsim etj;

- Monitoruan nga afër shkallën e rrezikut për secilën nga institucionet arsimore dhe informuan menjëherë Prefektin dhe Kryetarin e bashkisë për ato institucione që duhet të ndërpritej përkohësisht frekuentimi;

- Në bashkëpunim me autoritetet e menaxhimit të emergjencës, bashkëpunoi për organizimin dhe përkujdesjen për nxënësit gjatë operacioneve të transportit;

- Mbajtën në gatishmëri grupet e shpëtimit dhe shoqërimit të nxënësve dhe evakuimit të tyre, me qëllim regjistrimin e nxënësve të evakuuar dhe dërgimin e tyre pranë familjeve në rast nevojë.

Spektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në bashkinë Përmet

MZSH e bashkisë Përmet është struktura kryesore për operacionet e S&R dhe evakuimit e cila siguroi komandën, kontrollin dhe koordinimin e të gjitha burimeve në vendet e incidentit.

- Ajo mobilizoi në funksion të operacioneve të gjitha kapacitetet bazuar planit operacional dhe planit të emergjencave civile dhe pjesëmarrjen e forcave dhe mjeteve të MZSH-së në operacionet e ndryshme të S&R; evakuimit të njerëzve; evakuimit të gjësë së gjallë dhe ushqimit të tyre; nxjerrjen e ujit nga katet e para të ndërtesave të përmbytura dhe më pas pastrimin e tyre nga balta dhe mbeturinat;

- Siguroi lidhjen dhe informimin e vazhdueshëm të QOE-se dhe KMC-së në bashki dhe Institucionin e Prefektit sikurse të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në MB;

- Siguroi pajisjen e forcave me pajisjet mbrojtëse personale për të operuar në zonën e operacionit në të cilin ishin caktuar; dhe siguroi që të gjitha forcat e përfshira në operacione të mbështeteshin dhe menaxhoheshin nga një ekip ndër-agjensi i menaxhimit të incidentit;

- Bashkërendoi veprimet me strukturat e FA, PSH, SHU, strukturave të tjera të bashkisë, degëve territoriale dhe vullnetarëve që u përfshinë në operacionet e S&R dhe evakuimit;

- Udhëhoqi punën e grupeve të ngritura nga Kryetari i bashkisë për vlerësimin e nevojave dhe dha kontribut në grupet për vlerësimin e dëmeve;

- Udhëhoqi gjithë procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit gjatë operacioneve;
- Mori pjesë në operacionet e rivendosjes në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike si dhe për forcimin e argjaturave dhe hapjen e kanaleve kullues.

Spektori i Emergjencave Civile në bashkinë Përmet

- Drejtoi gjithë procesin e dhënies së paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit për popullsinë e zonave në rrezik;
- Siguroi funksionimin 24/7 të drejtorisë si Sekretariat i KMC-së së bashkisë Lezhë;
- Siguroi mbarëvajtjen e punës së QOE-së sikurse të KMC-së në bashki;
- Siguroi informimin e vazhdueshëm të Prefektit, publikut, medias, donatorëve, KSSH-së, dhe OJF- të interesuara;
- Vendosi ekspertë në përbërje të grupeve të punës për vlerësimin fillestar të nevojave dhe kryesoi punën e grupeve të vlerësimit të dëmeve;
- Spektori i Emergjencave Civile në bashki dhe një staf i kësaj drejtorie mbështetën Drejtuesin e Operacionit (Përgjegjës të Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Institucionin e Prefektit);
- Së bashku me komandantët e incidentit paraqiti propozimet në lidhje me evakuimin tek Drejtuesi i Operacionit në bashki.

Policia bashkiake

- Asistoi në operacionet e dhënies së paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit për popullsinë e zonave në rrezik;
- Asistoi në evakuimin dhe strehimin e popullsisë civile dhe të gjësë së gjallë;
- Asistoi PSH në operacionet e ndryshme siç janë ato të ruajtjes së rendit publik, sigurisë dhe kontrollit të trafikut rrugor, ruajtjes së banesave të evakuara, këshillimin e banorëve të zonave me risk etj.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve


- Asistoi në operacionet e evakuimit dhe strehimit të popullsisë;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të rehabilitimit të infrastruktureve publike dhe kritike;
- Me forcat dhe mjetet që disponon, sikurse nëpërmjet kontraktorëve, siguroi mbajtjen funksionale të segmenteve të rrugëve nën juridiksionin e bashkisë;
- Koordinoi punën me Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Rrugor Shqiptar – Gjirokastër për veprimtari të përbashkëta në mbajtjen funksionale të segmenteve rrugore nacionalë;
- Ofroi lehtësira logjistike (transporti, magazinimi etj.).

Sh.A Ujësjiellës Kanalizime dega Përmet

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave;
- Mbajti në gatishmëri linjat e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës së prekur nga përmytja;

- Garantoi sistem të sigurt të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në përputhje me standardet kombëtare të ruajtjes së shëndetit dhe mjedisit;
- Monitoroi pandërprerë dhe informoi urgjentisht Kryetarin e bashkisë dhe Prefektin e qarkut për çdo problematikë të shfaqur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve si pasojë e situates së krijuar nga përmytja;
- Bashkëpunoi me Drejtoritë e Higjienës për kryerjen e analizave periodike dhe klorifikimin e ujit të pijshëm;
- Bashkëpunoi me Degën përmet të Drejtorisë së OSHEE Gjirokaster për sigurimin në vazhdimësi të punës së elektropompave që furnizojnë depot e ujit;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të rehabilitimit të infrastructures publike veçanërisht asaj të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve;
- Ofroi lehtësira logjistike (transporti, magazinimi etj.)

Skema e aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në përballimin e emergjencës sipas skenarit të përmbytyjes në territorin e Qarkut Gjirokaster



**SKENARI
ZJARR NË PYJE**
Sipas ngjarjes së ndodhur në bashkinë Përmet

Konteksti

Nr	Zjarr	Vendi	Data	
			Fillimi	Mbarimi
1	Zjarr në pyll të përzier, (Pishe, shkurre e kullote)	Bashkia: Përmet Njësia Administrative: Piskovë Fshati: Kutal	30.07.2021	31.07.2021
			Sipërfaqja e përshkuar dhe djegur nga zjarri 12 ha (Pyll me pishe 6.5 ha dhe she shkurre e kullote 5.5 ha)	






Fig:12 Foto të zjarrit dhe të sipërfaqes së djegur në zonën e emergjencës (Kutal Përmet) korrik 2021.

A) Vlerësimi periodik i realitetit në bashkinë Përmet.

Historikisht pyjet janë mjaft të rrezikuara nga rënia e zjarreve si nga shkaqe natyrore ashtu dhe humane. Pothuajse çdo vit, në periudhën e nxehtë të verës, në territorin e bashkisë Përmet ndodhin zjarre që përfshijnë sipërfaqe pyjesh, shkurresh e kullotash. Më tepër informacion mbi zjarret në pyje gjendet në hyrje të këtij raporti.

B) Çfarë e shkaktoi emergjencën e zjarrit?

Arsyet e rënies së zjarreve në bashkinë Përmet janë nga më të ndryshmet. Në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme, në 99 % të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu, në mënyrë direkte ose indirekte. Shkaktarët e zjarreve në pyje mund të jetë thatësira gjatë gjithë verës, era e fortë, temperaturat e larta, lagështia e ulët të cilat shkaktojnë kushte të jashtëzakonshme thatësire në pyll. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu, ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e hershme kur vegjetacioni barishtor nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri nuk ka filluar akoma. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjahtarët, fermerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me synim që të zgjerojnë token e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lire për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale.

Konkretisht zjarri i skenarit, vlerësohet se është shkaktuar nga persona të cilët kryenin veprimtari në pyll.

C) Ndikimet e emergjencës së zjarrit mbi njerëzit, pasurinë, infrastrukturën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin? Popullsia e prekur, ajo e zhvendosur, karakteristikat e tyre.

Zjarri u shua në orën 7.00 të ditës së pestë të tij, pra kohëzgjatja e tij ishte 114 orë. Njësia administrative piskovë ka një popullsi rreth 4'000 banorë. Nga ky zjarr kërcënohen rreth 200 banesave që janë me një popullsi rreth 1000 banorë në fshatin Kutal të kësaj njësie.

- Nga zjarri kishim këto dëmtime në njerëz:
 - 1 efektiv i MZSH-së Përmet me djegie të vogla që u dërgua në spital;
 - 2 efektivë të FA me shqetësime të aparatit frymëmarrës dhe 4 banorë që iu dha ndihma e parë e nevojshme në vend nga ambulancat e Nj.V.K.SH Përmet që ndodhej e dislokuara në fshatin Kutal
 - Ndikimet më të mëdha të zjarrit të rënë janë në masivin pyjor me pisha dhe shkurre në very të fshatit Kutal (ZM)nga i cili u dogjën nga zjarri 68 ha, dhe u përshkuan 52 ha;
 - U dëmtuan pjesërisht nga flakët, 1 ndërtesë banimi dhe 2 kasolle bagëtish
 - Pësuan dëmtime në muret rrethuese dhe muret e jashtme rrethuese të 1 restoranti;
 - Djegia e këtij masivi pyjor ndikon negativisht në cilësinë e ajrit gjatë kësaj periudhe, në zonë;
 - Sipërfaqet e djegura, ndër të tjera, do të rrisin dukurinë e erozionit sikurse mundësinë e rrëshqitjeve të dherave dhe të masivëve shkëmbore dhe gurëve.
 - Zjarri ndikoi në bllokimin e trafikut rrugor në aksin rrugor Përmet – Këlcyrë në vendin e quajtur Degëzim Kutal – Ura e Bualit, duke sjellë shqetësime për qarkullimin e banorëve
 - Kohëzgjatja e zjarrit ishte e madhe dhe shkaktoi panik në zonë. Për shkak edhe të reve të tymit në fshat dhe qytetin përmet
- Retë e mëdha të tymit që shtyheshin nga erërat e fuqizuara për shkak të flakëve të zjarrit shkaktuan një ndotje dhe shqetësim për popullsinë e qytetit por edhe zonave përreth vatrave të zjarrit;
- U dëmtua nga zjarri në dy pika linja e TM (10Kv) e cila furnizon kabinat elektrike në zonën e fshatit Kutal

Ç) Nevojat humanitare tek popullsia e prekur. Nevojat për përgjigje. Burimet dhe pajisjet që do të nevojiten dhe burimet dhe pajisjet që disponohen aktualisht. Trajtimi i problematikave që dolën.

Nevojat e evidentuar për shkak të zjarrit janë;

- Njoftimi i gjithë banorëve të zonave të banuara përreth për t'u larguar nga banesat në risk nga zjarret;
- Izolimi dhe shuarja sa më shpejt e vatrave të zjarrit;
- Kërkim shpëtimi në disa prej ndërtesave që dyshohet për banorë të bllokuar;
- Evakuimi dhe strehimi në rast nevoje i banorëve të evakuuar;
- Triazhimi dhe mjekimi i efektivëve, vullnetarëve, banorëve të dëmtuar gjatë operacioneve dhe e banorëve të evakuuar; Dërgimi në Spitalin e qytetit i të dëmtuarëve;
- Riparimi i infrastrukturës së dëmtuar nga zjarri (linja elektrike e TM dhe TU)

Kapacitetet e nevojshme për t'u angazhuar janë:

- E gjithë struktura e MZSH-së së bashkisë Përmet;
- Kapacitete logjistike dhe njerëzore të strukturave të tjera të bashkisë që nevojiten në operacionet e ndryshme të përgjigjes ndaj emergjencës dhe që janë:
 - ✓ Sektori Emergjencave Civile;
 - ✓ Policia bashkiake;
 - ✓ Njësia e Administrimit të Pyjeve;
 - ✓ Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve;
 - ✓ Sektori Ujit e Kullimit dhe Transportet specifike në bashki;
 - ✓ Drejtoria e Shërbimit Social

Nevojat për kapacitete reagimi shtesë përveç atyre të bashkisë janë:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit;
- Komisarjati i Policisë në bashkinë Përmet dhe Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër;
- Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit / IKMT;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Gjyrokastër;
- Dega Përmet e Drejtorisë së OSHEE Gjyrokastër;
- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Spitali Përmet;
- Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Përmet

Tabela: Institucionet e angazhuara dhe kapacitetet e vëna në dispozicion

Nr	Institucionet/Strukturat	Kapacitetet e vëna në dispozicion
1	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit/MZSH i bashkisë Përmet	2 automjete zjarrfikëse dhe 12 personel zjarrfikës
2	Forca të tjera nga bashkia Përmet	Drejtoria e Shërbimeve. 2 automjete dhe 20 punonjës Njësia Administrative Piskovë - 4 punonjës dhe 15 vullnetar të fshatit Kutal Njësia e Administrimit të Pyjeve në bashki, me 4 inspektorë pyjesh dhe 10 punonjës
3	MZSH bashkia Këlcyrë	1 automjet zjarrfikës me 4 personel zjarrfikës
4	MZSH bashkia Tepelenë	1 automjet zjarrfikës me 4 personel zjarrfikës
5	MZSH bashkia Gjyrokastër	2 automjet zjarrfikës me 6 personel zjarrfikës
6	Batalioni Mbështetës Rajonal i Forcave të Armatosura, Repartit të Këmbësorisë, Grehot Gjyrokastër	20 forca, 2 automjete, 1 mjet zjarrfikës
7	Spitali Përmet	1 mjek, 1 infermier, 2 barela mbajtës dhe 1 mjet ambulance
8	Komisarijati i Policisë në bashkinë Përmet dhe Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër	2 patrulla të policisë rrugore në aksin rrugor Përmet – Këlcyrë me qëllim sigurimin e qarkullimit 6 punonjës shtesë të PSH për sigurimin e zones së emergjencës
9	Dega Përmet e Drejtorisë së OSHEE Gjyrokastër	Një skuadër e riparimit të avarive nga ana e OSHEE për riparimin e defektit të shkaktuar në linjat elektrike
10	Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki. Nj. V.K.SH dhe ISHSH	Punonjës socialë dhe psikologë për asistimin e reaguesve, popullsisë,

D) Funkcionet operacionale për përballimin e fatkeqësisë së zjarrit

Paralajmërimi i hershëm dhe informacioni publik për emergjencat, këshillimi i publikut

Për vetë natyrën e emergjencës, nuk ishte e mundur paralajmërimi i hershëm i banorëve të zonave përreth vatrave të zjarrit. Gjithsesi një informacion urgjent për zjarrin e rënë popullata e mori përmes Shërbimit të Informacionit të Policisë dhe Shërbimit Zjarrfikës të bashkisë, Sektorit të Emergjencave Civile dhe Kryetari fshatit Kutal

Gjithashtu banorët unjoftuan nëpërmjet sirenave të vetë automjeteve zjarrfikëse që mbërritën menjëherë në vijën e zjarrit. Dhënia e alarmit për popullsinë e zonave në rrezik u drejtua nga Sektorit Emergjencave Civile në bashki dhe u mbështet nga PSH dhe Policia Bashkiake.

Operacioni i shuarjes së zjarrit

Operacionet e shuarjes së zjarreve me automjete zjarrfikëse u kryen nga MZSH Përmet së bashku me strukturat e MZSH-ve të bashkive Gjirokastër, Tepelenë e Këlcyrë

Operacionet e izolimit dhe shuarjes së zjarreve me pompa shpine, kazma, lopata dhe me mjete të tjera rrethanore u kryen nga trupat e Batalionit të Këmbësorisë Grehot, të mbështetura edhe nga vullnetarë të Njesisë Administrative Piskovë, nga forcat bashkiake dhe të AdZM Gjirokastër. Struktura mbështetëse të operacioneve, me detyra specifike, ishin strukturat e PSH, Nj.V.K.SH, KKSH.

Organizimi dhe drejtimi, koordinimi qendror / i përgjithshëm i përballimit të emergjencës

Organizimi dhe drejtimi u kryen nga KMC në qark dhe KMC në bashki. Bazuar në shkallën e emergjencës dhe përvojës, Bashkia nuk i kërkoi Prefektit të Qarkut dërgimin e kërkesës për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore sikurse edhe nga Prefekti i Qarkut nuk u pa e udhës dërgimi i një kërkesë të tillë.

Bazuar në Planin e Emergjencave Civile kryetari bashkisë caktoi Drejtuesin e Operacionit për shuarjen e zjarrit, shefin e sektorit të MZSH.

Kërkim-shpëtimi

Nuk u paraqit nevoja për organizimin e operacionit për kërkim - shpëtim

Evakuimi i popullsisë civile

U evakua 1 stan me bagëti të imta që ndodhej në zonën e emergjencës. Nuk u paraqit nevoja për organizimin e evakuimit të popullsisë civile.

Strehimi i përkohshëm

Asnjë banorë i rrezikuar dhe banesë e djegur nga zjarri

Kujdesi mjekësor/ndihma e parë gjatë emergjencës (triazimi/klasifikimi)

Në dispozicion të përballimit të emergjencës ishin Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Spitali Përmet.

Ambulanca (pas miratimit të vendosjes në dispozicion të operacioneve nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore) që ndodhej e dislokuar në dhanë ndihmën e parë për:

- 1 efektiv të MZSH-së së lënduar gjatë operacioneve që i dhanë asistencën shëndetësore sikurse e dërguan me ambulancë në spital;

- 2 efektiva të FA të angazhuar në shuarjen e zjarrit nga toka, dhe 4 banorë, të cilët paraqitën problem të aparatit të frymëmarrjes, që u dhanë në vend asistencën e nevojshme. Nuk ishte e nevojshme dërgimi i tyre për trajtim të mëtejshëm shëndetësor.

Vlerësimi fillestar dhe ai i specializuar i dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura

MZSH Përmet kreu vlerësimin e situatës fillestare të zjarrit dhe të dëmit dhe përcaktoi mënyrën e përshtatshme të reagimit për të përmbushur kërkesën për ndihmë. Vlerësimi i nevojave dhe dëmeve të shkaktuara u krye nga grupi i punës së ngritur nga bashkia.

Grupi u drejtua nga MZSH e bashkisë i përbërë nga:

Njësia Administrative Piskovë;

- ✓ Sektori Emergjencave Civile në bashki;
- ✓ Drejtoria e Planifikimit të Territorit;
- ✓ Njësia e Administrimit të Pyjeve;
- ✓ Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit;

Kontribuan në vlerësimin e nevojave dhe dëmeve:

- ✓ Agjencia Rajonale e Mjedisit Gjirokastër ;
- ✓ Administrata e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër;

Zbatimi i ligjit, masat e sigurisë dhe masat për ruajtjen e rendit publik, siguria dhe kontrolli i trafikut

Zbatimi i ligjit dhe sigurisë në këtë rast lidhej me:

-Sigurimin e zonës së emergjencës

- Disiplinimin e trafikut në rrugët rreth zonës së zjarreve dhe devijimin e tij sipas zhvillimit të situatës së zjarreve;

- Sigurimin e lëvizjes së automjeteve zjarrfikëse, ambulancave dhe automjeteve të tjera në mbështetje të operacioneve për në destinacionet e tyre.

Për kryerjen e detyrave më lart ishin mobilizuar 2 postblloqe shtesë të Policisë Rrugore.

Në zbatimin e funksioneve të mësipërme, strukturat e PSH u asistuan edhe nga struktura e Policisë Bashkiake.

Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe procedurat e raportimit

Komunikimi u krye midis niveleve të ndryshme, paralele, nga lart poshtë dhe anasjelltas. Mjetet e komunikimit të përdorura janë të ndryshme si me telefon, celular

Në kushtet kur nuk ka ende një komunikim me radio midis forcave të ndryshme operacionale, strukturat e PSH asistuan me radiot e tyre për këtë qëllim.

Shërbimet e Ndhmës Sociale, mbështetja psikosociale

Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki e udhëhoqi këtë funksion, së bashku me Nj.V.K.SH dhe ISHSH. Psikologët ishin në dispozicion dhe u angazhuan në ndihmë të popullatës por edhe të forcave operacionale dhe punonjësve të tjerë të angazhuar në përgjigjen ndaj emergjencës.

Sigurimi dhe rivendosja në funksion e infrastrukturës publike dhe kritike

Ditën e parë të emergjencës, nga zjarri u dëmtua linja elektrike e tensionit të mesëm e të ulët; OSHEE mori masa për eliminimin e menjëhershëm të avarive të krijuara nga zjarret dhe ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej. Një skuadër e riparimit të avarive nga ana e OSHEE e riparoj defektin e shkaktuar në linjën elektrike.

Asistencë në sigurimin dhe rivendosjen në funksion të infrastrukturës publike dhe kritike u dha edhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve.

Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KMC në qark

- Bazuar në kërkesat e bashkisë Përmet dhe nevojave të evidentuara nga grupi i vlerësimit të nevojave të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë, kreu koordinimin e të gjithë aktorëve në nivel qarku me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave me kapacitete shtesë për përgjigjen ndaj emergjencës së zjarrit;

- Pas konkludimit të nevojës për kapacitete shtesë të FA për shuarjen e zjarrit, Prefekti dërgoi menjëherë tek AKMC kërkesën për t'iu drejtuar menjëherë ShPFA-së;

- Përgatiti informacione periodike sipas kërkesës për AKMC-në si dhe për publikun, median, donatorët, KKSH, dhe OJF- të e interesuara;

- Organizoi grupe pune për të ndjekur, kontrolluar e zbatuar detyra për monitorimin e situates dhe marrjen e masave të ndryshme sipas problematikave që kanë të bëjnë përgjigjen ndaj emergjencës;

- Nëpërmjet Sektorit të EC koordinoi të gjitha masat koordinuese dhe bashkërenduese për mbrojtjen e jetës së komunitetit, evakuimin, strehimin, furnizimin me artikujt e nevojshëm ushqimor, medikamente mjekësore, etj.

Bashkia Përmet

- Mblodhi urgjentisht KMC për konsultime për zjarrin dhe mori vendimet respektive;

- Aktivizoi 24/7 Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile (nëse është operacionale);
- Siguroi 24/7 funksionalitetin dhe vënien në veprim për reagimin ndaj zjarrit të të gjitha strukturave të saj;
- Nën koordinimin e MZSH, siguroi pjesëmarrjen e ekspertëve të bashkisë në grupe të përbashkëta të vlerësimit dhe verifikimit të dëmeve dhe të nevojave për përbalimin e situatës së zjarreve;
- Siguroi informacion të vazhdueshëm dhe të përditësuar rreth situatës në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit për situatën;
- Hartoi raportin e parë për situatën dhe informacione të mëtejshme periodike, të cilat iu dërguan Prefektit;
- Përgatiti informacione sipas kërkesës për Institucionin e Prefektit.

Njësia Administrative Piskovë

- Mobilizoi të gjithë burimet njerëzore mjetet logjistike që ka në juridiksionin e saj nën drejtimin e KMC në bashki dhe Qark në funksion të operacioneve për shuarjen e zjarrit;
- Kreu njoftimin dhe alarmin për gjithë popullsinë në rrezik si edhe informimin e KMC në bashki;
- Aktivizoi ekspertë nga Nj.A në grupet e punës për vlerësimin fillestar dhe të specializuar të dëmeve dhe të nevojave në zonën prekur nga zjarri;
- Organizoi punën me kapacitetet e Nj.A dhe me rrjetin e vullnetarëve që ka në zonë për operacionet e evakuimit, strehimit etj.,

Forcat e Armatosura

2 orë pas marrjes së kërkesës së drejtuar nga Prefekti i Qarkut dhe të miratuar dhe përcjellë nga AKMC, ShPFA angazhoi në mbështetje të përgjigjes emergjente:

- 20 forca tokësore nga Batalioni Mbështetës Rajonal i Forcave të Armatosura, Repartit të Këmbëorisë Grehot Gjirokastër që u angazhuan së bashku me forcat e MZSH-ve dhe vullnetarët në operacionet e shuarjes së zjarrit;
- 1 automjet zjarrfikës me personelin përkatës që operoi në shuarjen e zjarreve bashkë me automjetet e MZSH-ve

Agjencia Rajonale e Mjedisit

Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë tëspecializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura.

Komisariati i Policisë në bashkinë Përmet, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër

- Salla operative e Komisarariatit të Policisë në bashkinë Përmet funksionoi në koordinim të QOE në Institucionin e Prefektit dhe QOE në bashki;
- Njëpërmjet grupeve të ekspertëve të strukturave të specializuara morën masat e duhura për evidentimin dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të zjarrvënieve;
- Siguroi mbështetjen me mjete dhe forcat sa herë që kërkohej ndihmë nga KMC në Prefekturë dhe bashki;
- Nga strukturat e qarkullimit rrugor u morën masat e duhura për garantimin e lëvizjes së mjeteve zjarrfikëse në vatrat e zjarrit apo në objekte me risk zjarri dhe devijimet e detyruara të trafikut për shkak të situatave të krijuara nga zjarret;
- Morën pjesë në operacionet e kërkim shpëtimit, evakuimit dhe sigurimit të zonës si edhe të strehimit të banorëve të evakuuar;
- Morën pjesë në identifikimin e banorëve të dëmtuar;
- Kryen izolimin dhe ruajtjen e zonës së emergjencës;
- Siguruan ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike;

- Në bashkëpunim me Policinë bashkiake kryen informimin urgjent të popullatës që ndodhet në zonat me risk pranë zonës së emergjencës;
- Siguruan ndihmë në informim dhe radiokomunikim;

Administrata e Zonave të Mbrojtura Qarku Gjirokastrë

- Vendosi në dispozicion të grupeve të punës, ekspertë për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Vendosi në dispozicion dhe në funksion të shuarjes së zjarreve 10 forca nga AdZM Gjirokastrë

Dega Përmet e Drejtorisë së OSHEE Qarku Gjirokastrë

- Garantoi furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike, veçanërisht në fshatin Kutal 2 bizneseve, si dhe informimin e publikut për ndërprerjet e planifikuara për shkak të zjarreve;
- Mori masa për ndërprerjen e detyruar të furnizimit me energji aty ku nevojitej dhe njoftimin e banorëve për këtë.
- Një skuadër e riparimit të avarive riparoj defektin e shkaktuar në linjën elektrike.

Spitali Përmet

- Mbështeti operacionet dhe evakuimit të pacientëve nga banesat e dëmtuara nga flakët dhe atyre në rrezik;
- Siguroi kujdesin shëndetësor/ndihmën e parë gjatë emergjencës (triazhimi/klasifikimi);
- Asistoi në shërbimet e ndihmës sociale, mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut.
- Vuri në dispozicion të operacionit 1 mjek, 1 infermier, 2 barelembajtës dhe 1 mjet ambulancë.

Spektori MZSH-së së bashkisë Përmet

- MZSH e bashkisë Përmet është struktura kryesore për zbulimin dhe shuarjen e zjarreve në ambient të hapur, rural dhe urban e cila siguron komandën, kontrollin dhe koordinimin e të gjitha burimeve;
- Ajo mobilizoi në funksion të operacioneve të shuarjes së zjarreve të gjitha kapacitetet bazuar planit operacional dhe planit të emergjencave civile;
- Siguroi lidhjen dhe informimin e vazhdueshëm të QOE-se dhe KMC-së në bashki dhe Institucionin e Prefektit sikurse të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në MB;
- Kreu vlerësimin e situatës fillestare të zjarrit dhe të dëmit dhe përcaktoi mënyrën e përshtatshme të reagimit ndaj zjarrit;
- Analizoi secilën kërkesë para angazhimit të forcave dhe burimeve të tjera;
- Siguroi pajisjen e forcave me pajisjet mbrojtëse personale për të operuar në zonën e operacionit në të cilin ishin caktuar; dhe siguroi që të gjitha forcat e përfshira në përgjigjen ndaj zjarrit të mbështeteshin dhe menaxhoheshin nga një ekip ndër-agjensi i menaxhimit të incidentit;
- Para mobilizimit, kreu një informim specifik për të gjitha incidentet dhe në të u përfshinë përshkrimi i incidentit, kërkesat e misionit dhe rreziqet e njohura.

U identifikuan pajisjet mbrojtëse kryesore dhe nevojat shoqëruese për detyrat që punonjësit nuk i ndeshin apo kryejnë në mënyrë rutinë;

Pas konkludimit mbi pamjaftueshmërinë e kapaciteteve të bashkisë Lezhë për fikjen e zjarrit iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit në MB për vënien në dispozicion të kapaciteteve luftuese shtesë nga bashkitë e tjera;

- Iu argumentua Kryetarit të Bashkisë domosdoshmëria e përfshirjes në operacionet e shuarjes së zjarrit edhe të FA (forcave tokësore për luftimin e zjarrit);
- Bashkërendoi veprimet me strukturat e FA, PSH, SHU, strukturave të tjera të bashkisë degëve territoriale dhe vullnetarëve që u përfshinë në operacionin e shuarjes së zjarreve;

- Udhëhoqi punën e grupeve për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Udhëhoqi gjithë procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit gjatë operacioneve

Spektori Emergjencave Civile në bashkinë Përmet

- Drejtoi gjithë procesin e dhënies së alarmit për popullsinë e zonave në rrezik nga zjarri;
- Siguroi funksionimin 24/7 të drejtorisë si Sekretariat i KMC-së së bashkisë Përmet;
- Siguroi mbarëvajtjen e punës së QOE-së sikurse të KMC-së në bashki;
- Siguroi informimin e vazhdueshëm të Prefektit, AKMC-së, publikut, medias, donatorëve,
- Vendosi ekspertë në përbërje të grupeve të punës për vlerësimin fillestar dhe atë të specializuar të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura;
- Spektori i Emergjencave Civile në bashki mbështetën Drejtuesin e Operacionit (Shefin e Sektorit MZSH të bashkisë)

Policia bashkiake

- Asistoi në operacionet e dhënies së alarmit për popullsinë e zonave në rrezik nga zjarri;
- Asistoi në evakuimin dhe strehimit të popullsisë civile;
- Asistoi PSH në operacionet e ndryshme siç janë ato të ruajtjes së rendit, disiplinimit të qarkullimit, ruajtjes së banesave të evakuuara, këshillimin e banorëve të zonës me risk etj.

Njësia e Administrimit të Pyjeve në bashki

- Njëpërmjet vrojtuesve të saj siguron paralajmërimet e hershme në lidhje me zjarret ekzistues dhe vatrat e reja të zjarreve;


Mori pjesë në operacionin për shuarjen e zjarrit me stafin e saj

- Mori pjesë në grupet e punës për vlerësimin paraprak dhe të specializuar të dëmeve dhe nevojave për shuarjen e zjarrit.

Spektori e Shërbimeve Publike, Njësia e Mirëmbajtjes së Institucioneve të bashkisë

- Mori pjesë në operacionin për shuarjen e vatrës së zjarrit me 20 forca e 2 mjete transporti
- Asistoi në operacionet e evakuimit të popullsisë nga zona e prekur nga zjarri;
- Kontribuoi në punimet emergjente që u kryen në funksion të përgjigjes ndaj emergjencës së zjarrit, sikurse janë hapjet e rrugëve në pyll, pastrimit të brezave të izolimit nga zjarri, punime të ndryshme në funksion të rehabilitimit të infrastrukturës zonën urbane etj.;

Skema e aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të angazhuar në përballimin e emergjencës sipas skenarit të zjarrit në territorin e Qarkut Gjirokaster



9. Referenca

9.1 / Referencat ligjore dhe dokumentare

Referencat ligjore:

- Ligji Nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”
- Ligji nr.139 / 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian” 2022–2030
- Ligji 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”
- Ligji Nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të këshillit të ministrave, “për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore””
- Ligji Nr. 75/2016 "Për Miratimin e Marrëveshjes së Parisit"
- Ligji Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”
- Ligji Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- VKM Nr. 168, datë 24.3.2023 “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”
- VKM Nr. 94, datë 22.2.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit”.
- VKM Nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”
- Ligji Nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik” i ndryshuar.
- VKM Nr. 241, datë 27.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor”
- Ligji Nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 419, datë 4.7.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”.
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar
- VKM Nr. 568, datë 17.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.
- VKM Nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.
- Ligji Nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve”.
- VKM Nr. 147, datë 13.3.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor”.
- VKM Nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- VKM Nr. 102, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”.

- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, i ndryshuar”.
- Ligji Nr. 29/2024 “Për burimet ujore”.
- VKM Nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar
- VKM nr. 881, datë 14.12.2016, “Për miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar të territorit”. Fletore Zyrtare nr. 248, datë 23.12.2016.
- VKM Nr. 232 datë 17.04.2019 "Pe disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit"
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”
- Ligj Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"
- Ligji nr.9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar
- Urdhër Kryeministri Nr. 21, datë 5.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të qarkut”.

Referencat dokumentare:

- Prefekti i Qarkut Gjirokastrë. *Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Gjirokastrë*. 2025.
- Prefekti i Qarkut Gjirokastrë. *Plani Vendor i Emergjencave Civile Qarku Gjirokastrë 2025*
- Bashkia Përmet. *Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel vendor*. 2025.
- Bashkia Përmet. *Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë*. 2025.
- Kuadri Sendai për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive
- Dokumenti Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësisë-Shkurt 2019 (Albania post-disaster needs assessment report, February 2020)Comprehensive Preparedness Guide (CPG) 101 September 2021, Version 3.0.

ANEKSE


Aneks 1: Zonat e Emergjencës

Zonë e Mbuluar për Strehimin e Popullsisë

Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Gjimnazi “ Sami Frashëri” (palestra)		
Koordinatat	40 ⁰ 14’ 09” N, 20 ⁰ 21’ 05”		
Rruga e Aksesit	Rruga “Tomor Mullaraj”		
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Po
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Po
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Gjimnaz	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Si. Përgj. 1200 m ² Palestra 1, 60 m ² Palestra 2, 52.5m ²	Kapaciteti i personave Në palestër	20



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Pallati Sportit		
Koordinatat	40 ⁰ 14' 12", 20 ⁰ 21' 05"		
Rruga e Aksesit	"America Street"		
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Pallat Sporti për lojërë me dorë	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Sip. Përgj. 900 m ²	Kapaciteti i personave	30



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Shkolla 9-Vjeçare “ Nonda Bulka” (Palestra)		
Koordinatat	40° 14’ 30”, 20° 21’ 10”		
Rruga e Aksesit	Shetitorja “Mentor Xhemali”		
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Po
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Po
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Shkolla 9-Vjeçare	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Sip. Përgj.950 m ² Palestra 128 m ²	Kapaciteti i personave	



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë

Emri i Zonës	Shkolla 9-Vjeçare “ Meleq Gosnishti” (Palestra)
Koordinatat	40 ⁰ 13’ 52”, 20 ⁰ 21’ 14”
Rrugës e Aksesit	Rruga “ Meleq Gosnishti”

Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës

Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Po
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Po
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		

Tiparet e Ndërtimit

Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Shkollë 9- Vjeçare	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Sip. Përgj. 1001.52 m ² Palestra 100 m ²	Kapaciteti i personave	20



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Fshati Piskovë, godina e shkollaës		
Koordinatat	40 ⁰ 16' 50", 20 ⁰ 16' 23"		
Rrugës e Aksesit			
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Shkollë	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Një kat 200 m ² +palestra 40 m ²	Kapaciteti i personave	30



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Fshati Petran, godina e shkollës		
Koordinatat	40 ⁰ 12' 29", 20 ⁰ 25' 08"		
Rruga e Aksesit			
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Shkollë	Lloji i Ndërtimit	Strukturë betonarmeje
Sipërfaqja	Një kat 175 m ²	Kapaciteti i personave	30



Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Fshati Çarshovë, godina e shkollës		
Koordinatat	40 ⁰ 06' 57", 20 ⁰ 32' 23"		
Rruga e Aksesit			
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Po		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Shkollë	Lloji i Ndërtimit	
Sipërfaqja	Dy kate 200 m ²	Kapaciteti i personave	35

Zonë e Hapur për Strehimin e Popullsisë

Zonë e hapur për strehimin e popullsisë			
Emri i Zonës	Ish Rep. Usht. “ Komando”		
Koordinatat	40 ⁰ 13’ 52”, 20 ⁰ 21’ 27”		
Rruga e Aksesit	Rruga “ Kongresi Përmetit”		
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Jo		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Ministria e Mbrojtjes		
Përdorimi i Synuar	Ish rep. ushtarak	Lloji i Ndërtimit	Ndërtesa pa çati Fushë e hapur
Sipërfaqja	3.7 ha	Kapaciteti i personave	160 -240






Fig.: Varianti A i një fushe kampingu. 6 module x 8 tenda me përmasa 6x4 m. Sipërfaqe kampingu 65x110 m. Kapaciteti 190 -240 persona




Fig.: Varianti B i një fushe kampingu. 4 module x 8 tenda me përmasa 7.8x5.1 m. Sipërfaqe kampingu 65x110 m. Kapaciteti 130 -160 persona

Zona për uljen e helikopterit

Zonë e hapur për uljen e helikopterit			
Emri i Zonës	Fusha e sportit, “Stadiumi Durim Qypi”		
Koordinatat	40 ⁰ 14’ 11”, 20 ⁰ 21’ 26”		
Rruga e Aksesit			
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike	Po	Rrjeti Internet / Ëi-Fi	Jo
Gaz	Jo	Linja telefonike Fikse	Jo
Uji i Pijshëm	Po	Sinjal Celular	Po
Kanalizime	Jo		
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës	Publike		
Përdorimi i Synuar	Fushë sporti	Lloji i Ndërtimit	Fushe e rrethuar me mur betoni
Sipërfaqja	5000 m ² (0.5 ha)	Kapaciteti i uljes	2 helikopterë



Aneks 2: Raportimet

Raportimi Fillestar i Emergjencës

Bashkia:

Data: ___ / ___ / _____ **Ora:** __ : __ **Raporti Nr/datë:** _____

Shkaku i Emergjencës:

<input type="checkbox"/> Përmytje	<input type="checkbox"/> Jarre në pyje	<input type="checkbox"/> Je
<input type="checkbox"/> Tërmet	<input type="checkbox"/> Jarre Urbane/Industriale	<input type="checkbox"/> Ja
<input type="checkbox"/> Rrëshkitje toke	<input type="checkbox"/> Incident Të tjera	
<input type="checkbox"/> Stuhi	<input type="checkbox"/> Incident Industrial	

Vendi i origjinës së emergjencës, adresa, vendndodhja, detaje kontakti, koordinatat:

.....
.....
.....
.....
.....

Përshkrim i shkurtër i zonës në fjalë:

.....
.....
.....
.....

Përshkrim i shkurtër i situatës:

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Popullsia e prekur

Përfshirë	Mungojnë	Vdekur	Dëmtuar	Zhvendosur	Të tjera (përshkruaj)
n.	n.	n.	n.	n.	

Dëmtim rruge

Tipi i rrugës	Emri	Vendi	Vendndodhja e izoluar	Shënim
<input type="checkbox"/> Kryesore <input type="checkbox"/> Sekondare				
<input type="checkbox"/> Kryesore <input type="checkbox"/> Sekondare				
<input type="checkbox"/> Kryesore <input type="checkbox"/> Sekondare				
<input type="checkbox"/> Kryesore <input type="checkbox"/> Sekondare				

Kushtet atmosferike

Dukshmëria	Erërat	Retë
<input type="checkbox"/> Qartë <input type="checkbox"/> 500 m <input type="checkbox"/> 100 m	<input type="checkbox"/> Mungojnë <input type="checkbox"/> E forte <input type="checkbox"/> E lehtë	<input type="checkbox"/> Mungon <input type="checkbox"/> Pranishme <input type="checkbox"/> Shi

Strukturat e përfshira:

- Shtëpi Fermë Shkollë Stacion Policie
 Hotel/Fshat Fabrikë Spital Stacion Zjarrfikëse

Burimet

Aktivizuar	Kërkuar

Veprimet kryesore të ndërmarra

Harta:



RAPORTI SITUATËS

I. Historiku i emergjencës/fatkeqësisë

A.Lloji dhe arsyeja e emergjencës:

B. Intesiteti/karakteristikat:

C. Data e ndodhjes së fatkeqësisë:

D. Zonat e prekura: (Specifikoni emrat, numurin e përgjithshëm të popullsisë së prekur, si dhe nj, ad dhe fshatrate prekura më shumë, harta e zonave të prekura)

.....

E. Kërcënime të mundshme dytësore: (C'farë lloji kërcënimi është dhe cilave nj.ad e fshatrave u kanoset)

.....

II. Vlerësimi i dëmeve dhe ndikimeve

A.Efektet mbi popullsinë: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Numuri të vdekurve				
Numuri të dëmtuarve.....				
Numuri të zhdukurve.....				
Numuri i atyre në nevojë për strehim si pasojë e emergjencës				
Burimi informacionit.....				

B. Efektet mbi strehimin: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
---------	--------	--------	--------	--------

Niveli 1-Dëme të vogla nga zjarri (kërkohen riparime, struktura e banueshme).....				
Niveli 2-Dëme madhore nga zjarri, port ë riparueshme, struktura e pabanueshme , kërkohet evakuim)				
Niveli 3-Shkatërrim nga zjarri (strukturë e pa riparueshme dhe e pa banueshme)				
Numuri i atyre në nevojë për strehim si pasojë e emergjencës				
Nëse kërkohet vlerësim më i specializuar (Specifikohet se cfarë lloj ekspertize teknike kërkohet).....				
Burimi i informacionit: ...				
Komente: ...				

C. Efektet mbi shëndetin publik: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Përshkruani dëmet në mjetet e higjenës publike e private ...				
Efektet e raportuara të fatkeqësisë mbi shëndetin publik (numuri rasteve djegie të lehta, të rënda, asfiksime, infeksione virale)				
Nëse kërkohet vlerësim I specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet (spec.shend. public etj).....				
Burimi informacionit:				
Komente:				

D. Efektet mbi bujqësinë dhe bagëtinë : PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Të korra – lloji dhe masa e dëmit (sipërfaqja e djegur etj.)				
Bagëti – lloji dhe efektet (stane, bagëti etj.)				
Nëse kërkohet vlerësim i				

specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet (spec. bujqësie, veteriner, etj).....				
Burimi informacionit:				
Komente:				

E. Efektet mbi bizneset vendore dhe kushtet ekonomike: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Përshkruhet dëmi ose ndikimi mbi bizneset vendore (bizneset e vogla, dhe familjare, tregje vendore)				
Përshkruhen dëmet : -Në pajisje shëndetësore -në shërbimet publike (energji, gaz, karburant, ujësjellës, higjenë publike				
Nëse kërkohet vlerësim i specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet (ekonomist, specialist marketing etj).....				
Burimi informacionit:				
Komente:				

F. Efektet mbi pajisjet jetësore dhe kritike: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
-në transport dhe infrastrukturë (rrugë, ura etj) -në sistemin e telekomunikacionit				
-në pajisje shëndetësore -shërbime komunale - në shërbimet publike (energji, gaz, karburant, furnizim me ujë, higjenë publike)				
Nëse kërkohet vlerësim i specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet				
Burimi informacionit:				
Komente:				

--	--	--	--	--

G. Efektet mbi mjedisin dhe pyjet: PO JO

Efektet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Zonat e ndotura nga tymi, bloza, hiri (sipërfaqet)				
Sipërfaqet e përshkuara dhe të djegura nga zjarri:				
<ul style="list-style-type: none"> • Pyll halorë • Pyll i përzier • Shkurre • Kullotë 				
Nëse kërkohet vlerësim i specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet (spec. bujqësie, veteriner, etj).....				
Burimi informacionit:				
Komente:				

III. Përgjigja ndaj emergjencës dhe vlerësimi nevojave

A.Logjistika e emergjencës dhe kushtet e transportit PO JO

Përgjigja dhe kapacitetet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Cilat magazine vendore janë në dispozicion për përdorim të menjëhershëm (barakat ushtarake të zonës, magazinat e KKSH, kamionë)				
Cilat janë kushtet dhe cila është e disponueshme e rrugëve në këtë zonë				
Nevojat për ndihmë gjatë emergjencës	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Cfarë lloj ndihme kërkohet për të drejtuar pastrimin në rast emergjence dhe rregullimin e rrugëve të rëndësishme dhe pajisjeve të tjera të transportit				
Nëse kërkohet një vlerësim më I specializuar, cfarë lloj teknike kërkohet.				

B.Nevojat për strehim gjatë emergjencës: PO JO

Përgjigja dhe kapacitetet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Sa njerëzve u është ofruar strehuim gjatë emergjencës nëpërmjet organizimit në nivel vendor dhe ku?.....				
Cfarë po bëhet në nivel vendor për të ofruar strehim për popullsinë e zhvendosur?.....				
Nevojat për strehim gjatë emergjencës	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Numuri I njerëzve që kanë nevojë për strehim gjatë emergjencës, specifikohet lloji që nevojitet				
• Cadra				
• Shtrojca plastike				
• Batanije				
• Etj.				
Nëse kërkohet një vlerësim më i specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet?				

B.Nevojat për ujë gjatë emergjencës: PO JO

Përgjigja dhe kapacitetet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Sa njerëzve u është ofruar furnizim me ujë gjatë emergjencës nëpërmjet organizimit të bërë në nivel vendor				
Nevojat për ujë gjatë emergjencës	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Numuri njerëzve që kanë nevojë për furnizim me ujë të dërguar nga jashtë për 7 ditët e ardhshme				
A ka ndodhur ndonjë dëmtim në sistemin e sigurt të furnizimit me ujë, a mund të rregullohet shpejt, cfarë kërkohet për ta rivënë në funksion ?				
Nëse kërkohet një vlerësim më i				

specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet?				
--	--	--	--	--

D. Nevojat për kujdes shëndetësor dhe higjenë publike gjatë emergjencës:

PO JO

Përgjigja dhe kapacitetet	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
A po trajtohet në nivel vendorndonjë nga nevojat për trajtim shëndetësor ose higjenë publike dhe kërcënimet ndaj shëndetit ppublik nese po ,atëherë si?				
Nevojat për kujdes shëndetësor dhe higjenë publike gjatë emergjencës	Zona 1	Zona 2	Zona 3	Zona 4
Shëndet: Specifikohen nevojat për kujdes shëndetësor				
Higjenë publike: Numuri i njerëzve për të cilët kërkohet organizim nga jashtë për higjenë publike, specifikohet lloji i nevojitur.				
Banja të lëvizëshme Sapunë, detergjentë, pluhur klorine etj.				
Nëse kërkohet një vlerësim më i specializuar, cfarë lloji ekspertize kërkohet?				
Komente				

Përgatitur nga:

Data dhe ora e Raportit:

Kryetari Bashkisë

.....

FORMAT KËRKESE DREJTUAR AKMC PËR ANGAZHIMIN E FA
(Shembull)

Nr....Prot.....

Përmet, më .../.../2025

Lënda: Kërkesë për mbështetje me Forca të Armatosura, mjete zjarrfikëse dhe ndërhyrje nga ajri

Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Tiranë

Më datë....., në vendin e quajtur (fshati, nj,ad, bashkia, nga zona e deri në zonën e, si pasojë e temperaturave të larta, erës, terrenit të vështirë në përdorimin dhe manovrimin e forcave dhe të mjeteve zjarrfikëse nga data deri në datën, është përfshirë një territor i konsiderueshëm sipërfaqe me pyje, shkurre e kullotë e toke bujqësore.

Vatrat e zjarrit në këto zona po përhapet me shpejtësi në drejtim të qendrave të banuara

Nisur nga vështirësitë e konstatuara, nga drejtuesit e operacioneve në bashki, si dhe nga parashikimi i motit me temperatura të larta për ditët në vazhdim, gjendja e konstatuar konsiderohet tepër e vështirë, si për banorët, bagëtitë, të mbjellat, edhe për subjektet e tjera private që kryejnë aktivitetet në këto zone.

Grupi i vlerësimit i ngarkuar për këtë qëllim konstaton se:

Rrezik emergjent paraqet zona e fshatrave;banorët e së cilës kërkohet të evakohen jo më vonë se 12 orët e ardhshme.

Numri i banorëve me në rrezikbanorë.

Numuri i staneve

Numri i bagëtive në këtë zonëbagëti (të imëta dhe të trasha).

Objekte kulturi të rrezikuara

Kemi përcaktuar vendin e vendosjes së të evakuarve por, në pamundësi të disponimit të mjeteve të posaçme të përshtatshme për ndërhyrje në zonat në afërsi të vatrave të zjarrit dhe mjediseve të përshtatshme për strehim.

Me gjithë angazhimin e të gjitha kapaciteteve të mundëshme në njerëz dhe mjete të bashkive fqinje të qarkut dhe AdZM, vatrat e zjarrit nuk janë bërë të mundura të vihen nën kontroll.

Në këto kushte duke parë përhapjen e madhe në sipërfaqe të zjarrit, shtimin e pranisë së erës dhe terrenit të vështirë për ndërhyrje, referuar nenit 7,pika 3 të ligjit Nr. 45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, kërkojmë:

Ndërhyrjen tuaj në Ministrinë e Mbrojtjes , për mbeshtetjen me efektivë dhe mjete zjarrfikëse të Forcave të Armatosura.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë po ju dërgojmë edhe një hartë të zonës së prekur nga zjarri, duke evidentuar rrugët, urat dhe vendet ku, për momentin, është i mundur afrimi i efektivave të FA sa më afër zonave të rrezikuara nga zjarri.

Jemi në pritje të ardhjes sa më të shpejtë të forcave e mjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Numri i kontaktit:(Përgjegjësi sektorit të emergjencave civile)

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin

Kryetari Bashkisë

.....

Aneks 3: Formate orientuese për komunikimin me publikun, sipas etapave

Etapa I – Rritja e gatishmërisë

Titull: Rritje e gatishmërie

Bashkia Përmet dhe AKMC janë duke ndjekur nga afër [*përshkruani shkurt situatën dhe vendndodhjen*]. Për këtë arsye, Bashkia Përmet dhe AKMC kanë rritur gatishmërinë për të përballuar situatën në rast përshkallëzimi. Të gjithë qytetarët janë të lutur të marrin masa për të shmangur lëvizjet e panevojshme deri në një njoftim të dytë. Siguria juaj është prioritet! Informohuni në [*vendosni një faqe online dhe/ose kontaktet*].

Etapa II - Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Titull: Gjendje gatishmërie në [*zona e prekur*]

Shpallet gjendja e gatishmërisë në [*zona e prekur*] për shkak të përshkallëzimit të [*përshkruani shkurt situatën*]. Informojmë se kjo masë është marrë për të siguruar mobilizimin e të gjitha burimeve për përballimin e një situatë të emergjencës. Lutem të gjithë qytetarët që të mos qarkullojnë në afërsi të [*emri i zonës së prekur*]. Situata është nën kontroll dhe nuk ka vend për panik. Informohuni vazhdimisht në [*vendosni një faqe online dhe/ose kontaktet*]. Bashkia Përmet / AKMC

Etapa III – Aktivizimi: Shpallja e situatës së Emergjencës

Titull: Situatë emergjence

Të gjitha burimet janë venë në dispozicion për të përballuar situatën [*përshkruani shkurt situatën dhe vendndodhjen*].

Ekipet e emergjencës janë në vendngjarje dhe po punojnë për të garantuar sigurinë e banorëve dhe minimizuar dëmet.

Bashkëpunoni dhe zbatoni urdhërat e autoriteteve në rast të evakuimit të banesave!

Kërkoni ndihmë në numrin 112.

Informohuni vazhdimisht në [*vendosni një faqe online dhe/ose kontaktet*].

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Etapa IV – Dalja nga situatë

Titull: Stabilizim i situatës

Bashkia Mallakastër dhe AKMC kanë marrë në kontroll situatën e [*përshkruani shkurt situatën dhe vendndodhjen*]. Ka nisur puna për normalizimin e situatës dhe rimëkëmbjen e dëmeve.

Shmangni lëvizjet në [*zona e prekur*]. Raportoni dëmet në [*kontakt*].

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Aneks 4: Tabelat e Kapaciteteve

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave / fatkeqësive.

Kategoria: Personeli (Fuqia punëtore)

Nr	Emërtimi	Adresa Drejtuesi	Nr. telefonit	Numuri total i personelit	Nga numri total angazhohen në rast emergjence
Bashkia					
1	Aparati			58	15
2	Njësia e funksioneve			119	38
	Emergjencat Civile			4	3
	MZSH			14	14
	Policia Bashkiake			6	4
	Çerdhe			8	-
	Konvikti			7	-
	QKF + Kopështi			33	-
	Arsimi Mesëm			6	-
	Qendra me Aftësi ndryshe			9	-
	Spektori Aktiviteteve			20	5
	Njësitë Administrative			12	12
3	Njësia e shërbimeve			139	72
	Spektori mbetjeve			35	10
	Spektori Gjellbërimit			23	5
	Spektori Mirëmbajtjes			24	10
	Mirëmbajtja e Kanaleve Kulluese			8	8
	Spektori Rrugëve Rurale			35	25
	Spektori Pyje dhe Kullota			14	14
	Shuma			316	125

Tabela e kapaciteteve, kategoria për akomodim

N r	Emri i subjektit	Administrat ori	Lloji i Akomodimit/ Hotel/aparta ment/shtëpi	Adresa/Vendod hja	Numëri shtretër ve	Numër telefonit
1	“Permeti”	Valentina Bundo	Hotel	Qëndër Qytet	60	0694523811
2	“ Alvero”	Vasillaq Nikolla	Hotel	Qëndër Qytet	35	0682081334
3	“ Kaludhi”	Albert Lipe	Hotel	Në hyrje të qytetit Përmet	29	0682310029
4	“ Vjosa”	Leonard Budo	Hotel	Lagja e Re	15	0692398175
5	“ Amerika”	Stavri Kristo	Hotel	Lagja e Re	15	0692894536
6	“ Rei-19”	Ramis Shahini	Hotel	Lagja Mejden	30	0697788682
7	“Ana”	Marjeta Muke	Hotel	Lagja e Re	18	0692894536
8	“Ilvi/Dajana/ Felgi/Merli”	Flamur Guçe	Hotel	Ish SMT	25	0684130394
9	“ Ervehe”	Irakli Kaso	Hotel	Lagja Partizani	45	0693095827
10	“ Elma”	Mario Hysen Shahaj”	Hotel	Lagja e Re	35	0684657999
11	“ Villa Ago”	Drita Ago	Hotel	Lagja e Re	15	0682282801
12	“VillaÇulli”	Anesti Çulli	Hotel	Lagja Historike	15	
13	Joan Guest House	Ilijan Ibrahimi	Hotel	Lagja Mejden	25	0692476639
